

Ç'illoj BASHKIMI? Mbi hapësirën e përbashkët ekonomike Shqipëri - Kosovë

Akte të forumit akademik

*Nën kujdesin e z.BEHGJET PACOLLI
ish-President i Republikës së Kosovës*



Koordinator i konferencës dhe editor i botimit:
Mentor NAZARKO

Redaktimi gjubësor:
Besa VILA

Arti grafik:
Ilir DRIZARI

© UET Press, 2012

Të gjitha të drejtat për këtë botim janë të rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet
Përmes çdo mënyre ose mjeti pa leje paraprake.

ISBN: 978-99956-39-53-2

Adresa: Bulevsardi Gjergj Fishta, ish-NPV2, Tiranë
www.uet.edu.al / info@uet.edu.al

P Ë R M B A J T J A

Pse ky forum?	7
Karta e parimeve	9
Nisma për hapësirën mbarëkombëtare të zhvillimit <i>Propozuar nga z.Behgjet Pacolli, ish-President i Republikës së Kosovës</i>	
Krijimi i një vizioni të përbashkët ekonomik të popullit shqiptar	13
Dr. Teuta DOBI - <i>ish-Presidente UET</i>	
Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërshqiptar	17
Arbën XHAFERI - <i>Filozof</i>	
Ne duhet të punojmë për Mirëqenien e kombit tonë	23
Behgjet PACOLLI - <i>ish - President i Kosovës</i>	
Potenciali ekonomik i viseve shqiptare para copëtimit në vitin 1913	33
Prof. dr. Marenglen VERLI - <i>Instituti i Historisë</i>	
Të veprojmë si një treg i përbashkët	47
Nikolin JAKA - <i>Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë</i>	
Koha e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri	51
Safet GËRXHALIU, M.A. - <i>Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, Universiteti FAMA</i>	
Koha për nisma dhe aksione konkrete në kuadër të integritimit rajonal edhe europian	55
Alfred MOISIU - <i>ish-President i Shqipërisë</i>	
Të realizojmë vetintegrimin tonë kombëtar si pasqyrim të zhvillimeve aktuale globale	59
Rexhep MEIDANI - <i>ish-President i Shqipërisë</i>	
Zhvillimi i barabartë dhe i gjithanshëm i të gjitha pjeseve të kombit, nxit aspiratat për zhvillim, bashkëpunim dhe integrim	67
Prof.Dr.Faik BRESTOVCI - <i>Rektor i Universitetit "FAMA"</i>	

Nevoja e unifikimit të programeve arsimore, legjislacionit arsimor, etj 71

Prof. Dr. Shpresa HOXHA

Kryetare e Institutit "ALB-SHKENCA – Prishtinë"

Efektiviteti i funksionimit të hapësirës së përbashkët ekonomike shqiptare75

Prof. Dr. Adrian CIVICI - *Universiteti European i Tiranës*

Tregu i përbashkët i energjisë elektrike Kosovë- Shqipëri 81

Fadil ISMAJLI, Naim BEJTULLAHU, Skënder GJONBALAJ

Shqipëri - Kosovë, dy shtete, një komb, një treg i përbashkët mbarëkombëtar 97

Artan GJERGJI, M.A. - *Universiteti European i Tiranës*

Roli i bujqësisë në zhvillimin ekonomik: Bashkëpunimi ekonomik Shqipëri-Kosovë 121

Lumnije THAÇI, M.A. - *Universiteti FAMA*

Ecuria e zhvillimit të bujqësisë në Shqipëri dhe në Kosovë: Sfida të përbashkëta dhe nevoja për koordinim të politikave zhvillimore 127

Dr. Shkëlzen MARKU - *Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore*

Integrimet Rajonale Europiane

A munden Shtetet Nordike të jenë shembull për Shqipërinë dhe Kosovën dhe për trojet e tjera shqiptare në Ballkan?.....137

Avni DERVISHI, M.A.

Integrimi dhe bashkëpunimi financiar Shqipëri – Kosovë145

Dr. Elvin MEKA

Dr. Arjan KADAREJA - *Universiteti European i Tiranës*

Në vend të përmylljes, ose roli i Lëvizjes 153

Mentor NAZARKO, M.A. - *Universiteti FAMA*

Drejtor i Qendrës për Kërkime të "Lëvizjes për hapësirë mbarëkombëtare zhvillimi"

Ç'lloj BASHKIMI?

Mbi hapësirën e përbashkët ekonomike Shqipëri-Kosovë

Pse ky forum?

Po shtohen zërat për një bashkim intensiv të dy vendeve. A duhet paraprirë eventualisht një bashkim i tillë nga krijimi i një tregu të përbashkët shqiptar? A duhet nxitur në nivele maksimale komunikimi kulturor dhe njerëzor midis dy vendeve si parakushte të çdo zhvillimi tjetër? Ç'rol luan integrimi europian për aspiratën e shqiptarëve që sipas sondazheve të fundit e duan bashkimin në një shumicë të caktuar? Cili do të jetë stacioni i fundit i këtij integrimi ndërshqiptar?

Cilat janë **hapësirat në këtë bashkëpunim** që duket sikur e lehtësojnë barrën e mbijetesës së Kosovës që nuk ka dalje në det; që nuk ka eksperiencë zhvillimi të pavarur; që ka një papunësi mbi 50% në një popullsi nga më të rejtat në botë, etj?

A nevojitet një strategji e përbashkët zhvillimi dhe integrimi europian, apo strategji të veçanta panshqiptare që duhen koordinuar? A ka **faktorë të jashtëm** që e pengojnë këtë integrim? Cilët janë **faktorët e brendshëm** (shqiptarë) që e pengojnë këtë integrim? **Marrëveshja CEFTA** dhe cilat janë hapësirat që ofron ajo për një treg të përbashkët shqiptar. A ka **modele të ngjashme integrimi të tregjeve** si parapërgatitje për integrimin europian.

Për të gjitha këto pikëpyetje Forumi i organizuar nga dy Universitetet tentoi të ofronte përgjigje autoritare.

Karta e parimeve

Nisma për hapësirën mbarëkombëtare të zhvillimit

Propozuar nga z.Behgjet PACOLLI

Ish-President i Republikës së Kosovës

Ne, një grup figurash institucionale, intelektualësh, autoritetesh akademike të universiteteve të Shqipërisë, të Kosovës dhe të Maqedonisë:

- Të frymëzuar nga idetë e baballarëve themelues të kombit shqiptar dhe nga sakrificat e heronjve të tij;
- Duke vlerësuar kapacitetet ekzistuese shoqërore, politike, akademike, ekonomike, kulturore të kombit;
- Duke respektuar aspiratat europiane të kombit shqiptar;
- Thellësisht të bindur për rëndësinë thelbësore të Aleancës së këtij kombi me shoqërinë perëndimore të kombeve, materializuar me pavarësinë e Kosovës dhe me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO;
- Duke respektuar të gjitha dokumentet ndërkombëtare relevante për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë të shteteve;
- Në respekt të traditës së shkëlqyer të bashkëjetesës së kombit shqiptar me kombet e tjera në rajon,
- Duke konsideruar se vendet tona nuk kanë arritur të realizojnë plotësisht potencialet e veta zhvillimore për arsye historike që lidhen me ato ose me të tjerë;

- Me shqetësimin për gjendjen aktuale ekonomike të dy vendeve, që me gjithë progreset e shënuara e të arritura në këtë periudhë të lirisë dhe pavarësisë, prapëseprapë kanë probleme të mëdha zhvillimore në rrafsh europian;
- Thellësisht të bindur se vetiniciativa për realizimin e kapaciteteve zhvillimore të kombit nëpërmjet integritit të këtyre kapaciteteve, në modelet më të mira integruese, të Komuniteteve Ekonomike Europiane, të Komunuelthit, të Frankofonisë, të vendeve nordike, është rruga më e drejtë dhe e sigurt e zhvillimit të kombit;

Vendosim t'i japim jetë nismës për "Hapësirën mbarëkombëtare të zhvillimit"

Nisma do të jetë një lëvizje qytetare e shtrirë në të gjithë vendet ku jetojnë shqiptarë, e cila synon të krijojë një **Lëvizje përbashkuese** të kapaciteteve më të mira intelektuale, akademike, shoqërore, etj, për t'i sugjeruar politikës së vendeve tona ecjen në një rrugë përbashkuese zhvillimi, që do të kombinonte në mënyrën më të mirë aspiratat natyrore të kombit për mirëqenie dhe aspiratat europiane integruese.

Qëllimet e kësaj Lëvizjeje do të jenë:

- Zhvillimi harmonik, kompatibël dhe i qëndrueshëm ekonomik në të gjitha fushat, prej bujqësisë, energjetikës dhe deri te vlerat kulturore;
- Zhvillimi i resurseve njerëzore në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, stabilizimit të familjes sidomos garantimi i barazisë së femrës dhe i kujdesit të veçantë ndaj fëmijëve;
- Ngritja e standardit jetësor dhe mbrojtja e mjedisit;
- Kontrolli i migrimit të popullatës etj.

Kjo Lëvizje, e institucionalizuar, e organizuar, do të ofrojë

dokumente programatike, studimore të qeverive përkatëse për të ecur në këtë rrugë.

Për këtë qëllim Lëvizja do të krijojë një **Institut Kërkimor pranë Universitetit European të Tiranës**, që do të inkurajojë studiuesit e rinj, ata me eksperiencë në veprimtari kërkimore, dhe për formulimin e këtyre dokumenteve strategjike për qeveritë e vendeve tona. Instituti do të jetë i hapur për kontribute edhe dhe më gjerë.

Kjo Lëvizje do të nxisë në mënyrë periodike takimet e krerëve të shteteve dhe të qeverive, ministrave të fushave të ndryshme për të bërë bilancin e bashkëpunimit kombëtar në fushën ekonomike, kulturore, universitare, të drejtësisë, të shëndetësisë, të ruajtjes së kufijve nga dukuritë negative, në përafrimin e legjislacionit me atë europian, etj;

Lëvizja sugjeron krijimin e organizatave të përbashkëta të juristëve, të ekonomistëve, dhe të çdo lloj asociacioni të grupeve të interesit, të shoqërisë civile etj, të cilët takohen në mënyrë periodike në qytete të ndryshme të hapësirës kombëtare;

Në kontekstin rajonal, Lëvizja sugjeron se duhet të intensifikohet bashkëpunimi i ndërsjellë në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit të qenie njerëzore dhe garantimit të të drejtave të minoriteteve;

Në kontekstin ndërkombëtar, Lëvizja synon inkurajimin e aktivitetit të qeverive në kuadër të zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të detyrimeve të tjera në këtë plan.

Për të realizuar qëllimet e veta Lëvizja vendos:

Nisma do të përfaqësohet nga një figurë publike që simbolizon unitetin kombëtar. Ai si vetë asociacioni nuk do të ketë pushtet ekzekutiv. Veprimtaria e tij do të orientohet dhe do të drejtohet nga **Bordi i Besimit** të kësaj Lëvizje ku

bëjnë pjesë si anëtarë themelues:

Alfred Moisiu,

ish-President i Shqipërisë;

Rexhep Meidani,

ish-President i Shqipërisë;

Behgjet Pacolli,

ish-President i Kosovës;

Arbën Xhafferri,

filozof dhe intelektual;

Faik Brestovci,

profesor, rektor i Universitetit Fama, Prishtinë;

Teuta Dobi,

ish-Presidente, Universiteti European i Tiranës;

Në vijim të ekzistencës së tij Bordi është i hapur për praninë e personaliteteve të tjera të shquara nga hapësira shqiptare. Me funksionalizimin e Lëvizjes do të merret një strukturë e përhershme ekzekutive.

Asociacioni duhet të mbajë dy mbledhje plenare në vit. Në këto mbledhje do të analizohen arritjet dhe do të projektohen qëllimet e reja.

Krijimi i një vizioni të përbashkët ekonomik të popullit shqiptar

Dr. Teuta DOBI*

Abstrakt. *“Një treg i përbashkët shqiptar” nuk do të thotë vetëm rritje bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Kosovës, e cila pak a shumë edhe për shkak të uniformitetit tonë si një komb me një gjuhë dhe kulturë të përbashkët është arritur, por do të thotë intensifikimin e këtij bashkëpunimi dhe institucionalizimin e tij. Dhe kjo nuk nënkupton medoemos vetëm politika të caktuara ekonomike, të shoqëruara me fatura financiare, por pikësepari do të thotë politika të përbashkëta arsimore dhe sociale.*

Në emër të Universitetit European të Tiranës kam nderin t’ju përshëndes në këtë konferencë të rëndësishme, e cila ka si qëllimin kryesor të saj krijimin e një vizioni të përbashkët ekonomik të popullit shqiptar: **“Krijimin e një hapësire të përbashkët ekonomike shqiptare”**, duke u mbështetur në tri dimensione kryesore: dimensionin politik, ekonomik dhe atë akademik. Ne duhet ta zhvillojmë e institucionalizojmë këtë debat konstruktiv mbi të ardhmen shqiptare në rajon. Ky është një debat shumë i rëndësishëm, i cili pavarësisht se është

* *Ish-Presidente UET*

i përqendruar në bashkëpunimin ekonomik, doemos i kalon këta kufij. Duke synuar të nxisë e të mbështesë formulimin e politikave të unifikuara ekonomike nga qeveritë në Shqipëri e në Kosovë, këta objektiva përkojnë gjithashtu me interesat politike, sociale dhe kulturore shqiptare. Dhe sigurisht që këtu dy Universitetet nismëtare, UET-i dhe FAMA, si dhe universitetet e tjera në të dy vendet tona, munden dhe duhet të shërbejnë si një “medium” për të përçuar mesazhin tek të dyja qeveritë tona respektive, por edhe te grupet e interesit në Shqipëri e në Kosovë. Por, kryesisht universitetet mundet dhe duhet të shërbejnë edhe si “think tank”, ose “vatër” gjenerimi idesh mbi strategji e politika të reja, si dhe për formulimin e tyre.

Pavarësisht se deklaratat politike zyrtare nuk kanë munguar, turizmi patriotik dhe kulturor kanë qenë në rritje të vazhdueshme, sërish kanë munguar politikat e caktuara ekonomike midis Shqipërisë dhe Kosovës për të institucionalizuar vullnetet politike të dy palëve, të shprehura publikisht. Në qoftë se para viteve 90–të gjëja që na mungonte më shumë ishte liria e lëvizjes dhe e komunikimit, mbyllja e tregjeve, sot ne po operojmë në një treg të hapur: në një treg të hapur rajonal dhe në një treg të hapur ndërkombëtar. Kështu, sfida jonë më imediate sot mbetet rregullimi i këtij “tregu të hapur” dhe gjetja e modelit më të përshtatshëm dhe në interes të të dyja palëve. Sigurisht që filozofia kryesore e rregullimit të tij është dhe duhet të mbetet ndjenja kombëtare, por sensi pragmatist dhe interesi individual i secilit biznes ose i çdo aktori tjetër është diçka që duhet respektuar në secilën politikë të ndërmarrë në nivel qendror ose lokal.

“Një treg i përbashkët shqiptar” nuk do të thotë vetëm rritje bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Kosovës, e cila pak a shumë edhe për shkak të uniformitetit tonë si një komb me një gjuhë dhe kulturë të përbashkët është arritur, por do të thotë intensifikimin e këtij bashkëpunimi dhe institucionalizimin e tij.

Dhe kjo nuk nënkupton medoemos vetëm politika të caktuara ekonomike, të shoqëruara me fatura financiare, por pikësëpari do të thotë politika të përbashkëta arsimore dhe sociale. Midis Shqipërisë dhe Kosovës mungojnë politika të caktuara në nivelin makro për njohjen reciproke të diplomave, zhvendosjen e institucioneve arsimore, hapjen e degëve dhe programeve të përbashkëta të studimit, vendosjen e rregullave dhe ligjeve të përbashkëta, shkëmbimin e studentëve dhe profesorëve. Sigurisht që debatet për një bashkëpunim të tillë kanë kohë që kanë nisur dhe iniciativa individuale midis universiteteve publike ose private janë ndërmarrë, por kuadri ligjor për certifikimin e tyre ka munguar. Shpesh, gjatë iniciativave tona të përbashkëta me institucione homologe, na është dashur të përballemi me të tilla sfida ligjore të cilat krijojnë po të njëjtat pengesa që do të krijonin dhe me vende të tjera në rajon ose edhe më gjerë.

Kjo sepse tregu ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës është bërë tashmë jo vetëm një treg i hapur ku operojnë aktorë të fuqishëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë, por edhe sepse ai është bërë një treg shumë kompetitiv dhe madje në disa raste me një konkurrencë agresive, aspak sipas rregullave dhe aspak luajale. Kjo pasqyrohet në ekonomi ashtu siç pasqyrohet edhe në arsimin e lartë. Zakonisht institucionet e arsimit të lartë perceptohen si më pak të adaptueshme ndaj tregut në krahasim me kompanitë private ose edhe institucionet publike. Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe në Kosovë kanë ndryshuar shumë gjatë këtyre viteve të fundit, megjithëse shpeshherë duke ndjekur modelet e institucioneve publike vendase ose modelet e universiteteve të huaja. Të pakta kanë qenë rastet kur përshtatja e universiteteve shqiptare është bërë në përputhje me kërkesat e tregut të punës ose edhe më të pakta kanë qenë rastet kur i janë përshtatur kërkesave të tregut të hapur midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Sigurisht që për të realizuar “një hapësirë të përbashkët

ekonomike Shqipëri – Kosovë” duhet të rrisim investimet tona në arsimin e lartë, pasi pa rinovuar strukturat ekzistuese në legjislacion ashtu si dhe në infrastrukturë nuk mund të kemi zhvillim të politikave të përbashkëta ekonomike. Na nevojiten programe të reja studimi, na nevojiten programe të përbashkëta studimi dhe standarde të unifikuara të cilësisë në mënyrë që t’i shërbejmë më mirë funksioneve politike dhe ekonomike. Kërkohej gjithashtu një bashkëpunim më i madh midis universiteteve dhe kompanive të cilat operojnë si në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë. Kërkohej njehsimi i programeve dhe kurrikulave tona mësimore, njehsimi i teksteve si dhe i botimeve të përbashkëta akademike. Me anë të programeve të përbashkëta të studimit ne mund të ndikojmë në mënyrë domethënëse që të rinjtë shqiptarë të njohin më mirë njëri – tjetrin pavarësisht anës së kufirit ku jetojnë dhe pavarësisht miteve dhe fantazmave të historisë së shkuar, të cilat vendet tona i kanë kaluar me mjaft vështirësi, natyrisht në llojin e vet. Universiteti European i Tiranës ka shërbyer dhe vazhdon të shërbejë si një oaz institucional i këtij bashkëpunimi, si një pikë takimi midis të rinjve të Shqipërisë dhe Kosovës, të cilët shkëmbejnë me njëri – tjetrin eksperiencat e ndryshme jetësore, por që falë prejardhjes së njëjtë kulturore dhe historike kanë shpresa dhe ëndrra të njëjtësuarra për të ardhmen.

Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërshtetëror

Arbën XHAFERI

Filozof

Abstrakt. *Mirëqenia e përbashkët shqiptare është në funksion të korigjimit të gabimeve që janë bërë deri më tani në konferenca të ndryshme dhe të krijojë kompatibilitet ekonomik, politik, kulturor ndërmjet dy shteteve shqiptare. Projekti shqiptar nuk do të provokojë askënd, por do të krijojë kushte për një zhvillim më të lehtë në të gjitha fushat e shoqërisë, kryesisht në ekonomi.*

Ideja e krijimit të një projekti që synon të konsolidojë mirëqenien shqiptare duhet të realizohet përmes institucionalizimit të saj. Pa institucione asnjë ide nuk mund të pretendojë për sukses dhe funksionim të papenguar.

Historia e njerëzimit dëshmon se vetiniciativa është një nga faktorët kryesorë për suksesin e popujve në procesin e mbijetesës, prodhimit të vlerave, ngritjes së mirëqenies dhe progresit të tyre të vazhdueshëm.

Populli shqiptar një kohë të gjatë pati vështirësi që të mbrohet nga iniciativat pushtuese të popujve të tjerë, që për shkaqe të ndryshme arrinin të depërtojnë dhe t'i pushtojnë hapësirat e tyre tradicionale duke i robëruar ata dhe duke i vandalizuar

vlerat e krijuara me shekuj.

Pas shpërbërjes së Perandorive, asaj Otomane dhe Austro-Hungareze u krijuan kushte për çlirim dhe krijim të shteteve të popujve që ishin të sunduar nga këto Perandori. Kongresi i Berlinit (qershor 1878) ishte i padrejtë ndaj shqiptarëve ngaqë, nën diktatin e Bismarck-ut u zbatua politika që i përfillte realitetet, kapacitetet reale të popujve (realpolitikën). Populli shqiptar në atë kohë, por edhe në vazhdimësi nuk i posedonte këto kapacitete, prandaj në mënyrë arrogante shpërfill interesin e tij. Në Kongresin e Berlinit nuk u mor parasysh kërkesa e drejtë e popullit shqiptar për pavarësi.

Pas luftërave ballkanike, që ishin pasojë e konstatimit për shpërbërjen e pandalshme, definitive të Perandorisë Otomane, shqiptarët e shpallën pavarësinë që në Konferencën e Londrës, që nuk u njoh në tërësinë e saj. Jashtë kufijve mbetën territore të mëdha të banuara me popullatë dominante shqiptare.

Gati 100 vjet u zhvillua lufta për mbijetesë fizike të shqiptarëve. Me shpërbërjen e Jugosllavisë sërish u hapën mundësitë për korrigjim të gabimeve historike.

Faktori ndërkombëtar formoi një komision, që do të përcaktonte mënyrën e shpërbërjes së Jugosllavisë, të udhëhequr nga eksperti francez, Badenter. Por, edhe ai e përsëriti gabimin paraprak: të drejtën për vetëvendosje ua njohu vetëm republikave dhe jo entiteteve konstituive shtetformuese. Edhe kjo padrejtësi u korrigjua pjesërisht me mundime dhe viktima të mëdha. E drejta e patjetërsueshme e popullit shqiptar për vetëvendosje, konkretisht për bashkim me shtetin amë sërish u anashkalua.

Me pavarësimin e Kosovës u pengua krijimi i një shteti normal, rentabël shqiptar. U krijuan dy shtete shqiptare të cilat vazhdimisht do të përballen me probleme ekonomike, investime dhe shpenzime të tjera të panevojshme. Nëse nuk gjenden rrugë të tjera këto dy shtete të vogla do të hasin në pengesa të njëpasnjëshme.

Në situata të këtilla çdo popull i qytetëruar do të përpiejë të gjejë rrugëdalje të qytetëruar për t'i tejkaluar barrierat e

vendosura në konferenca të ndryshme. S'do mend se rrugëdalja nuk duhet t'i shkelë konventat ndërkombëtare, por të gjejë forma të tjera që kanë një precedencë të mbarë, si bie fjala projekti britanik i Commonwealthit (Mirëqenia e popujve) që ka 53 anëtarë dhe ai francez (Frankofonia) që ka numër identik të anëtarëve (53). Këtë rrugë, kohët e fundit, ka filluar ta ndjekë edhe Turqia me idenë e krijimit të një Commonwealthi osman. Ky projekt turk që mëton rikthimin në Ballkan filloi me vizitën e Ministrisë turke të Punëve të Jashtme, Davutogllu, në Sanxhak dhe vazhdoi me nënshkrimin e deklaratës së Stambollit ndërmjet Presidentit turk Gyl, atij serb Tadiq dhe atij boshnjak Sillajxhiq.

Projekti shqiptar i mirëqenies së përbashkët natyrisht që nuk do të jetë kaq ambicioz dhe pretencioz ngaqë nuk synon që të krijojë një mekanizëm për përhapje të hegjemonisë shqiptare në rajon. Mirëqenia e përbashkët shqiptare është në funksion të korrigjimit të gabimeve që janë bërë deri më tani në konferenca të ndryshme dhe të krijojë kompatibilitet ekonomik, politik, kulturor ndërmjet dy shteteve shqiptare.

Projekti shqiptar nuk do të provokojë askënd, por do të krijojë kushte për një zhvillim më të lehtë në të gjitha fushat e shoqërisë, kryesisht në ekonomi.

Ideja e krijimit të një projekti të këtillë, që synon të konsolidojë mirëqenien shqiptare duhet të realizohet përmes institucionalizimit të saj. Pa institucione asnjë ide nuk mund të pretendojë për sukses dhe funksionim të papenguar.

Hapi i parë duhet të jetë miratimi i Deklaratës për themelimin e asociacionit për "Mirëqenie shqiptare".

Kjo deklaratë duhet të përkufizojë qëllimet parësore të këtij projekti. Ky program duhet të ndahet në tri kategori:

- konteksti shqiptar;
- konteksti rajonal dhe
- konteksti ndërkombëtar.

Në kontekstin e parë duhet të përfshihen qëllimet parësore siç janë:

1. Zhvillimi harmonik, kompatibil dhe i qëndrueshëm ekonomik në të gjitha fushat, prej bujqësisë, energjetikës dhe deri te vlerat kulturore;
2. Zhvillimi i resurseve njerëzore në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, stabilizimit të familjes e sidomos garantimi i barazisë së femrës dhe kujdesit të veçantë ndaj fëmijëve;
3. Ngritja e standardit jetësor;
4. Mbrojtja e mjedisit;
5. Kontrolli i migrimit të popullatës etj.

Në kontekstin rajonal duhet të intensifikohet bashkëpunimi i ndërsjellë në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit me qenie njerëzore dhe garantimit të të drejtave të minoriteteve.

Në kontekstin ndërkombëtar bëhet vlerësimi i veprimeve në kuadër të zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të detyrimeve të tjera në këtë plan.

Kjo marrëveshje lidhet mes dy shteteve shqiptare, Shqipërisë dhe Kosovës. Marrëveshja është vullnetare që nuk ndërhyt në interesat e qeverive.

Selia e asociacionit “Mirëqenia shqiptare” sugjerohet të jetë në Kosovë.

“Mirëqenia shqiptare” do të udhëheqë një figurë eminente kombëtare që simbolizon unitetin kombëtar. Ajo si vetë asociacioni nuk do të ketë pushtet ekzekutiv.

Me funksionimin e asociacionit do të merret Sekretariati i Mirëqenies.

Asociacioni duhet të mbajë dy mbledhje plenare në vit. Në këto mbledhje do të analizohen arritjet dhe do të projektohen qëllimet e reja.

Themelimi i një institucioni të tillë ka dy dobësi. E para ka të

bëjë me dyshimet, sidomos të atyre që i frikësohen konsolidimit të kauzës kombëtare se kjo iniciativë ka të bëjë me idenë e krijimit të Shqipërisë së Madhe. Për ta eliminuar këtë dyshim duhet që në deklaratë të parashikohen garanci që eliminojnë të gjitha imputimet dashakeqe ose dashamirëse.

Dobësia e dytë e kësaj ideje ka të bëjë me kritikën që shtron dilemën se ky asociacion do të ndërhyjë në kompetencat e qeverive të dy shteteve. Krahas kësaj që në fillim do të bëhen vërejtje përbuzëse që këtë iniciativë e shohin si një ide folklorike dhe të kotë.

Përgjigja kundër këtyre kritikave eventuale përbuzëse duhet të jetë ajo që tha Hasan Prishtina kur luftonte për krijimin e Shqipërisë etnike:

“Na luftojmë e ndoshta nuk e gëzojmë (lirinë), por ata që vinë pas nesh kanë me gjet shejat tona”.

* Arbën Xhaferi vdiq në 15 gusht 2012. Si mendimtari më i madh i viseve shqiptare në fund të shek. 20 dhe fillim të shek. 21, ai ishte ideatori, nuni dhe themeluesi i kësaj ideje, që zu fill me emrin Komunuelth i shteteve shqiptare. Megjithëse ai nuk mundi të merrte pjesë në këtë konferencë për arsye shëndetësore, Arbëni ishte mbrapa çdo akti dhe çdo vendimi të kësaj Konference, duke u konsultuar në kohë reale për tekstin e Deklaratës së fundit, vendimin për krijimin e Lëvizjes për Hapësirën Mbarëkombëtare të Zhvillimit, emrat që do ta përbënin Bordin fillestar, drejtimin e tij, etj. Zoti Xhaferi kishte përpunuar dhe ide të tjera për vijimësinë e kësaj Lëvizjeje duke vendosur të merrej shumë kohë me të. Mjerisht ai vdiq parakohe në datë 15 gusht 2012, duke lënë pas një trashëgimi ideore, mendimi dhe veprimi politik, që do të përkujtohen gjatë. Parë kështu, fjalët e Hasan Prishtinës që ai citon në fund të këtij referimi, ngjajnë si të thëna prej vetë Arbënit, si përkujtim i ngjashmërisë në fatin e burrave të mëdhenj të kombit që nuk arrijnë të shohin të jetësuar gjithë idetë e tyre.

Ne duhet të punojmë për Mirëqenien e kombit tonë

Behgjet PACOLLI

Ish-President i Kosovës

Abstrakt. *Ne duhet të punojmë për Mirëqenien e kombit tonë. Askush nuk mund të na pengojë për këtë. Askush s'ka të drejtë të na pengojë për këtë.*

Duke folur në frymë pozitive, më duhet të them se institucionet europiane ku ne duam të hyjmë, na nxisin të punojmë për këtë mirëqenie. Në përputhje me modelet europiane, në mbrojtje të interesit tonë kombëtar ne mund të punojmë, pa trembur askënd..

*Ne duke ecur në pista europiane mund të rikrijojmë realitete ekonomike kombëtare konkurruese, prej të cilave nuk do të fitonin vetëm shqiptarët, por dhe popullsitë që jetojnë bashkë me ta, ose pranë tyre. **Fjala kyçe është heqja e barrierave kufitare, administrative, thyerja e tyre dhe shfrytëzimi i të gjithë kapaciteteve tona njerëzore, natyrore, politike në funksion të mirëqenies sonë kombëtare. Me fjalë të tjera krijimi i tregut të përbashkët kombëtar.***

Idenë e hapësirës së përbashkët e hodha për herë të parë në Parlamentin e Shqipërisë dhe ajo krijoi entuziazëm të madh te shumë intelektualë të shquar të hapësirës sonë. E diskutova idenë e këtij forumi me drejtuesit e UET-it, që kur isha këtu,

në mars, me veshjen e Presidentit të Kosovës, dhe jam tejet i nderuar që ata e pranuan patronatin tim për realizimin e tij.

Ne duhet të punojmë për Mirëqenien e kombit tonë.

Askush nuk mund të na pengojë për këtë.

Askush s'ka të drejtë të na pengojë për këtë.

Duke folur në frymë pozitive, më duhet të them se institucionet europiane ku ne duam të hyjmë, na nxisin të punojmë për këtë mirëqenie.

Në përputhje me modelet europiane, në mbrojtje të interesit tonë kombëtar ne mund të punojmë, pa trembur askënd..

Para disa muajsh falënderova Universitetin Europian për titullin *honoris causa* që më blatuan, dhe nënvizova: guri peshon më rëndë në vendin e vet.

Me këto fjalë doja të thosha, se pas udhëtimeve të shumta nëpër botë, si njeri i biznesit, kam kuptuar shumë *sesa i rëndësishëm është Atdheu*, por dhe kam kuptuar më shumë *sesi duhet të zhvillohet ai*. Atdheu për ne, është Kosova, është Shqipëria. Ne jemi një komb, ne kemi një Atdhe. Ne duhet të mendojmë së bashku për zhvillimin e tij. Kështu veç e veç jemi të vegjël, po edhe bashkë jemi gjithashtu të vegjël. Por më të fortë akoma!

GJENDJA E DY VENDEVE TONA

Janë disa fjalë kyçe, që të çojnë tek ideja e Mbrothësisë siç thonë në Jug të Shqipërisë, ose e Mirëqenies, si i thonë kudo ku jetojnë shqiptarët, termi që përdor Mjeshtri i fjalës dhe i ideve, Arbën Xhaferri.

Mbrothësia ose Mirëqenia kombëtare janë imperativ i kohës për klasën politike dhe intelektuale të dy vendeve.

-Ne sot jemi ndër shtetet më të varfra dhe të pazhvilluara të Europës.

-Me gjithë njëlloj diference pozitive të Shqipërisë, sa i takon të ardhurave për frymë, përqindja e popullsisë që jeton nën dyshtetë dhe varfërisë është thujse e njëjtë.

-Papunësia është njëlloj e lartë, duke u luhatur tek 30-50% nëse do t'i marrim për të sakta të dhënat e burimeve zyrtare statistikore.

-Ne jemi vende që nuk prodhojmë, ose prodhojmë fare pak.

-Ne jemi vende që po e braktisim traditën tonë të punimit të tokës, ndryshe nga fqinjët tanë, që e punojnë tokën disa herë më shumë sesa ne që e lemë djerrë.

-Ne jemi vende që blejmë më shumë sesa shesim, pra ne jemi vend që importojmë shumë më shumë sesa eksportojmë.

-Ne jemi të vetmet vende në Europë, megjithëse me rezervat ujore dhe të qymyrit më të mëdhatë për frymë popullsie, kemi vuajtur së bashku, nga kriza energjetike, megjithëse Shqipëria ka disa vite që është shkëputur prej saj.

-Ne jemi dy vende pa modele të qarta zhvillimi siç pohojnë këtu dhe atje autoritete të rëndësishme profesionale, si Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

-Ne nuk po identifikojmë dot prioritetet tona të zhvillimit.

-Ne nuk po mësojmë nga gabimet e të tjerëve.

Kjo situatë është dramatike. Ne e dimë si e kanë afirmuar profesorë të shquar, që do të referojnë në këtë konferencë, se pjesa më e madhe e problemeve të moszhvillimit janë për shkak të copëtimit nga fqinjët. Viset shqiptare para 1913-ës, përfaqësonin një unitet ekonomik dhe demografik të krahasueshëm me popujt e tjerë të rajonit; me grekët, me serbët, a me bullgarët.

SHIKIMI NGA E ARDHMJA

Por sot nuk dua të merrem me të kaluarën dhe të shoh brenda saj të metat tona apo fatkeqësitë historike.

Sot dua të shoh, me ndihmën tuaj, kah horizonti i të ardhmes. Për fat të mirë, aspiratat tona kombëtare, ëndrrat e patriotëve tanë të mëdhenj, nuk shkojnë kundër proceseve europiane në të cilat ne jemi kyçur.

Ne duke ecur në pista europiane mund të rikrijojmë realitete ekonomike kombëtare konkurruese, prej të cilave nuk do të fitonin vetëm shqiptarët, por dhe popullsitë që jetojnë bashkë me ta, ose pranë tyre.

Fjala kyçe është heqja e barrierave kufitare, administrative, thyerja e tyre dhe shfrytëzimi i të gjithë kapaciteteve tona njerëzore, natyrore, politike në funksion të mirëqenies sonë kombëtare.

Me fjalë të tjera krijimi i tregut të përbashkët kombëtar.

Krijimi i këtij tregu, në të gjitha elementet e tij, është parakusht i çdolloj integrimi kombëtar ose europian të shqiptarëve. Nga krijimi i këtij realiteti ekonomik të përbashkët, shqiptarët do të potenconin dhe epërsitë strategjike që kishin mbi popullsitë e tjera, për shkak të pozicionit gjeografik.

Si mund të arrihet kjo, pa vendosur kudo në hapësirën tonë kombëtare një sistem legjislativ europian?

Si mund të arrihet kjo pa standardizuar dijen, kulturën, universitetet?

A ka mundësi që ne të ngremë një sistem energjetik unik?

A e dini se nëse do të kishim ndërtuar prej kohësh një linjë interkoneksioni, dy sistemet tona energjetike do të krijonin mundësi që as Kosova, as Shqipëria të mos vuanin për energji, dhe madje të eksportnin?

A e dini se sikur të kishim krijuar një sistem unik, të menaxhuar sipas standardeve të njëjta,

duke shtuar burimet e prodhimit, do të kushtëzonim tregun

rajonat të energjisë? Kush na ka penguar ne të ndërtojmë një sistem të tillë?

Jam shumë i lumtur që më në fund, qeveria e sotme e Shqipërisë vendosi ndërtimin e kësaj linje, ashtu si dhe vendosi që të heqë çmimet e referencës për produktet e dy vendeve, një barrierë mjaft problematike doganore.

Më mirë vonë se kurrë.

ORIGJINA E ANGAZHIMIT TIM PËR TREGUN E PËRBASHKËT KOMBËTAR

Në këtë prezantimin unë thjesht po mundohem të hap disa pista për diskutimet e ardhshme.

Ndërkohë dua të sqaroj diçka personale, për atë se ku i ka rrënjët ky përkushtim i imi për këtë ide. Dua të qartësohet se ky përkushtim nuk është pasojë e ndonjë konvertimi tim politik në nacionalistin e orës së fundit. Përkundrazi.

Dua të kuptohet se pikërisht **kozmopolitizmi im jetësor**, profesional, ma ka forcuar dashurinë për atdheun, diçka që mund ta kuptojnë shumë mirë ata që jetojnë jashtë vendit.

Dua të jetë e qartë se pikërisht kjo lloj endje rrugëve të botës, tregjeve të saj, më bëri të shoh shumë më larg sesa miqtë e mi politikanë që nuk e kanë pasur këtë shans.

Pra, eksperiencia ime në biznesin ndërkombëtar më ka bindur prej kohësh për dobinë e këtyre ideve që do të diskutojmë sot.

-Shumë vite më parë në përpjekje për të ndihmuar Shqipërinë që ta kapërcente krizën energjetike të vitit 2005, i njoha potencialet e bashkimit të sistemeve tona energjetike dhe kundërshtarët e këtij bashkimi.

-Në vitin 2006, pikërisht duke identifikuar problemet ekonomike, si moment i rëndësishëm përbashkues i popujve të Ballkanit, themelova Fondacionin SEED, për zhvillimin e Europës Juglindore.

-Në vitin 2007 rashë në kontakt me idenë e zotit Xhaferri për

krijimin e një Komunuelthi shqiptar, një objektiv që ai e përsëriti dhe sot të rishikuar. Ishte një forum akademik si ky i sotmi, ku zoti Xhaferri plasoi idenë e tij, një forum ku shumë akademikë artikuluan shumë ide të ngjashme, por që qysh atëherë mbetën pa realizim.

-Kam reflektuar shumë për idenë e tregut, të cilën e kam afishuar me forcë të madhe në zgjedhjet e 2010-ës, anembanë Kosovës, dhe në Parlamentin e Shqipërisë, në mars të vitit 2011.

-Po punoj dhe sot në cilësinë e zëvendëskryeministrit, për jetësimin në praktikë të dy zonave të lira ekonomike në Mitrovicë dhe në Gjakovë. Janë këto dy zona prej të cilave do të fitojnë dy vendet tona, do të fitojnë shqiptarët, por dhe serbët. Ekonomia ofron të vetmet mundësi që të kapërcehet ndarja aktuale, që të thyhen kufijtë midis shqiptarëve, ose ata që janë vendosur në Mitrovicë. Unë kam pranuar ftesën e kryeministrit të Kosovës për të ndihmuar në nxitjen e investimeve të huaja dhe për shtimin e njohjeve në cilësinë e zëvendëskryeministrit. Ajo që po bëj, është ajo që di shumë mirë ta bëj dhe s'do ndalem kurrë.

-Unë do të ndryshoj rrënjësisht mënyrën e promovimit të Kosovës, pse jo dhe të Shqipërisë për t'i bërë tërheqëse për investimet e huaja, nëpërmjet reformimit të Agjencisë së Investimeve, por dhe duke modifikuar rrënjësisht Agjencinë e Privatizimit.

-Pasojat e aktivitetit të kësaj Agjencie në vite kanë qenë përgjithësisht negative në ekonominë dhe financat e trojeve tona, duke prodhuar varfëri, papunësi dhe duke zhvendosur burime financiare nga tregu i Kosovës në një destinacion, prej ku Kosovës do t'i duhet një kohë e gjatë për t'i përdorur.

Ne flasim shumë për partneritetin publiko privat PPP.

S'di si janë punët në Shqipëri, por në Kosovë s'ka asnjë shans që ky partneritet të funksionojë ashtu siç është menduar dhe tentohet nga dikush.

-Nga ky Forum, po i bëj thirrje klasës politike, në Kosovë dhe institucioneve në Shqipëri që në menaxhimin e aseteve, që kanë mbetur pa u privatizuar, të përdoret me efektivitet kjo formulë participimesh në biznese të përbashkëta.

Kjo mundëson që investitori të ndihet i sigurt, ndihmohet ai në krijimin e biznesit, të ndikohet pozitivisht në mirëqenie dhe punësim.

Kështu Kosovës do t'i mundësohet që paratë e privatizimit të mbeten në qarkullim në ekonominë e vendit dhe jo të ngurtësohen jashtë tij.

-Shteti do të tërhiqet nga partneriteti kur biznesi të fuqizohet, kur t'i shumëfishohet vlera dhe kur t'i kthehen më shumë para sesa ka harxhuar.

-Unë do të angazhohem fuqimisht që asetet tona minerare të mos trajtohen shkel e shko siç është deri më sot me burimet tona natyrore.

-Unë do mundohem së bashku me ekspertët e huaj që këto asete minerare të vlerësohen dhe të jenë pjesë përbërëse e brezave, panairëve ndërkombëtare. Në këtë angazhim do të përfshihen vetëm ekspertët me eksperiencë.

-Nga një qasje krijuese si kjo, mineralet si të tilla kanë shansin më të mirë që vlera e tyre të shumëfishohet. Ndërkohë krijohen mundësitë që aksionarë të tyre të mos jenë vetëm një person apo një kompani, por të jenë të hapura për **aksionariat publik.**

-Krijimi i holdingjeve të përbashkëta ndërshtetërore, ku të ruhet vlera dhe interesi i kompanisë, është një drejtim tjetër ku ne duhet të investojmë së bashku. Pra qoftë në Shqipëri, qoftë në Kosovë. Asetet minerare janë pasuri e kombit tonë.

- Në vend që Trepça e Kosovës të shitet për dhjetëra milionë për shkak të pamundësisë së buxhetit të vogël për ta funksionalizuar, ne do të ndërrojmë adresën e kompanisë menaxhuese duke e transferuar atë në qendrat më të rëndësishme financiare botërore. Atje ajo do të vendoset në kontakt me publikun. **Vlera e saj e shitjes nga dhjetëra milionët aktualë do të jetë miliardëshe.**

Bëj apel që kjo mënyrë privatizimi ose trajtimi duhet të përdoret urgjentisht dhe në Shqipëri për ato minerale që janë të dobishme jo vetëm për shqiptarët, por për mbarë botën.

-Jetësimi i parimit one stop shop, në trajtimin e investimeve të huaja, do të jetë imediat në punën time dhe të stafit tim.

-Reformat në sistemin gjyqësor janë jetike për investimet e huaja. Jam i njohur me problemet në procese të ndryshme këtu në Shqipëri dhe te ne, që zgjatin shumë dhjetëra vite; njerëzit e biznesit shantazhohen dhe dekurajohen.

Unë po e ndiej edhe vetë në Kosovë kohët e fundit këtë të keqe të madhe. Këto praktika të pranishme në vendet tona duhet të marrin fund sepse ato damkosin për keq vendet tona dhe mbyllin rrugët e zhvillimit.

KRIJIMI I SINERGJIVE KOMBËTARE

Sot jam shumë i lumtur se ideja e bashkimit ekonomik ka gjetur përkrahje të madhe në mjediset politike, në mjediset akademike, në mjediset e biznesit të kombit tonë në Prishtinë dhe në Tiranë.

Dua të falënderoj publikisht intelektualin e shquar, **Akademikun Rexhep Qosja, i cili me gjithë disa kritika për mua, kishte gjetur rastin të çmonte idetë e mia për bashkimin kombëtar që nisin nga ekonomia.**

Më tej akoma, **shumë mjedise intelektuale, OJQ-** kanë filluar të diskutojnë për idetë tona të intensifikimit të bashkëpunimit tonë kombëtar, të krijimit të tregut të përbashkët.

Makina kombëtare, tani është vënë në lëvizje prej energjive tona dhe askush nuk mund ta ndalë.

Pa dashur të zgjatem dua të them se përpara kemi shumë punë për të bërë. Unë jam i bindur se ky Forum do të vendosë piketa të rëndësishme për të ardhmen.

Në veprimtarinë time të biznesit unë jam udhëhequr nga

parimet. Sot në politikë dua të bëj të njëjtën gjë. Unë dua konkretësi në veprimtarinë time dhe jo shou.

Unë dua që idetë tuaja, puna ime, kontributi i miqve të mi të politikës dhe të biznesit të bashkohen në një fluks të përbashkët energjish, në një lëvizje qytetare, mbarëkombëtare, që t'ia nisë që sot e të punojë për realizimin e ideve tona përbashkuese.

Me bindjen se tash e tutje ky forum do të pasohet nga veprimtari konkrete, dua të shpreh bindjen se pjesëmarrësit në të, do t'i japin jetë kësaj nisme të re.

Gjatë punimeve *Karta e parimeve* të lëvizjes sonë do të jetë në tryezat tuaja dhe ju do ta nënshkruani për të nisur nga puna dhe për të lënë shenjat tona modeste në historinë moderne të kombit.

*Potenciali ekonomik i viseve shqiptare PARA copëtimit në vitin 1913**

Prof. Dr. Marenglen VERLI

Instituti i Historisë

Abstrakt. *Për të kuptuar më mirë potencialin e kësaj hapësire kemi shkuar pas në kohë, 10 vjet më parë, kur Shqipëria u coptua. U coptua bashkë me popullsinë dhe territorin, një unitet ekonomik, potencial që do ishte konkurreues me shumë kombe të tjerë në Ballkan.*

Potenciali ekonomik

Ndër elementet që tregojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi për potencialin ekonomik të një vendi dhe të banorëve të tij, janë pa dyshim *sipërfaqja e atij vendi, pozita gjeografike, sipërfaqja dhe cilësia e tokës bujqësore* (e lidhur kjo edhe me rrejetin hidrografik dhe klimën), *pasuritë e nëntokës, niveli i zhvillimit të infrastrukturës rrugore, përmasat e urbanizimit, struktura e degëve të ekonomisë, përmasat dhe bilanci i tregtisë së jashtme, standardi i jetesës, prodhimi dhe të ardhurat e përgjithshme, rezervat valutore, ose (në të kaluarën) rezerva e thesarisuar e monedhave të punuara nga metale të çmuara etj.* Natyrisht kanë peshë *numri i popullsisë, mosha mesatare e saj, arsimimi i saj, kualifikimi etj.*

* Referat i mbajtur në Forumin e organizuar nga Universiteti European i Tiranës, më 9 korrik 2011 me tematikën: Hapësira e përbashkët ekonomike shqiptare.

Nga një këndvështrim sado i përciptë del se potenciali ekonomik i viseve shqiptare në vitin 1912 ishte i konsiderueshëm dhe në disa aspekte superior, krahasuar me viset e tjera të Ballkanit osman dhe më gjerë. Le të shikojmë disa elemente të këtij potenciali.

Sipërfaqja dhe popullsia

Trojet shqiptare në vitin 1912, në prag të Shpalljes së Pavarësisë, shtriheshin të paktën në 55-60 mijë km² e, sipas disa autorëve, në 70-75 mijë km².¹

Në këto vise (pa llogaritur humbjet në fund të viteve 70 si pasojë e luftërave dhe e vendimeve të Kongresit të Berlinit), si edhe në vise të tjera periferike llogariteshin 1,5 – 2 milionë banorë. Në trojet shqiptare përveç popullsisë shumicë jetonin edhe pakica kombëtare, kryesisht serbe, maqedone e greke, të cilat numëronin rreth 200.000 banorë (Me ndarjen e kufijve më 1913 në Shqipërinë politike u përfshinë rreth 37000 pjesëtarë të pakicave kombëtare)².

Në kuadër të katër vilajeteve të cilësuar shqiptare, përkatësisht të Shkodrës, të Shkupit, të Manastirit dhe të Janinës, pa llogaritur Sanxhakun e Selfixhes në Vilajetin e Manastirit, që nuk kishte shqiptarë, në vitin 1912 jetonin 2.354.200 banorë, nga të cilët 1.452.000 ose 61,7% e gjithë popullsisë ishin shqiptarë. Shifrat e sipërpërmendura tregojnë se kombi shqiptar nga ana sasiore nuk dallohej nga kombet fqinje. Sipas të dhënave të kohës në fund të shek. XIX Bullgaria kishte 96 000 km² dhe 3,3 milionë banorë (bullgarë e jobullgarë), Serbia 48 000 km² dhe 2,37 milionë banorë, Greqia 65 000 km² dhe 2,4 milionë banorë (1/3 së paku arvanitë), kurse Mali i Zi 9 000 km² dhe 227 mijë banorë³.

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.I, Tiranë, 2002, f.35-36.

² Z. Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë 1984, f. 32. Popullsinë e Shqipërisë në fund të shek.XIX, e vlerëson 2 milionë banorë në 75.000 km²; *Historia e Shqipërisë*, vëll.II, Tiranë, 1984, f. 37; Po aty, vëll. III, f. 45-64.

³ Z. Shkodra, vep. e përm., f.32.

Pozita gjeografike

Trevat shqiptare kishin një pozicion shumë të favorshëm gjeografik në Ballkan. Ato kishin qenë gjithnjë ura lidhëse veçanërisht ndërmjet viseve perëndimore bregdetare me viset qendrore e jugore të Ballkanit e më gjerë. Ato kishin shërbyer për komunikimin njerëzor gjithfarësh, ekonomik, kulturor, politik etj., midis shqiptarëve dhe popujve a kombeve të tjera fqinje, me interes të ndërsjellë në shkëmbim të vlerave materiale e shpirtërore. Madje ato kishin shërbyer edhe si ndërlidhëse të popujve të tjerë të Ballkanit me Europën Perëndimore. Trevat shqiptare të pandara kishin mjaftueshëm vise me reliev të butë, pra fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore, vlera e së cilës ishte veçanërisht e lartë për shkak të rrejtimit hidrografik të dendur dhe të klimës së përshtatshme⁴. Njëherësh ky reliev ishte pa probleme edhe për mjetet e komunikimit ose të transportit të asaj kohe. Përmes tri korridoreve, ose linjave horizontale, prej shekujsh komunikohesh nga bregdeti Adriatik e Jon në brendësinë e Gadishullit⁵.

Përmes Tivarit-Ulqinit dhe Lezhës, Shkodra e fuqishme tregtare gjatë shek. XIX shkëmbente (duke ndjekur disa drejtime, por veçanërisht rrugën përgjatë Drinit) me Prizrenin dhe gjithë Kosovën, me rreze që shkonin, drejt Nishit e Tetovës dhe më tej. (Shkëputja e Ulqinit dhe e Tivarit, më 1878, por edhe e Sanxhakut të Nishit, ishte goditje fatale për rrugën e veriut. Sigurisht kishte edhe faktorë të tjerë që ndikuan negativisht, si hapja e rrugëve të reja të komunikimit rajonal e ndërkombëtar, rritja e pasigurisë etj.)

Drejtimi i dytë ishte Durrës-Elbasan, me bigëzimin Dibër-Ohër, më tej me zgjatimin drejt Manastirit etj., rrezja e të cilit

⁴ L. Mile, *Çështje të historisë agrare shqiptare*, Tiranë, 1984, f.269-284; R. Çavolli, *Gjeografia regionale e Kosovës*, Prishtinë, 1997, f.5-6.

⁵ Sh. Mema, *Shqipëria dhe shqiptarët në veprat e udhëtarëve anglezë*, Tiranë, 1988, f.176-193; D. Statovci, *Zhvillimi historik i zëjtarisë dhe rëndësia e saj bashkëkohore për strukturën ekonomiko-shoqërore të KSA të Kosovës*, Prishtinë, 1982, f.27, 111, 237, 253, 256; Z. Shkodra, *vep. e përm.*, f.165, 168, 213, 241-333 etj.

⁶ Kjo rrugë u shkurtua në vitin 1913 në mënyrë drastike, duke mbetur një arterie që vdiste në Qafën e Thanës.

shkonte deri në Bullgari⁶.

Drejtimi i tretë niste nga bregdeti i Çamërisë, me port kryesor Prevezën, dhe përfshinte Janinën, Korçën, Kosturin, Follorinën e më tej, me rreze përtej Thesalisë, duke pasur caqe të vetat Selanikun dhe Stambollin⁷.

Pas vitit 1874 ishte rritur komunikimi me drejtimin e ri vertikal veri-jugë përgjatë linjës hekurudhore Mitrovicë, Prishtinë, Ferizaj-Shkup, por ai nuk do të kompensonte shkatërrimin e korridoreve të sipërpërmendura lindje-perëndimi, dhe, madje, pas vitit 1913, do të ndikonte në copëtimin e tregut unik shqiptar.

Sipërfaqja bujqësore

Në vitin 1912 në trevat shqiptare, ende brenda kufijve të Perandorisë Osmane, llogariteshin si tokë bujqësore, kryesisht në pronësi të shqiptarëve, rreth 1 milion ha tokë, pa përfshirë këtu sipërfaqet në Serbi, Bosnjë e Thesali, pronësinë e të cilave shqiptarët e humbën pjesërisht qysh në gjysmën e parë të shek. XIX dhe sidomos pas ndryshimeve kufitare në fund të viteve 70 të shek.XIX, që, sipas të dhënave jo të drejtpërdrejta, duhet të

⁷ Ky korridor pësoi goditjen fatale në vitin 1913, kur jo vetëm u humbën skela, por edhe rruga nga Saranda drejt brendësisë, e ndërprerë nga kufiri, mbeti një segment qorr pa vijimësi deri në Korçë.

⁸ Është fjala për tokat në pronësi të shqiptarëve në Sanxhakun e Nishit, të aneksuara nga Serbia, si edhe për pasuri të tjera në viset që u përfshinë në kufijtë e Malit të Zi dhe të Greqisë, sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit. Llogaritjet janë të përafërta. (Shih: S. Brestovci, *Marrëdhëniet shqiptaro-serbo-malazeze (1830-1878)*, Prishtinë, 1983, f.47, 244 etj; S. Raça, *Marrëdhëniet shqiptaro-greke 1829-1881*, Prishtinë, 1990, f.227-247). Brenda Shqipërisë së pavarur të vitit 1913 mbetën afërsisht 350 mijë ha tokë bujqësore, ndërsa jashtë saj mbetën të paktën 2 herë më tepër. Vetëm në Kosovë, në kufijtë e saj të sotëm konvencionalë, gjendeshin rreth 400 mijë ha tokë bujqësore, në trevat e tjera shqiptare të përfshira në Serbi e në Mal të Zi (më pas në Jugosllavi) dhe në viset periferike ishin në pronësi të shqiptarëve edhe rreth 200 mijë ha të tjerë. Po kështu dhjetëra mijëra ha tokë bujqësore në pronësi të shqiptarëve ishin në Çamëri, në viset midis Janinës, Konicës, Kosturit, Follorinës etj. (Shih M.Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë 1918-1941*, Bon - Tiranë, 1992, f. 75; *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, 1984, f. 74 etj.)

kishin qenë diku midis 100-200 mijë hektarëve⁸.

Sipërfaqja bujqësore prej 1.000.000 ha kishte kapacitet të prodhonte, llogaritur me rendimentet e kohës (5 kv/ha) rreth 0,5 milion ton drithëra. Këto ishin të mjaftueshme për të ushqyer një popullsi prej 3-4 milionësh (sipas konsumit të atëhershëm të drithërave për banor), ose deri dyfishin e popullsisë së atëhershme. Ndonëse për shkak të përqindjes së konsiderueshme të djerrinave, veçanërisht të tokës në pronësinë çifligare (deri 50%), formë pronësie kjo që në viset shqiptare shtrihej në rreth 620 000 ha, shifra e prodhimit të drithërave e llogaritur potencialisht nuk realizohej, përsëri sasia e realizuar ishte e mjaftueshme për ushqimin e popullsisë në këto treva⁹.

Tokat bujqësore të shqiptarëve, në viset lindore, të cilat mbetën jashtë Shqipërisë, përgjithësisht ishin për kohën më të bonifikuarat dhe me vlera më të larta prodhuese. Sipërfaqet bujqësore në Kosovë, në Pollog dhe në viset e tjera ishin prodhuese drithi mbi nevojat e konsumit të viseve shqiptare. Me vlera eksportuese paraqitej edhe blegtoria dhe disa produkte të tjera të ekonomisë fshatare. Prodhimet e disa llojeve të frutave, ku veçohej molla, duhani etj., gjithashtu ishin të konsiderueshme¹⁰.

Rrjeti rrugor

Viset shqiptare kishin edhe potenciale të tjera me vlera ekonomike të mëdha. Në to ekzistonte një rrjet rrugor qerresh e karvanësh mjaft i plotë sipas parametrave të Ballkanit osman me mundësi përmirësimi të shpejtë (e favorizonte edhe terreni), kapacitete portuale e rrugëve detare, të rëndësishme dhe një linjë hekurudhore

⁹ *Historia e Shqipërisë*, vëll.III, Tiranë, 1984, f.67-69; M. Verli, *vep. e përm.*, f.21, etj.

¹⁰ *Po aty*; Shih edhe L. Mile, *vep. e përm.*, f.269, 275, 301, etj.

¹¹ *Historia e Shqipërisë*, vëll.III, Tiranë, 1984, f. 60-61; shih edhe: Sh. Mema, *vep. e përm.*, etj. Jashtë kufijve mbetën rreth 2 600 km. Gjatë Luftës së Parë Botërore vetëm brenda 28 mijë km² të shtetit shqiptar, ku mbizotëronte një terren mjaft i thyer malor në krahasim me viset e copëtuara. Ushtritë pushtuese patën mundësi të improvizonin rreth 1 000 km rrugë për nevojat e tyre, madje edhe një rrjet dekovili prej 350 km.

që ngjitej nga Shkupi e deri në Mitrovicë, e cila kalonte përmes viseve shqiptare. Vetëm rrugë qerresh të shndërrueshme lehtësisht në trase për automobila llogaritet të kenë qenë mbi 4000 km.¹¹

Qytetet

Në vitin 1913 në trevat shqiptare numëroheshin 56 qendra urbane nga të cilat 32 konsideroheshin qytete të rëndësishme. Me një popullsi prej 352 mijë banorësh, qytetet kishin një rol me rëndësi në zhvillimin ekonomiko-social e kulturor të vendit.¹²

Qendrat kryesore të 3 ndër 4 vilajetet shqiptare, përkatësisht Shkupi, Manastiri dhe Janina, edhe pse me popullsi mjaft të përzier, si popullsi të parë kishin shqiptarët. Këto qendra banoheshin në masën mbi 50% nga shqiptarët, si në rastin e Shkupit, ose ata ishin të pranishëm më shumë se çdo popullsi tjetër, si në Manastir dhe në Janinë. Shqiptarët gjithashtu ishin pronarët kryesorë, ose kishin në duar në një masë të madhe ekonominë e këtyre qyteteve¹³.

Në bregdetin shqiptar ishin të rëndësishme edhe kapacitetet portuale. Ende pa u copëtuar trevat shqiptare funksiononin 22 skela e limane. Sipas dokumentacionit të kohës, në shek. XIX skelat kryesore ishin Tivari, Ulqini, Lezha, Shëngjini, Durrësi, Kavaja, Vlora, Porto Palermo, Saranda, Preveza, Salahora (Arta), Gumenica, gjithashtu Valdanosi (gji në veri të Ulqinit), gjiri i Kruçit, Porto Milena, Oboti, Vivari i Butrinit, Sajadha, Spalanca, Katakto etj.¹⁴

¹² Z. Shkodra, *vep. e përm.*, f.165, 200, 274, 299; *Historia e Shqipërisë*, vëll.II, f. 39. Në viset e copëtuara gjendeshin 25 nga 56 qendrat urbane ose 46% e tyre (16 ndër 32 qytetet më të rëndësishme), rreth gjysma e popullsisë qytetare (51%).

¹³ Z. Shkodra, *vep. e përm.*, f.34.

¹⁴ *Po aty*, f. 200, 274, 299, 315 etj; Shih edhe R. Rexha, *Ulqini prej themelimit deri më 1918*, në "Kosova", Prishtinë, 1976, nr.5, f.209; A. Viquesnel, *Voyage dans la Turquie d'Europe*, vëll.I, Paris, 1868, f.343. Jashtë kufijve të Shqipërisë mbetën 12 nga 22 skela e limane, që përbaltonin 2/3 e lëvizjes tregtare (rreth 30 milionë franga). Disa nga këto skela, ndoshta 6, si Tivari, Ulqini e Salahora (Arta) etj., ishin humbur qysh në vitet 70 të shek.XIX. Të tjera si Preveza, e cila bënte dyfishin e xhiros së gjithë porteve shqiptare jugore, humbën në vitin 1913. Sipas prof. Z.Shkodrës në vitin 1912 lëvizja e jashtme tregtare e disa skelave arrinte në rreth 50 milionë fr.

Nga ky bilanc sado i përciptë del qartë se në viset shqiptare *tregu i përbashkët kombëtar*, ishte i konsoliduar gjatë gjysmës së parë të shek.XIX e në lulëzim deri në vitet 60-70, por madje me shumë peshë në rajon edhe më pas, me gjithë goditjet që pësoi pas hapjes së linjave të reja të komunikimit rajonal e më gjerë, siç ishte vënia në punë e Kanalit të Suezit (1869) dhe ndërtimi i hekurudhës Selanik-Mitrovicë (1874). Pasojat e shkaktuara nga hapja e korridoreve të reja të lëvizjes së mallrave, bashkë me thellimin e rënies së gjithanshme të Perandorisë Osmane dhe të rritjes së pasigurisë për çdo biznes të kohës, ndikuan në çrregullimin e drejtimeve të vjetra të tregtisë dhe pakësuan vlerat portuale të bregdetit shqiptar, si edhe tregtinë tranzite të trevave shqiptare që kishte aty bazën e nisjes.

Në viset shqiptare kishte edhe kapacitete të konsiderueshme prodhuese. Në periudhën e fundit të sundimit osman ishin regjistruar 16 921 njësi vezejtaro-tregtare, (8548 njësi mbetën jashtë kufirit, ku ushtroheshin rreth 80 zeje, si edhe rreth 50 ndërmarrje industriale, nga të cilat Shkupi me 20 njësi të tilla dhe Shkodra me 12-15 njësi, kishin rol udhëheqës në drejtimin e ri të ekonomisë. Qytete si Prishtina me 5-6 njësi, Tetova me 2 dhe me mbi 20 punishte manufakture, Ulqini me kantieret për anije, Preveza, Elbasani etj., me nga një njësi, sidoqoftë rreshtoheshin pas tyre)¹⁵.

Ndonëse në prodhimin e ekonomisë së qytetit mbizotëronin zejet e përpunimit të metaleve, kryesisht për objekte me funksione zbukurimi ose përdorimi vetjak, përpunimi i lëkurëve, veshjet dhe produktet ushqimore, këto degë siguronin të ardhura të konsiderueshme në kuadrin e gjithë degëve të ekonomisë.

¹⁵ Z. Shkodra, *vep. e përm.*, f.92 (80 zeje), 158 (40-50 njësi), 200; *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, f.47. Sipas këtij botimi në vitin 1913 në Shqipëri kishte 33 ndërmarrje prodhimi mbi baza kapitaliste. K. Prifti, *Lidhja Pejës*, Tiranë, 1984, f.45, 47; Shih edhe D. Statovci, *vep. e përm.*, f.293 etj; Sh. Rahimi, *Vilajeti i Kosovës*, Beograd, 1969, f.34-35. D. Zografski, *Razvoitak na kapitalističkite elementi vo Makedonija za vreme na turskoto vladenje*, Skopje, 1967, f.525; T. Abdyli, *Industria e Kosovës*, Prishtinë, 1978, f.83; *Mitrovica dhe rrethina*, Mitrovicë, 1979, f.103; R. Abdyli, *Gjendja dhe pozita e klasës punëtore në Kosovë (1918-1941)*, Prishtinë, 1986, f.27; M. Verli, *Ekonomia e Kosovës dhe vargonjtë e politikës Jugosllave*, Tiranë, 2000, f.26-29 etj.

Administrimi osman në këtë kohë pengonte zhvillimin e ekonomisë dhe ngadalësoi mjaft hapat që qenë hedhur në fillim të shek.XIX, kur në pashallëqet e mëdha, me politikë më racionale dhe veçanërisht me shpenzimin në vend të të ardhurave kryesore të vjela nga tatimet, u arritën të tilla maja, sa që p.sh. Shkodra të kishte 40 000 banorë, Prizreni 25 000 banorë etj., (të cilat mbetën po aq edhe pas një shekulli), ndërkohë që Beogradi dhe Athina ishin mjaft më të vogla, përkatësisht 25.000 dhe 9.000 banorë (6.000 ishin arvanitë)¹⁶.

Sipas prof. Zija Shkodrës në fillim të shek. XX, Shkodra vazhdonte të kishte 40 000 banorë dhe 2 500 dyqane, Prizreni 30 000 banorë dhe 1 427 dyqane, Gjakova 12 000 banorë dhe 1 000 dyqane, Peja 15 000 banorë dhe 660 dyqane, Vushtria 3 600 banorë dhe 130 dyqane, Prishtina 12 000 banorë dhe 512 dyqane, Tetova 9 750 banorë dhe 573 dyqane, Dibra 11 000 banorë dhe 462 dyqane, Ohri 16 000 banorë dhe 510 dyqane, Lezha 4 000 banorë dhe 127 dyqane, Durrësi 5 000 banorë dhe 321 dyqane, Kavaja 5 000 banorë dhe 447 dyqane, Tirana 15 000 banorë dhe 700 dyqane, Elbasani 11 000 banorë dhe 800 dyqane, Korça 13 000 banorë dhe 800 dyqane, Berati 15 000 banorë dhe 1 000 dyqane, Vlora 7 000 banorë dhe 242 dyqane, Gjirokastra 12 000 banorë dhe 410 dyqane, Janina 18 000 banorë dhe 1 300 dyqane, Preveza 8 000 banorë dhe 180 dyqane, Mitrovica 3 500 banorë dhe 365 dyqane, Struga 3 550 banorë dhe 236 dyqane etj.¹⁷

Por edhe pse dhjetëvjeçarët e fundit i kishin shtuar problemet për shqiptarët dhe koniunkturat ndërkombëtare ekonomiko-politike kishin ndikuar negativisht duke frenuar ritmet e zhvillimit, edhe pse struktura e degëve të ekonomisë nuk ishte më bashkëkohore, edhe pse bilanci i tregtisë së jashtme nga portet shqiptare erdhi duke u bërë gjithnjë e më pasiv dhe në shpenzimet e jetesës së popullsisë ndikonin dukshëm

¹⁶ *Historia e Shqipërisë*, vëll.III, Tiranë, 1984, f.47.

¹⁷ *Z. Shkodra, vep. e përm.*, f. 200.

¹⁸ Po aty. Në vitet 1912 në SHBA llogaritet të kenë jetuar rreth 50 000 shqiptarë.

dërgesat e emigrantëve (në 1912 rreth 14-16 milionë franga) ose pjesërisht konsumi i monedhave të arta të thesarisuara etj., përsëri potenciali ekonomik i viseve shqiptare mbetet i konsiderueshëm¹⁸. Mund të thuhet pa dyshim se trevat e copëtuara më 1913-ën ishin pjesa më e begatë e viseve shqiptare sipas parametrave të kohës¹⁹.

Pasuritë minerale

Ndër begatitë e sipërpërmendura nuk janë llogaritur pasuritë minerale nëntokësore të viseve shqiptare. Në këtë kohë shfrytëzohej vetëm sera e Selenicës dhe kromet në Rrafshin e Siriniqit. Vlera e pasurive minerale të viseve shqiptare, posaçërisht të Kosovës dhe të viseve të tjera të shkëputura nga shteti shqiptar u çmua pak më vonë. Rezervat energjetike të këtyre viseve, me bazën e tyre në Kosovë (100 000 000 tonelata linjit, sipas vlerësimeve të viteve 70 të shek.XX), gjithashtu polimetalet me bazë plumb-zinkun, kromitet etj., etj., të cilat kanë përbërë 50-60% e më shumë të rezervave të Federatës Jugosllave për këto pasuri të nëntokës, treguan se viset shqiptare të shkëputura arbitrarisht në vitin 1913 dhe veçanërisht Kosova ishin dhe u vlerësuan si trevat me nëntokën më të pasur në Ballkanin Qendror e Perëndimor dhe një ndër rajonet më të pasura të Europës e të Botës²⁰. Potenciali i shtetit shqiptar në kromite, bakër, hekur-nikel, naftë etj., të cilat u vunë në shfrytëzim veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XX, janë të njohura.²¹

¹⁹ R. Çavolli, *Gjeografia regionale e Kosovës*, Prishtinë, 1997, f.33-34, 68; M. Verli, *vep. e përm.*, Tiranë, 2000, f.15-29 etj.

²⁰ *Po aty*; Shih edhe T. Abdyli, *vep. e përm.*; *Kosova nekad i danas - Kosova dikur dhe sot*, Tiranë, 1985, Zëri "Kosova"; M. Limani, *Politika Ekonomike*, Prishtinë, 1994; M. Roux, *Les albanais en Yugoslavie*, Paris, 1992; I. Gusia, *Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik të KSA të Kosovës*, Prishtinë, 1982; A. Jakupi, *Finalizimi dimension i strategjisë së zhvillimit të ekonomisë së Kosovës*, Prishtinë, 1985 etj.

²¹ *Anuari Statistikor i RPSH*, 1960; I. Fishta, M. Ziu, *Historia e Ekonomisë së Shqipërisë, 1944-1960*, Tiranë, 2004 etj.

Tatimet

Për potencialin ekonomik të viseve shqiptare do të dëshmonte edhe sasia e tatimeve që mbliidhte administrata osmane. Në mesin e viteve 90-të të shek.XIX, nga taksat themelore të shtetit në vilajetin e Janinës (527 000 banorë) nxirreshin 28,5 milionë groshë (vetëm 8 milionë shpenzoheshin në vend) në vilajetin e Manastirit (840 000 banorë) 46,7 milionë groshë (9,7 milionë shpenzoheshin në vend), në vilajetin e Kosovës (1 milion banorë) 53 milionë groshë (43 milionë shpenzoheshin në vend), kurse në vilajetin e Shkodrës (300 mijë banorë) vetëm 4,3 milionë groshë (1,7 milion shpenzoheshin në vend) Në total mbliidheshin rreth 130 milionë grosh, nga të cilat në vend shpenzoheshin më pak se gjysma (62,4 milionë grosh)²².

Sikurse shihet në viset shqiptare siguroheshin edhe në këtë aspekt mjete të mjaftueshme monetare për të financuar zhvillimin nëse këto mjete do të investoheshin të gjitha në vend në mënyrë racionale.

Thesaret monetare

Së fundi për begatinë e viseve të shkëputura dëshmon edhe sasia e monedhave të thesarisuara, që në kushte zhvillimi normal do të ishte një kapital i mirë për investime. Për fat të keq, në mungesë edhe në këtë rast të të dhënave, duhet të përdorim llogaritje jo të drejtpërdrejta që vlerësojnë edhe treguesit e tjerë ekonomikë të njohur. Vetëm në Shqipërinë e pavarur më 1922, pikërisht pas 15 vjet destabiliteti e luftërash të egra, ekonomisti i Lidhjes së Kombeve, Alber Kalme, ka vlerësuar ekzistencën e 60-100 milionë fr. në gjendje monedhash me vlerë²³. Mund të arsyetohet se në vitin 1912 shifra ka qenë më e madhe. E njëjta situatë duhet pranuar edhe për Kosovën dhe për viset e tjera të

²² K. Prifti, *Lidhja e Pejës*, Tiranë, 1984, f.58.

²³ *Historia e Shqipërisë*, vëll.III, Tiranë, 1984; Shih edhe: *E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë, 1990; *Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual*, Tiranë, 1996; *Shqiptarët e Maqedonisë*, Shkup, 1992 etj.

copëtuara. Për shifrat e monedhave që gjendeshin atje në duart e popullsisë vetëm mund të hamendësohet, por sidoqoftë ato s'kanë qenë kurrë më të vogla sesa në Shqipërinë e vitit 1913.

Pasojat e copëtimit

Copëtimi i vitit 1912 ka qenë fatal për kombin shqiptar. Dëmet dhe pasojat negative ishin të rënda në të dy krahët e kufijve: *Kombi shqiptar në tërësi* humbi troje, njerëz, vlera ekonomike; u dobësua në peshën e tij politike e ushtarake etj., dhe u rrezikua qenia e tij. Atij iu prish tregu unik, iu ulën dukshëm ritmet e zhvillimit ekonomik, u bë argat i tipit kolonial ndaj fuqive të ndryshme, nën ndikimin ose nën pushtimin e të cilëve hyri (Itali, Serbi)²⁴. Për pasojë u desh të përballohej një konsum i madh energjish dhe mjetesh që të sigurohej vetëm qenia e tij dhe rrjedhimisht mbeti në një prapambetje dhe varfëri të dhimbshme.

Në këtë kuadër *shteti shqiptar* u izolua ekonomikisht. Duke mos pasur më pozitën e bazës së tranzitit tregtar me Ballkanin Qendror, ai nuk kishte më mundësinë e akumulimit të mëparshëm të kapitalit, të thithjes së teknologjisë, të përvojës etj., etj., që të zhvillonte me parametrat normalë të kohës industrinë dhe degët e tjera prioritare ekonomike me rentabilitet. Shqipërisë iu krijuan probleme deri për ushqimin e popullsisë (sigurohej vetëm 50-70% e ushqimeve), madje iu pakësua ndjeshëm edhe fondi blegtoral i trashëguar. (P.sh. Luma nga rreth 500 000 bagëti të imëta që kishte në vitin 1912, për shkak të humbjes së bazës kullimore dimërore në vitin 1939 mbarështonte vetëm 50 000 krerë)²⁵.

Veçanërisht pas vitit 1912 në gjendje izolimi të thellë mbetën viset malore lindore të Shqipërisë.

Shteti i cunguar shqiptar gjithashtu humbi dy nga tri korridoret

²⁴ *Historiku i Qarkut të Kukësit* (broshurë), Kukës, 1981.

²⁵ M. Verli, *vep. e përzm.*, Bon-Tiranë, 1992, f.143 etj.

horizontale të komunikimit me viset e tjera të Ballkanit e më tej dhe iu rrëgjua i treti që niste nga Durrësi.

Edhe më tepër probleme patën *viset shqiptare të aneksuara*. Politika specifike shoviniste e njohur, solli atje shpronësime masive në pronësinë agrare, por jo vetëm agrare... (të mos ndalemi në shpronësimin e 381 000 ha, gjatë viteve 1918-1941 në viset shqiptare veriore e lindore të përfshira në Jugosllavi, nga të cilat 192 000 vetëm në Kosovë etj)²⁶. Varfërimi i shqiptarëve me çdo mjet, me trysni, dhunë, tatime e lloj-lloj arbitraritetesh u bë për gati një shekull politikë zyrtare e Beogradit dhe e Athinës për viset përkatëse të aneksuara²⁷.

Shpërngulja ishte një element tjetër i politikës së sipërpërmendur, që zvogëloi ndjeshëm popullsinë shqiptare në ato vise dhe forcat e saj prodhuese (300 000 të shpërngulur deri në LDB dhe me gjithë të dëbuarit e Sanxhakut të Nishit ishin rreth 1 milion deri në vitin 1966). Me këtë rast nga popullsia aktive e vendit humbën mijëra zejtarë, tregtarë etj., si edhe profesionistë të vyer. Vise të tëra periferike u *spastruan etnikisht*. Shembujt janë të shumtë. Dukshëm ndryshoi edhe struktura etnike e qyteteve shqiptare²⁸.

Pasojë tjetër e copëtimit për Kosovën dhe për viset e tjera shqiptare lindore ishte humbja e porteve detare të përdorura tradicionalisht dhe integrimi i dhunshëm i tyre sipas interesave të pushtetmbajtësve sllavë, çka jo vetëm solli humbje ekonomike të pallogaritshme, por edhe filloi të *strukturojë ekonominë në degë*, që, kur u bë bilanci i 90 vjetëve që pasuan, doli të kishin qenë *jorentabël*²⁹. Qytetet

²⁶ M. Verli, vep. e përm., Bon-Tiranë, 1992, f.143 etj.

²⁷ Po aty; A. Kotini, Çamëria denoncon, Tiranë, 2002; M. Vickers, Çështja çame, Prishtinë, 2002; Dokumente për Çamërinë, Tiranë, 1999 etj.

²⁸ H. Bajrami, Rrethanat politike e shoqërore në Kosovë 1918-1941, Prishtinë, 1981; Z. Shtylla, Aspekte të politikës së shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Kosova në vitet 1936-1941, "Studime historike", Tiranë, 1990, nr.3 etj.

²⁹ M. Roux, vep. e përm., Paris, 1992; M. Limani, vep. e përm., Prishtinë, 1994; M. Verli, vep. e përm., Tiranë, 2000 etj.

³⁰ Po aty.

e kufizuara artificialisht nga trevat e veta tradicionale ekonomike, si p.sh. qytetet e Rrafshit të Dukagjinit, Dibra etj., kaluan disa dhjetëvjeçarë rënie ekonomike³⁰. Pasuria e popullsisë shqiptare në to, por edhe përgjithësisht në viset e copëtuara, në mënyra të ndryshme u shkri masivisht deri në nivelin e rezervave monetare. Psikoza e pasigurisë hoqi edhe dëshirën për investime, çka çoi në thellimin e dallimeve me fqinjët. Shqiptarët nën sundimin e huaj u kthyen në popullsi të dorës së dytë. Ata ishin paracaktuar për t'iu nënshtruar dhunës shekullore shkombëtarizuese, për të mbetur prapa në fushën e *arsimit e të kulturës* kombëtare.

Të gjithakëto, që natyrisht lidhen me politikë në institucionalizuar shtetërore të Beogradit dhe të Athinës, sollën edhe acarimin e marrëdhënieve nacionale, me pasoja të ndërsjella në dëm të stabilitetit, të mirëkuptimit e të bashkëpunimit ballkanik.

Përfundimi

Nëse do të ishte realizuar pavarësia për të gjithë kombin shqiptar, do të ishin krijuar mundësi të mëdha përparimi. Një shembull jo të plotë patën dhënë dy pashallëqet e mëdha, gati autonome, rreth një shekull më parë. Vetëm vendosja e rendit dhe e sigurisë dhe shpenzimi në vend i shumicës së të ardhurave të realizuara, patën dhënë aso kohe arritje të dukshme. Është e qartë se potencialet ekonomike si komb i kemi. Është detyrë e qarqeve drejtuese kombëtare, kudo në viset ku jetojnë shqiptarët, t'i rikthejnë elementet e munguara që shtrojnë rrugën e integritetit dhe të zhvillimit ekonomik, arsimor, kulturor etj. Natyrshëm ky është i vetmi drejtim që çon në plotësimin e aspiratave kombëtare.

Madje, në kuadër të integritetit rajonale e europiane, shqiptarët kanë koncepte të qarta se duhet synuar më gjerë se tregu kombëtar i përbashkët, që do të përmbledhte një territor relativisht të kufizuar me një popullsi prej 6 - 7 milionë banorësh, ose bashkë me fqinjët e afërt një treg rreth

15 milionë banorë. Tregu rajonal ballkanik, me rreth 60-70 milionë banorë e më gjerë tregu europian, janë caqe që domosdoshmërisht duhen synuar dhe llogaritur pa vonesë në strategjinë e zhvillimit për të ardhmen e afërt.

Të veprojmë si një treg i përbashkët

Nikolin JAKA

Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë

Abstrakt. *Është momenti i duhur që ne të shfrytëzojmë mundësitë dhe potencialet tona nga pikëpamja ekonomike. Tashmë Shqipëria dhe Kosova nuk mund të konsiderohen si një treg i vogël, por një portë e rajonit tonë. Në kohën e ekonomisë globale, kur kriza ekonomike është ende e pranishme, duhen parë të gjitha mundësitë që ne të operojmë në një treg të përbashkët. Në rrafshin ekonomik dhe tregtar, marrëdhëniet e biznesit shqiptar dhe atij të Kosovës kanë ardhur duke u rritur; por kërkesat tona të përbashkëta janë për më shumë, ndaj duhet të intensifikojmë punën tonë në këtë drejtim.*

E kam përmendur vazhdimisht faktin që në krye të shtetit të Kosovës për aq kohë sa ishte president zoti Pacolli, takimin e parë që ai bëri jashtë dverve të presidencës, ishte ai në Tiranën zyrtare dhe veçanërisht me sipërmarrjen. Kjo është dëshmi e qartë se iniciativa e tij si një sipërmarrës është një garanci më shumë që marrëdhëniet tona të kenë një dimension real dhe kujdesi i tij për të riardhur sërish, pas kaq pak kohësh në një aktivitet të tillë, na inkurajon në atë që ne prisnim, në nuhatjen dhe përkujdesjen e tij për t'i çuar iniciativat deri në fund. Është momenti i duhur që ne të shfrytëzojmë mundësitë dhe

potencialet tona nga pikëpamja ekonomike. Tashmë Shqipëria dhe Kosova nuk mund të konsiderohen si një treg i vogël, por një portë e rajonit tonë. Në kohën e ekonomisë globale, kur kriza ekonomike është ende e pranishme, duhen parë të gjitha mundësitë që ne të operojmë në një treg të përbashkët.

1. Nevoja e një tregu të unifikuar do të thotë më shumë kapitale të mbledhura bashkë, më të qartë në investime, dhe më me perspektivë zhvilluese të qëndrueshme.

Përpyekja për të unifikuar tregun duhet të jetë një nga përparësitë e qeverive tona, pasi biznesi i ka paraprirë në investimet që po bën dhe ajo çfarë do të sugjeroja është jo vetëm mbajtja e forumeve të tilla në evidentimin e potencialeve, por një bindje konkrete që kjo është më e mira që mund të bëjmë.

2. Ka qenë një problem i deritanishëm referenca doganore, shqetësim i ngritur prej kohësh nga Oda e Kosovës, por që tashmë së fundmi ka marrë një zgjidhje dhe kjo besoj do të jetë një pengesë më pak për të shkuar drejt një tregu të përbashkët.

3. Shtrirja e biznesit shqiptar në tregun e Kosovës ka qenë një iniciativë e hershme, që para shpalljes së pavarësisë. Kjo shtrirje tashmë ka ardhur duke u zgjeruar në sektorë të rëndësishëm si në ndërtim, banka ose kompani sigurimesh. Mendoj që ka ardhur koha që dhe sipërmarrësit e Kosovës të jenë më të pranishëm në tregun tonë.

4. Turizmi është një mundësi më shumë për të bashkëpunuar. Rruga e re e cila ka ngushtuar diferencën fizike, është një mundësi shumë e mirë jo vetëm në drejtim të turizmit, që vetëm këtë vit kur ende sezoni turistik është i hapur ka 37 për qind më shumë turistë se një vit më parë.

Jam i bindur se bregdeti shqiptar i Jonit dhe ai i Adriatikut përbëjnë një destinacion turistik më se të favorshëm për shqiptarët e Kosovës ose të Maqedonisë, të cilët e kanë zgjedhur këtë prej vitesh.

Për një popull dhe dy shtete, me mundësi të mëdha të trans-

portit rrugor, shkëmbimet ekonomike duhet të njohin një dimension të ri. Prandaj ne duhet të intensifikojmë përpjekjet dhe të gjejmë format që kjo situatë të ndryshojë në sensin pozitiv. Në rrafshin ekonomik dhe tregtar, marrëdhëniet e biznesit shqiptar dhe atij të Kosovës kanë ardhur duke u rritur; por kërkesat tona të përbashkëta janë për më shumë, ndaj duhet të intensifikojmë punën tonë në këtë drejtim.

Të dyja shtetet tona janë përfshirë prej kohësh në rrugën e reformave dhe të integrimit euro-atlantik. Dhomat e Tregtisë dhe të Industrisë, si përfaqësuese të interesave të gjera të organizatave të biznesit dhe të sipërmarrjes, kanë luajtur dhe do të luajnë një rol të rëndësishëm në të gjitha këto zhvillime. Ato kanë inkurajuar intensifikimin e këtyre marrëdhënieve të shëndetshme, po ashtu kanë promovuar në mënyrë reciproke bizneset e të dyja vendeve tona.

Objektivat tonë janë ambiciozë; ne po punojmë dhe po bashkëpunojmë fort për nxitjen dhe për mbrojtjen e sipërmarrjeve private respektive. Dhomat e Tregtisë janë pjesë e qenësishme e të gjitha përpjekjeve për zhvillimin ekonomik të vendeve tona, si dhe për integrimin e tyre në komunitetin europian. Ne do të vazhdojnë të kontribuojnë fuqishëm për integrimin e plotë të vendeve, bizneseve dhe shoqërive tona në Bashkimin Europian, në aleancën e madhe të kapitalit dhe të demokracisë.

Koha e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri

Safet GËRXHALIU, MA

Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, Universiteti FAMA

Abstrakt. *Ka ardhur koha që bashkëpunimi ekonomik në mes të Kosovës dhe Shqipërisë të dalë nga hija e marrëdhënieve politike dhe të bëhet në të ardhmen një nga shtyllat kryesore të marrëdhënieve të përgjithshme në mes të dyja shteteve vëllazërore.*

Më të drejtë të plotë politika ka dominuar në marrëdhëniet pas rënies së mini -Murit të Berlinit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë sepse ekzistonte nevoja që të kompensohet në njëfarë mënyre mungesa gati gjysmëshekullore e komunikimit të mirëfilltë politik në mes të dy krahëve të një korpusi të njëjtë kombëtar. Politika i ka përcaktuar në mënyrë vendimtare marrëdhëniet tona në 11 vjetët e fundit edhe për shkak të betejës së Kosovës për zgjidhjen përfundimtare të statusit të saj politik, ku Shqipëria ka dhënë kontribut të çmuar.

Por, pa i dëmtuar marrëdhëniet e shkëlqyera politike, ka ardhur koha që të dyja vende të shfrytëzojnë afërsinë e tyre që është unike për Europën dhe të fillojnë të krijojnë modelin e bashkëpunimit ekonomik, ku këmbimi i thjeshtë tregtar, që për një vit kaq shumë modeste prej 65 milionë eurosh, në të dyja drejtimet të zëvendësohet me një bashkëpunim të strukturuar dhe komplementar, dobiprurës për të dyja palët.

Bashkëpunimi i ardhshëm ekonomik në mes të Kosovës dhe Shqipërisë nuk mund të ndërtohet sikur deri më tani mbi bazat e folklorizmit apo romantizmit që shpeshherë karakterizojnë marrëdhëniet tona politike. Nuk do të jemi as seriozë para Europës dhe nuk do të jemi as të përgjegjshëm para qytetarëve tanë nëse mendojmë se harmonia gati idilike politike në mes të Prishtinës dhe Tiranës vetvetiu mjafton për adresimin e sfidave në bashkëpunimin ekonomik mes Kosovës dhe Shqipërisë ose vetvetiu mjafton në përcaktimin e modelit bashkëkohor për bashkëpunimin ekonomik në mes të dyja vendeve në të ardhmen. Ka ardhur koha që pragmatizmi ekonomik duhet të zërë vendin e parë pranë politikës, pranë kulturës, pranë edukimit dhe fushave të tjera ku kemi shënuar progres marramendës në marrëdhënie tona bilaterale. Ka ardhur koha që ekonomia tani t'i japë ritëm e të përcaktojë kualitet, të ndikojë në mënyrë të rëndësishme në imazhin e veçantë të marrëdhënieve tona të përgjithshme.

Kjo është arsyeja përse Oda Ekonomike e Kosovës i propozon Odës simotër në Tiranë si dhe institucioneve të tjera relevante krijimin e elaboratit, strategjisë ose platformës për ngritjen dhe avancimin e bashkëpunimit ekonomik mes Kosovës dhe Shqipërisë për një afat të mesëm dhe të gjatë, me të cilin do të paraqitemi pranë qeverive dhe parlamenteve tona respektive. Kosova ka interes që një strategji e tillë të bëhet sa më shpejtë e mundur.

Kosova ka interes që në një strategji të tillë të inkuadrojë së pari vendosjen e parimit të barazisë mes bizneseve, pra qasjen e papenguar të tyre nga njëri vend në tjetrin, që do të thotë heqjen e pengesave administrative që favorizojnë njërin dhe e dekurajojnë biznesin tjetër.

Eliminimi i barrierave të tilla do të krijonte hapësirë për gërshetimin e ekonomive tona. Do të inkurajonte këmbimin e përvojave. Do të krijonte kushte për bashkërenditjen e dy ekonomive komplementare duke u mundësuar plane të

përbashkëta biznesi dhe prodhimi për paraqitje të përbashkët në tregun rajonal.

Do të mundësonte që Kosova dhe Shqipëria të paraqiten jo veç e veç, por me ofertat e përbashkëta për të ashtuquajturat punë “loon” që përbëjnë një nga mënyrat më të mira për tejkalimin e problemit të papunësisë në të dyja anët e kufirit. Dhe në fund, një zhvillim më i hovshëm i bashkëpunimit tonë ekonomik do të hapte mundësinë që Kosova përmes Shqipërisë të krijojë qasje edhe në fonde të BE-së që u ofrohen secilit vend që e aspiron anëtarësimin në familjen europiane.

Arritjen e një shkalle të tillë të lartë të bashkëpunimit ekonomik e mundëson tani edhe ndërtimi grandioz i autostradës Durrës – Morinë dhe fillimi i ndërtimit të autostradës Morinë – Prishtinë. Nuk guxojmë të lejojmë që kjo derë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë -- gjerësisht e hapur për të parën herë në historinë e tyre -- të shfrytëzohet maksimalisht vetëm për tre muaj, gjatë sezonit turistik.

Ka ardhur koha tani që ekonomitë komplementare të të dyja vendeve tona të njihen dhe të përputhen mes vete, që secila prej tyre të gjejë interesin e mirëfilltë në anën tjetër të kufirit, që të dyja të gjejnë gjuhën e përbashkët dhe të ndihmojnë njëra-tjetrën në depërtimin në tregun e jashtëm dhe në pozicionimin e ri strategjik në rajon.

Koha për nisma dhe aksione konkrete në kuadër të integrimit rajonal edhe evropian

Alfred MOISIU

Ish-President i Shqipërisë

Abstrakt. *Nuk na duhet të qëndrojmë më në kuadrin e diskutimeve, deri-diku teorike, për bashkimin shpirtëror dhe kulturor etnik e kombëtar, por ka ardhur koha e materializimit të këtij bashkimi duke ndërmarrë një bashkim konkret ekonomik, si një hap i parë dhe shumë i rëndësishëm, përmes lehtësimit të tregtisë mes vendeve tona. Tashmë mund të shkojmë edhe më përpara në këtë rrugë duke hequr të gjitha barrierat tregtare, duke eliminuar çdo pengesë tarifore, doganore, e të çfarëdo lloji tjetër, në funksion të rritjes së kontaktit ekonomik dhe zhvillimit të ndërsjellë.*

Në fund të viteve 1980-të në revistën *Shkenca dhe Jeta*, më rastisi të lexoja me mjaft interes një artikull të një mikut tim të vjetër dhe shokut të dikurshëm të klasës, Zef Rakacolli, mbi ndërtimin e një traseje në aksin e Veriut, që do të lidhte Kosovën me Shqipërinë. Ajo ravijëzohej pikërisht në aksin ku sot është ndërtuar Rruga e Kombit, që lidh dy vendet tona. Sot, diskutojmë në këtë Forum për Hapësirën e Përbashkët Ekonomike Shqiptare, nën kujdesin e ish-Presidentit të

Kosovës, z. Pacolli, dhe në praninë e personaliteteve më të larta si institucionale ashtu dhe akademike e ekonomike, për të rrahur mendime e për të diskutuar më konkretisht për mundësitë e thellimit të integritit ekonomik të kësaj hapësire. Kjo është gjë e munguar në pjesën më të madhe të shekullit të njëzetë, por vitet e fundit proceset integruese ekonomike dhe jo vetëm, kanë përshpejtuar hapin e tyre e po bëhen gjithnjë e më të vrullshme. Sigurisht, sot ndodhemi në një moment kyç historik, me sfida të mëdha përpara për të gjithë hapësirën shqiptare, një moment i duhur kohor për të ndërmarrë nisma dhe aksione konkrete në kuadër të integritit të mëtejshëm jo vetëm rajonal, por edhe europian. Në të vërtetë nuk na duhet të qëndrojmë më në kuadrin e diskutimeve, deri-diku teorike, për bashkimin shpirtëror dhe kulturor etnik e kombëtar, por ka ardhur koha e materializimit të këtij bashkimi duke ndërmarrë një bashkim konkret ekonomik, si një hap i parë dhe shumë i rëndësishëm, përmes lehtësimit të tregtisë mes vendeve tona. Tashmë mund të shkojmë edhe më përpara në këtë rrugë duke hequr të gjitha barrierat tregtare, duke eliminuar çdo pengesë tarifore, doganore, e të çfarëdo lloji tjetër, në funksion të rritjes së kontaktit ekonomik dhe zhvillimit të ndërsjellë.

Sigurisht që kombi shqiptar nuk mund të pretendojë se është i izoluar, apo se kjo nismë duhet të mbetet vetëm shqiptare. Mbi të gjitha, iniciativa të tilla i shërbejnë zhvillimit të gjithë rajonit. Korridoret e komunikimit, akset ndërshtetërore rrugore u shërbejnë të gjithë popujve të Ballkanit dhe më gjerë. Prej rritjes së aksesit në portet shqiptare nuk përfitojnë vetëm kosovarët, por edhe serbët, maqedonasit, apo popuj të tjerë. Bashkëpunimi rajonal ekonomik, tregtar dhe financiar ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e Shqipërisë gjatë gjithë periudhës historike postdiktatoriale. Kjo frymë e gjerë bashkëpunimi duhet vendosur pa mëdyshje në kuadrin e përpjekjeve të të gjithë shqiptarëve të rajonit për të përparuar

në proceset e tyre integruese drejt Bashkimit European. Së fundmi, më lejoni t'i referohem një artikulli të lexuar para pak kohësh në një revistë shkencore historike ruse ku pasqyroheshin diskutimet në Dumën Ruse, në vitin e largët 1912, thuajse një shekull më parë. Gjatë diskutimeve, deputetë të ndryshëm rusë paraqisnin qëndrimet e tyre mbi daljen e Serbisë në det, si një nevojë strategjike jetike për këtë shtet. Sipas tyre duhej që Serbia të kishte akses në një port të madh. Si të tillë ata identifikuan Durrësin. Sigurisht që pjesa më e madhe e konflikteve të shekullit të njëzetë në Ballkan ka qenë edhe për garantimin e akseve të tilla gjeostrategjike të shteteve të rajonit.

Sa i takon rëndësisë strategjike të hapësirës shqiptare duket se historia po ripërsëritet. Por kësaj here në një mënyrë shumë paqësore. Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ekonomik, tregtar e financiar, duke eliminuar të gjitha barrierat tregtare, mund të përfitojnë të gjithë, mund të shpresojnë të gjithë, jo vetëm shqiptarët, dhe mund të hedhim sytë drejt së ardhmes me më pak dyshim te njëri-tjetri.

Sigurisht që zhvillimi ekonomik, duke qenë parësor për çdo vend, me siguri do të ndihmojë për të rritur mirëkuptimin dhe nevojën e bashkëpunimit midis vendeve të rajonit, pavarësisht nga historitë e hidhura të së kaluarës. Ka ardhur koha të shikojmë përpara dhe të mendojmë më shumë për brezat e rij.

Të realizojmë vetintegrimin tonë kombëtar si pasqyrim të zhvillimeve aktuale globale

Rexhep MEIDANI

Ish-President i Shqipërisë

Abstrakt. Nëse integrimi politik-territorial ose bashkimi juridik-administrativ nuk varen shumë nga mjedisi shqiptar, ka aspekte të tjera të unifikimit dhe ndërveprimit kombëtar, që varen përgjithësisht prej nesh, nga energjitë dhe vullneti, nga mendja dhe veprimi ynë. Këto aspekte bashkim-bashkëpunimi mund të thellohen në vazhdimësi, të përmirësohen më tej ose të zgjerohen në fusha të tjera tepër të rëndësishme për jetën tonë kombëtare, shpirtërore e materiale, në shërbim të zhvillimit dhe jetës së qytetarit, standardit të saj.

E vlerësoj këtë iniciativë të Universitetit “European” të Tiranës dhe Universitetit “Fama” të Prishtinës, të organizuar si një forum debati e rrahje mendimesh, me temë të propozuar nga z. Pacolli; “Për një hapësirë të përbashkët ekonomike shqiptare Shqipëri-Kosovë. Çfarë lloj bashkimi?”, synon të rrokë disa çështje thelbësore të ndërveprimit, të lidhura ngushtë edhe me perspektivën tonë europiane, në kushtet e një procesi të pritshëm integrimi. Jo për t’u trajtuar vetëm me “gjuhën”

e politikës, por, mbi të gjitha, të një analize profesionale të gjithanshme ekonomike, diplomatike, juridike, kulturore, etj. Sa më larg radikalizmit pseudo-nacionalist dhe sa më afër thelbit e realitetit konkret! Aq më tepër, që nëpërmjet procesit të integritit europian, në shumë aspekte, ne synojmë të realizojmë edhe vetintegrimin tonë kombëtar, si pasqyrim edhe të zhvillimeve aktuale globale.

Në botën e sotme gjithnjë e më të ndërvarur, mjaft çështje që më parë konsiderohesh si tabu ose si çështje të brendshme të një vendi, kanë marrë sot një përmasë ndërkombëtare në rritje. Pikërisht, reflektimi i kësaj përmasë ka qenë edhe arritja e lirisë dhe e pavarësisë së Kosovës. Gjithashtu, kooperimi në kohë reale në politikën ndërkombëtare po bëhet gjithnjë dhe më i fuqishëm. Krahas çështjeve të ekonomisë e tregtisë, mjaft probleme të klimës e të mjedisit, ato mbi emigracionin, shëndetin, edukimin, etj. po koordinohen gjithnjë e më mirë në nivel rajonal e ndërkombëtar. Ndikimi i internetit po bëhet më tërësor në ushtrimin e fuqisë, në të gjitha fushat, përfshirë dhe cilësinë konkrete të qeverisjes. Madje, teknologjitë e komunikimit dhe media sociale po revolucionarizojnë ditaditës bashkëpunimin midis politikës e qytetarëve.

Parë me këtë sy, në këtë botë gjithnjë e më globale, shtetet nuk janë, si më parë, të vetmit aktorë në lojë. Aktorë joshtetërorë si: OJQ-të, grupet etnike, organizimet e tyre në diasporë, organizatat qeveritare ndërkombëtare, struktura të kompozuar nga përfaqësues shtetërorë (si, p.sh., OKB-ja, NATO-ja, BE-ja, etj.), organizatat joqeveritare ndërkombëtare (INGO), aktorët mbikombëtarë me një përfaqësim jo patjetër zyrtar (Kryqi i Kuq, Amnistia Ndërkombëtare; etj.), korporatat multinacionale, firmat ekonomike të shtrira në mjaft shtete, etj. po bëhen çdo ditë gjithnjë e më të forta dhe politikisht me mjaft influencë. Po ashtu, edhe vetë sistemi ndërkombëtar, dikur anarkik, është duke u sistemuar gradualisht me një mori mekanizmash, rregullash

e normash, të miratuara së bashku. Pikërisht, në një botë të tillë, ku tregtia, investimet, turizmi dhe komunikimi i afrojnë gjithnjë e më tepër vendet dhe njerëzit, po bëhet i detyrueshëm një korrelacion shumë më i mirë forcash, procesesh e faktorësh kombëtarë e ndërkombëtarë. Tepër të rëndësishme po bëhen a) proceset demokratike që lidhen me legjitimitetin në realizimin e interesave kombëtare; b) me legjislacionin ndërkombëtar në trajtimin e konflikteve brenda “dizajnit” ligjor-institucional dhe ndërtimit të konsensusit; c) me diplomacinë “transformuese” e pjesëmarrëse ose me kontributin e qytetarëve “diplomatë”, jashtë kanaleve zyrtare të negocimit, etj...

Pikërisht, faktorë të tillë duhen konsideruar seriozisht edhe në procesin tonë të integritit kombëtar. Për më tepër, që këto gjëra nuk janë më të reja. Veçse me një këndvështrim global, mund të arrihen dhe rezultate kombëtare! E thënë shkurt, sot, “duhet menduar në mënyrë globale dhe vepruar në mënyrë lokale”! Pikërisht, në këtë kuadër global të menduari, duhet azhurnuar aksioni lokal, i cili nuk duhet të “intimitohet” as nga radikalizmi, as nga euforia, as nga ngazëllimi folklorik. Në sajë të padrejtësive historike, një aksion i tillë lokal mbetet për shqiptarët unifikimi i mëtejshëm në kuptimin e bashkim-integritit kombëtar, edhe pse, në një kuptim tradicional, një proces i tillë, bile deri vonë, ka nënkuptuar përgjithësisht bashkim territoresh në rrafshin juridik dhe të banorëve të tyre (me lidhje gjaku, gjuhe, historie, tradite, konfesionit, etj.) në rrafshin qeverisës. Ky i fundit, si një komplet i integruar institucionesh të hartimit dhe zbatimit të ligjit, mishëron sovranitetin e brendshëm. Është po ai, që, nga ana tjetër, mundëson njohjen e këtij sovraniteti prej shteteve të tjera, pra sovranitetin e jashtëm, që në rastin e Kosovës duhet të mbetet një nga përparësitë e aksionit kombëtar. E thënë më thjesht, vetë shteti është një entitet politik e gjeopolitik, kurse kombi është një entitet kulturor (dhe/ose etnik), që së bashku mishërojnë të ashtuquajturin shtet-komb. Pikërisht, procesi i globalizimit po prek aktualisht vetë thelbin tradicional të këtij konceptimi.

Edhe kultura, në kushtet e sotme, po shfaqet jo vetëm si objektiv ose qëllim, por dhe si mjet. Aspekti i parë nënkupton traditën dhe historinë, dhe të gjitha produktet: materiale, sociale ose shpirtërore të lidhura me to, përfshirë dhe mitet, këngët e ngjarjet, të transferuara brez pas brezi. Pra, gjithçka që sendërtan kombin si të tërë. Kjo lloj kulture bën veçimin, duke u shndërruar kështu në një instrument të fuqishëm në mbrojtje të unitetit kombëtar. Këtë fatmirësisht e kemi dhe duhet ta ruajmë sa më shumë! Ndryshe prej saj, “kultura si mjet” është një instrument i fuqishëm në favor të globalizimit që, në një mënyrë ose në tjetrën, ushqen homogjenizimin, edhe për fatin e keq të popujve të vegjël. Është ky lloj instrumenti që po thyen kufijtë, që hedh poshtë muret e lashta të traditës kombëtare. Proklamimi i prodhimeve të ndryshme, në të gjitha fushat, shfrytëzimi ose konsumi universal i tyre është shembulli më kuptimplotë i saj. Akoma më shqetësuese, në rrafshin kombëtar, është “fuqia” e saj për të krijuar qëndrime e pozicionime, opinione, sjellje e rregulla globale...

Pas këtij shtjellimi, qoftë dhe sipërfaqësor, të konceptimit të sotëm të disa aspekteve të ndryshimit brenda binomit: sovranitet - ndërvarësi, për ne ende sot, si çështje thelbësore mbetet po ajo e një shekulli më parë – çështja kombëtare. Si do të çohet më tej kjo çështje në përputhje me situatat dhe kushtet e reja të epokës së globalizimit? Si mund të realizohet bashkimi kombëtar në situata të tilla? A mund të mbyllet, në një fazë të dytë, procesi i integritetit dhe i vetintegritetit me plotësimin e aspiratës historike të një bashkimi të mirëfilltë kombëtar? Cilat janë probabilitetet e saj të kalimit nga mundësia në realitet? Madje, edhe duke pasur parasysh faktin, që në kuptimin e kësaj asperate, një pengesë kohore në vetvete krijon shpërndarja territoriale te popullsisë shqiptare ose shpërngulje me forcë e saj, që në thelbin e saj nënkupton ndryshim kufijsh - tabu kjo e pagëlltitshme në pjesën vendimmarrëse të bashkësisë

ndërkombëtare. Ndryshe kjo nga ndonjë perspektivë bashkimi politik Kosovë-Shqipëri, si shtet unitar apo federal, brenda një BE-je gjithnjë dhe më të institucionalizuar. Megjithatë, edhe në këtë rast, nuk është aq e lehtë t'i japësh përgjigje kësaj pyetje. Sepse gjithçka varet shumë nga konceptimi i drejtë dhe aksioni konkret i sotëm, por dhe vullneti politik dhe gjykimi qytetar në territoret shqiptare, ecuria e proceseve demokratike qeverisëse, krahas projeksionit politik perspektiv të vetë BE-së, në perfeksionimin e organizimit administrativ të saj si një entitet me pamje federale. Në fund të fundit, edhe përbërja, reagimi e ndryshimet, pamjet konkrete të fuqisë janë të lidhura ngushtë me politika e skenarë të ndryshëm në realitete konkrete lokale, kombëtare e ndërkombëtare. Sidoqoftë, arritja apo shtimi i çdo lloj fuqie, kudo në botë, nuk është pa kosto, përfshirë dhe fitimin e një fuqie të pamerituar...

Sidoqoftë, për sendërtimin e aspiratës sonë, qoftë dhe si frymëzim, duhen përshpejtuar detyrimisht disa hapa që, pa u realizuar në kohë, mund të provokojnë vonesa ose të prodhojnë dëme me kosto të lartë. Veçanërisht për t'i riparuar ato në një periudhë të dytë! Prandaj, një çështje e parë, me peshë themelore, pas çlirimit të Kosovës dhe pavarësisht të saj, është njohja e mëtejshme e Kosovës si shtet i pavarur dhe anëtarësimi i saj në të gjitha organizatat e vendeve sovraane, jo vetëm në OKB, NATO, BE, por dhe në struktura të tjera si OSBE-ja, Këshilli i Europës, etj. Për këtë, në forumet ballkanike, çfarëdo qofshin ato, Shqipëria dhe të deleguarit e saj duhet të refuzojnë ose nuk duhet të pranojnë më tej shmangien e Kosovës nga përfaqësime të tilla, për "hatrin" e Serbisë! Madje, duhet aktivizuar i gjithë lobingu proshqiptar, por dhe duhet vënë në lëvizje çdo ingranazh i diplomacisë kombëtare shqiptare për të mos lejuar qoftë dhe prirjet minimale të ndonjë favorizimi mbi procesin e integritimit europian të Serbisë, pa u bashkëshoqëruar ai me ecurinë paralele si të Shqipërisë, ashtu dhe të Kosovës.

Kjo është tepër serioze, madje çdo mbyllje sysh në këtë proces mund të rezultojë tepër e rrezikshme!...

Nëse integrimi politik-territorial ose bashkimi juridik-administrativ nuk varen shumë nga mjedisi shqiptar, ka aspekte të tjera të unifikimit dhe ndërveprimit kombëtar, që varen përgjithësisht prej nesh, nga energjitë dhe vullneti, nga mendja dhe veprimi ynë. Këto aspekte bashkim-bashkëpunimi mund të thellohen në vazhdimësi, të përmirësohen më tej ose të zgjerohen në fusha të tjera tepër të rëndësishme për jetën tonë kombëtare, shpirtërore e materiale, në shërbim të zhvillimit dhe jetës së qytetarit, standardit të saj. Kjo nuk do të thotë se është bërë deri tani shumë pak, përkundrazi, por situatat e sotme e bëjnë këtë avancim të gjithanshëm, shumë më të domosdoshëm. Duke ditur se shumica e aspekteve politike-diplomatike, ekonomike-doganore, kulturore-edukative, etj., të këtij bashkimi, pra dhe e ndërveprimit të gjithanshëm midis shqiptarëve, do të analizohen në referimet pasuese, unë po tentoj të rreshtoj këtu thjesht disa prej tyre. Po e nis me idenë e funksionimit të një hapësire të përbashkët ekonomike shqiptare. Apo të një veprimtarie konvergjente në fushën e politikës së jashtme e diplomacisë, deri duke shfrytëzuar një infrastrukturë materiale të njëjtë, si në rastin e infrastrukturës kufitare “europiane” Shqipëri – Mal i Zi, në Sukubinë - Muriqan. Po aq e rëndësishme është dhe domosdoshmëria e hapjes dhe e zgjerimit të tregjeve, e rritjes së hapësirave të veprimit ekonomik e financiar, jo thjesht atyre territoriale, por dhe atyre njerëzore, të kapitaleve, të investimeve, të shërbimeve, të luftës së përbashkët kundër krimit ekonomik e financiar, etj.

Duhet të shtohen mbështetjet shtetërore ose nxitjet e biznesit privat në veprimtari të përbashkëta, përfshirë dhe ato komplementare e kompensuese. Në këtë optikë, po aq i rëndësishëm është bashkëveprimi legjislativ e ekzekutiv, dhe, mbi të gjitha, ndërveprimi midis parlamenteve, dikastereve, institucioneve të pavarura, p.sh. gjykatave e prokurorive, përf-

shirë dhe gjykatat kushtetuese, i strukturave “ndërmjetëse”, p.sh. e dhomave të tregtisë dhe industrisë, i bizneseve të të njëjtit profil; realizimi i projekteve të ndryshme infrastrukturore, sidomos i korridoreve të transportit, me bashkim kapitalësh dhe ekspertize. Aty, një rol të veçantë duhet të marrë kooperimi energjetik, deri në unifikimin e tij nëpërmjet diversifikimit, por dhe komplementaritetit hidro - termo. Tepër i rëndësishëm mbetet shkollimi sa më i përafërt, pse jo dhe i njëjtë në sistemin publik, në nivelin parauniversitar ose universitar, me programe e botime të përbashkëta, shkëmbime pedagogësh, praktika e vizita të ndërsjella, bursa shkollimi, veprimtari shkencore në fushën e mësimdhënies, etj. Më tepër intensitet e përkrahje kërkohet dhe për veprimtaritë letrare; duhet të nxiten më tej aktivitetet kulturore të përbashkëta, festivalet, shfaqjet e ndryshme, prodhimi i filmave artistikë shqiptarë me fonde të përbashkëta, shtimi i panairove të librave, i veprimtarive sportive, etj. Gjithashtu, duhet të zgjerohen veprimtaritë e përbashkëta akademike, projektet kërkimore-shkencore në fusha të ndryshme, në radhë të parë në fushën e albanologjisë, etj. Por, pa lënë mënjanë unifikimin e mjaft shërbimeve, sipas bazës materiale dhe ekspertizës, përfshirë dhe ato laboratorike (mjedisore, shëndetësore, radiologjike, kriminalistike, etj.). Edhe pse nuk mungojnë arritjet, vëmendje kërkon dhe media e shkruar ose elektronike, rritja e bashkëveprimit midis gazetarëve, në transmetimin dhe cilësinë e informacionit, të verifikimit të tij, etj. Nuk mund të mos përmend këtu dhe shoqërinë civile që ka arritur të kapërcejë mjaft barriera të dikurshme, madje duke arritur të realizojë organizime gjithëshqiptare me zë në fusha të ndryshme. Kjo edhe pse mbështetjet financiare për to kanë mbetur ende të varfra nga strukturat shtetërore ose nga bizneset përkatëse.

Kjo gamë e gjithanshme bashkëpunim-unifikimi është krejtësisht në dorën tonë. Ajo përbën dhe thelbin e pamjes konkrete të bashkëpunimit mbarëshqiptar të sotëm dhe të së

ardhmes së afërt. Veçse, një pamje e tillë duhet zhvilluar e përpunuar më tej në të gjitha drejtimet. Madje, në këtë kuptim, çdo rezultat pozitiv ndërveprues në aspektet e përmendura më sipër, ose dhe në fusha të tjera të reja (ende të paprekura), i shërben jo vetëm fuqizimit të zërit shqiptar në rajon e në botë, por dhe zhvillimit të gjithanshëm mbarëkombëtar, vetë procesit të mirëfilltë të bashkimit kombëtar, që nëpërmjet integritetit europian, mund të arrijë të sendërtojë edhe cilësi të reja territoriale vetintegruese.

Zhvillimi i barabartë dhe i gjithanshëm i të gjitha pjesëve të kombit, nxit aspiratat për zhvillim, bashkëpunim dhe integrim

Prof.Dr.Faik BRESTOVCI

Rektor i Universitetit "FAMA"

Abstrakt. *Bashkëpunimi i të gjitha pjesëve të kombit është mundësuar sidomos kohët e fundit kur janë hequr pengesat objektive dhe subjektive që kanë ekzistuar me shekuj të tërë. Tani varet vetem nga se në cilën mënyrë dhe në cilën kohë do të bëhemi një, në të gjitha aspektet e shoqërisë moderne.*

Dëshiroj sukses në punën e shenjtë që ka për qëllim të fundit krijimin e kushteve për bashkim mbarëkombëtar. Kjo ide e krijuar nga baballarët e kombit shqiptar mund të realizohet në të ardhmen vetëm nëse angazhohen me seriozitetin më të madh të gjitha potencialet njerëzore dhe ekonomike të të gjithë shqiptarëve kudo që janë. Sidomos është i nevojshëm angazhimi i forcave intelektuale të cilat janë në zhvillim e rritje të vazhdueshme si në aspektin kuantitativ, ashtu dhe në atë kualitativ. Në trojet tona numërojmë me dhjetra Universitete në të cilat studjojnë me qindra mijëra studentë dhe mijëra pedagog me grada shkencore më të larta. Kjo është një forcë e

cila është në gjendje të kontribojë në zhvillimin e vazhdueshëm të ekonomisë, arësimit, kulturës, shëndetësisë, etj. pa të cilin nuk mund të ketë mireqenie të popullit. Zhvillimi i barabartë dhe i gjithanshëm i të gjitha pjesëve të kombit, nxit aspiratat për zhvillim të mëtutjeshëm, për bashkëpunim dhe integrim.

Bashkëpunimi i të gjitha pjesëve të kombit është mundësuar sidomos kohët e fundit kur janë hequr pengesat objektive dhe subjektive që kanë ekzistuar me shekuj të tërë. Tani varet vetëm nga se në cilën mënyrë dhe në cilën kohë do të bëhemi **një**, në të gjitha aspektet e shoqërisë moderne. Janë duke u hequr të gjitha barrierat që i pengonin kontaktet, lidhjet dhe bashkëpunimin në të gjitha lëmitë e jetës dhe punës së pjesëve të një kombi unik. Është koha kur duhet të angazhohemi të gjithë për krijimin e një tregu unik, e një hapsirë arsimore unike e një hapsirë unike kulturore, sportive etj. Ndërtimi i urave të bashkëpunimit gjithpërfshirës, ndërtimi rrugëve që i lidhin të gjitha pjesët e kombit, ndërtimi i hekurudhave që i përshkojnë të gjitha viset shqiptare është kusht i domosdoshëm pa të cilin nuk ka kontakte dhe bashkëpunim e as njëjtësim të ekonomisë e kulturës dhe arsimit të një populli.

Është i rëndësishëm sidomos bashkëpunimi i Universiteteve të cilat ekzistojnë në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni. Bashkëpunimi midis tyre në lëminë mësimore dhe shkencore krijon kushte për zhvillim të gjithanshëm të shoqërisë. Bashkëpunimi në këtë fushë të jetës e punës e ka nismën që nga fundi i viteve të gjashtëdhjeta, kur u nënshkrua “ Protokoli për Bashkëpunim” midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës. Qysh atëherë, me dhjetra pedagog të dy universiteteve bashkëpunonin në mbajtje të leksioneve, për hulumtime shkencore, për konsultime, etj. Edhe tekstet universitare të njëjta shfrytëzoheshin, atje e këtu. Bashkëpunimi në fjalë ka qenë i vazhdueshëm dhe pa ndërprerje. Bashkëpunimi i universiteteve në të ardhmen do të jetë edhe më i plotë dhe i gjithanshëm dhe shumë më masiv e më i dobishëm për të gjithë.

Krijimi i hapësirës unike të arësimit të lartë në tokat tona është obligim që del edhe nga standardet e Kartes së Bolonjës me të cilën parashihet përafrimi i plan-programeve të universiteteve të Evropës, lëvisshmëria e studentëve dhe e pedagogëve dhe e punëtorëve shkencor. Këto standarte mund të realizohen në universitetet tona sikurse me anë të marrëveshjeve bilaterale ashtu edhe me anë të marrëveshjeve multilaterale.

Nevoja e unifikimit të programeve arsimore, legjislacionit arsimor, etj.

Prof.dr. Shpresa HOXHA

Kryetare e Institutit "ALB-SHKENCA – Prishtinë"

Abstrakt. *Nevojë fundamentale sot është unifikimi i planprogrameve mësimore, duke filluar nga ai fillor e deri te studimet e larta. E shoh të domosdoshme të apeloj imperativin e thellimit të bashkëpunimit në të gjitha sferat shoqërore, duhet filluar para së gjithash në fushën e arsimit, kulturës, shkencave mjekësore, për ta vijuar në kuadrin e bashkëpunimit juridik dhe ekonomik në veçanti.*

Shqipëria dhe Kosova, një trung i ndarë në dysh, me një popull dhe me një gjuhë kaluan në etapa të ndryshme shoqërore, politike, ekonomike dhe zhvillimore.

Kundrejt të gjitha sfidave, me të cilat u ballafaquan, populli ynë ia doli të ruajë mëvetësinë, duke ruajtur gjuhën para së gjithash tutje Alpeve shqiptare dhe sidomos ta ushqejë ndjenjën e bashkëpunimit, sado modeste të ketë qenë ajo.

Në sajë të bashkëpunimit të ndërsjellë Kosova gjithnjë u ndihmua nga Shqipëria, mbi të gjitha me hapjen e shkollave të para shqipe në Kosovën e vitit 1941, duke arsimuar pishtarët e arsimit kosovar dhe së fundi duke sjellë kuadrot arsimore nga Ministria e Arsimit të Shqipërisë, me Profesor Ernest

Koliqin në ballë. Në këtë drejtim një ndihmesë e shënuar ishte edhe botimi i *Abetares* shqipe që në vitet e para të pasçlirimit. Ndërkaq pas një heshtjeje të detyrueshme prej mëse dy dekadash, nga viti 1968-të, dëshmitare e këtij viti jam edhe unë, zuri fill bashkëpunimi i fuqishëm në planin e unifikimit të gjuhës letrare shqipe nga të dy anët e kufirit, arritje kjo shumë e madhe për kombin shqiptar.

Me themelimin e Universitetit të Prishtinës më 1970, ky tempull i dijes u ndihmua me mësimdhënës të shquar, në shumë fusha studimesh, duke filluar nga ato themelore e deri te studimet e magjistraturës dhe të tezave të doktoratës. Literatura shqipe dhe botime të tjera të ndryshme, të dërguara nga Shqipëria pasuruan bibliotekat tona, institucione këto të varfra me libra të gjuhës shqipe. Edhe pse me pengesa të shumta, qëllimi kryesor u arrit në saje të mbështetjes vëllazërore nga shteti amë.

Sot, kur fatin e kemi në duart tona, mundësitë për një bashkëpunim të mirëfilltë janë mëse të përafërta. Kemi “Rrugën e Kombit”, e cila na afron edhe më tepër duke mundësuar bashkëpunim më të lehtë dhe pa dyshim shumë të efektshëm në të gjitha sferat e jetës.

Nevojë fundamentale sot është unifikimi i planprogrameve mësimore, duke filluar nga ai fillor e deri te studimet e larta. Janë bërë hapat e parë për një *Abetare* të përbashkët dhe besojmë të finalizohen me sukses në një të ardhme të afërt, si edhe për tekstet e niveleve të tjera arsimore.

Bashkëpunimi ndërinstitutional është bërë edhe nëpërmes konferencave të ndryshme, sesioneve shkencore, tryezave të rumbullakëta, seminareve, etj. Një prej tyre është edhe Instituti “ALB-SHKENCA” i themeluar në tri qendra: Tiranë-Prishtinë-Shkup, organizatë kjo, jofitimprurëse me 10 seksione shkencore, ku marrin pjesë studiues të ndryshëm, të punësuar në qendra të ndryshme arsimore-shkencore të botës. IASH-ja sivjet organizon Takimin VI të radhës më 1-4 shtator 2011 në Prishtinë - Kosovë me një pjesëmarrje masive me rreth

750 studiues shqiptarë dhe të huaj. Takimet tona kanë për qëllim paraqitjen dhe njohjen e arritjeve shkencore të fushave të ndryshme studimore, më tej shkëmbimin e përvojave, si dhe mundësinë e afrimit dhe të thellimit të bashkëpunimit në mesin e studiuesve shqiptarë. Përveç 10 konferencave të parapara priten të mbahen edhe tryeza shkencore dhe kurse të fushave të ndryshme në mjediset e Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik të Prishtinës. Me këtë rast presim të mblidhen në kryeqytetin e Kosovës anëtarët e rregullt të IASH-it, shkencëtarë nga qendra të ndryshme universitare shqiptare dhe nga diaspora, studentë e dashamirë të shkencës për të marrë pjesë në konferenca gjithnjë në përputhje me interesimin e tyre shkencor. Kështu në takimet vjetore krijohen kontakte profesionale ndërmjet shkencëtarëve të profileve të ndryshme prej një interesi të përbashkët, duke prezantuar rezultate afirmative dhe këmbim njohurish shkencore.

Punimet e paraqitura të takimit fillimisht prezantohen në përmbledhje dhe më pas në ato origjinale, të formatizuara sipas shablonit të dhënë dhe kriterëve të tjera të mbështetura në përvojën shkencore. Ato botohen në revistën AKTET në disa vëllime.

Dorëshkrimet e paraqitura vlerësohen për përmbajtjen e tyre nga recensentët më të kualifikuar të disiplinave përkatëse shkencore, të cilëve nuk i dihet emri i autorit. Dhe krejt në fund, punimet e pranuar i dërgohen Redaksisë së revistës për botim. Nga e gjithë kjo që u tha, e shoh të domosdoshme të apeloj imperativin e thellimit të bashkëpunimit në të gjitha sferat shoqërore, duhet filluar para së gjithash në fushën e arsimit, kulturës, shkencave mjekësore, për ta vijuar në kuadrin e bashkëpunimit juridik dhe ekonomik në veçanti.

Efektiviteti i funksionimit të hapësirës së përbashkët ekonomike shqiptare

Prof. Dr. Adrian CIVICI

Universiteti European i Tiranës

Abstrakt. *Ideja e nxitjes së një hapësire të përbashkët ekonomike shqiptare në Ballkan mund të vlerësohet si një hap prej kërkimit të rritjes së rëndësisë dhe prej frymëmarrjes së sistemit ekonomik e financiar, të tregjeve e të shkëmbimeve të të gjitha llojeve për ekonominë shqiptare, atë kosovare dhe pse jo, edhe për atë të disa vendeve të tjera të Europës jug-lindore si Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, etj.*

Larg ideve ose praktikave të nacionalizmit ekonomik e politik, ajo që synohet nëpërmjet kësaj iniciative janë analizat, studimet dhe propozimet konkrete për masa, për politika ekonomike, për strategji zhvillimi ekonomik, për realizim të projekteve me inpakt të konsiderueshëm, për thithje të drejtpërdrejtë investimesh të huaja, rritja e efijencës së investimeve të realizuara, koordinimi i interesave dhe i sferës së veprimit të biznesit privat, shfrytëzimi i avantazheve krahasuese të njëri-tjetrit, koordinimin e politikave tregtare dhe tregtinë reciproke, koordinimin e politikave energjitike, bashkëpunimin e dhomave të tregtisë e të industrisë, etj.

Debatet, diskutimet dhe propozimet në kuadrin e përpjekjeve për krijimin e një hapësire të përbashkët ekonomike shqiptare na cojnë natyrshëm në domosdoshmërinë e dhënies së përgjigjes dhe reflektimit për pyetjet e mëposhtëme.

Pse ky Forum dhe kjo iniciativë mbi hapësirën e përbashkët ekonomike shqiptare në Ballkan? - Iniciativa e lancimit të një forumi mbi krijimin ose efijencën e një hapësire të përbashkët ekonomike shqiptare në Ballkan mishëron një kërkesë evidente në periudhën apo stadin ku ndodhen veçanërisht ekonomitë e Shqipërisë dhe Kosovës. Ajo po merr jetë si një nismë e ish-Presidentit të Republikës së Kosovës, z.Behgjet Pacolli, aktualisht zv/kryeministër dhe prej Universitetit European të Tiranës së bashku me Universitetin FAMA të Prishtinës.

Tendenca kryesore në shek. XXI, por veçanërisht periudha pas krizës globale po evidenton si domosdoshmëri krijimin e hapësirave sa më të mëdha të veprimit të aktivitetit ekonomik e financiar, të hapësirave jo vetëm territoriale, por dhe njerëzore, kapitaleve, investimeve, tregtisë, shërbimeve, etj. Në këtë këndvështrim, edhe ideja e nxitjes së një hapësire të përbashkët ekonomike shqiptare në Ballkan mund të vlerësohet si një hap prej kërkimit të rritjes së rëndësisë dhe prej frymëmarrjes së sistemit ekonomik e financiar, të tregjeve e të shkëmbimeve të të gjitha llojeve për ekonominë shqiptare, atë kosovare dhe pse jo, edhe për atë të disa vendeve të tjera të Europës jug-lindore si Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, etj.

Larg ideve ose praktikave të nacionalizmit ekonomik e politik, ajo që synohet nëpërmjet kësaj iniciative janë analizat, studimet dhe propozimet konkrete për masa, për politika ekonomike, për strategji zhvillimi ekonomik, për realizim të projekteve me in-pakt të konsiderueshëm, për thithje të drejtpërdrejtë investimesh të huaja, rritja e efijencës së mjaft investimeve të realizuara deri tani, koordinimi më i mirë i interesave dhe i sferës së veprimit të biznesit privat, shfrytëzimi i avantazheve

krahasuese të njëri-tjetrit, koordinimin e politikave tregtare dhe tregtinë reciproke, koordinimin e politikave energjitike, bashkëpunimin e dhomave të tregtisë e të industrisë, etj.

A mund të përballemi më mirë me integrimin europian, por dhe me globalizimin nëpërmjet hapësirës ekonomike shqiptare? -

Zgjerimi dhe mirëfunksionimi i një tregu ballkanik në përgjithësi dhe në këtë kuadër edhe atij mbarëshqiptar në veçanti do të ishte një hap më shumë drejt integritit europian. Për më tepër, një nga sfidat e sotme të globalizimit është sfida e integritit të ekonomive të vendeve të ndryshme me njëra-tjetrën, është shkalla e hapjes së tyre ndaj ekonomisë globale, është përballimi i konkurrencës ndërkombëtare, që sa vjen e bëhet më e vështirë nëse ekonomitë e vendeve të ndryshme ose tregjet janë të vogla e të izoluar. Pikërisht për këtë arsye ne duhet të kërkojmë dhe të përpiqemi që ta zgjerojmë hapësirën bashkëpunuese dhe ndërvarësinë e ekonomive tona jo vetëm ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, por në gjithë hapësirën ballkanike.

Duke u ndalur veçanërisht tek « integrimi i sistemeve ekonomike e financiare » problemi qëndron te mundësitë dhe rrugët që duhet të kërkojnë këto vende për të bashkëpunuar institucionalisht në këtë drejtim. Sa më i qëndrueshëm të jetë stabiliteti financiar dhe ekonomik i rajonit, aq më tërheqës bëhet ai për investimet e huaja drejtpërdrejt dhe përgjithësisht për tregjet financiare dhe partneritetin ndërkombëtar. Kapacitetet ekonomike të vendeve të rajonit mbeten ende të nënshfrytëzuara dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe i ekuilibruar kërkon rendiment të lartë të balancimit të faktorëve të prodhimit me kërkesën e brendshme dhe të jashtme të vendeve tona.

Çfarë masash apo politikash shtesë mund të ndërmerren për ta bërë sa më efektive këtë iniciativë? - Masat ose politikat që mund të ndërmerren në këtë drejtim janë të shumta. Si të tilla

mund të përmendim thellimin e diapazonit të veprimit dhe të efektit të marrëveshjeve tregtare dhe këmbimit të mallrave ose shërbimeve në përgjithësi; përdorimi i burimeve dhe faktorëve të prodhimit mbi baza komplementare mes dy vendeve; hartimi dhe koordinimi i projekteve të përbashkëta që kanë të bëjnë me transportin, kryesisht atë rrugor e hekurudhor; koordinimi i politikave dhe investimeve në energjetikë aq më tepër që , mund të jemi komplementarë në prodhimin e energjisë; përmirësimi dhe harmonizimi i legjislacionit dhe heqjes së barrierave të panevojshme administrative me qëllim lehtësimin e procedurave për shkëmbimin e mallrave, shërbimeve dhe faktorëve të prodhimit mes dy vendeve; përfshirjen e përbashkët në programet europiane e ndërkombëtare të naftës, gjelësve e gazsjellësve; harmonizimi i ofertës dhe i produkteve turistike cilësore për t'u bërë një pol i rëndësishëm turistik rajonal; koordinimi i politikave makroekonomike, fiskale e buxhetore për të krijuar një zonë ekonomiko-financiare të përbashkët, të stabilizuar dhe larg krizave; hartimin dhe implementimin e politikave të përbashkëta për përmirësimin e klimës së biznesit dhe për stimulimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme; nxitjen e bashkëpunimit të dhomave të tregtisë dhe industrisë për koordinimin e biznesit privat që është një faktor fundamental për ekonominë tona; bashkëveprimi më i mirë i tregjeve financiare dhe bankave; koordinimi ligjor e institucional për luftimin e krimit financiar e ekonomik, pastrimin e parave, eliminimin ose zbulimin e transaksioneve ose pagesave jolegale, etj., mund të vlerësohet si një drejtim i rëndësishëm integrimi financiar i rajonit; .

Çfarë roli mund të luajnë universitetet në këtë kuadër?

Në vendet e zhvilluara universitetet janë jo vetëm qendra të rëndësishme akademike mësimdhënëse, por edhe qendra të rëndësishme kërkimore - shkencore e ofruese shërbimesh të

ndryshme. Ato kanë kapacitetet njerëzore cilësore dhe struktura institucionale që të luajnë një rol parësor në agjendën e zhvillimit ekonomik-social të çdo vendi. Në këtë këndvështrim, edhe përfshirja në këtë iniciativë e Universitetit Europian të Tiranës dhe e Universitetit FAMA të Prishtinës shkon në të njëjtin kah me këtë rol të universiteteve. Ato mund e duhet të bëhen qendra të rëndësishme që bëjnë analiza të specializuara, që ofrojnë politika e masa që duhen ndërmarrë nga qeveritë përkatëse, koordinojnë aktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik, artikulojnë shkencërisht kërkesat e biznesit dhe të tregjeve në përgjithësi, botojnë dhe divulgojnë gjithë problematikën e zhvillimit dhe të kooperimit ekonomik, janë më neutrale politikisht dhe privilegjojnë logjikën shkencore të politikave dhe të strategjive të zhvillimit, i kanë më të lehta kontaktet dhe bashkëpunimin me shumë partnerë të specializuar ndërkombëtarë, etj. E rëndësishme është që vetë universitetet ta vlerësojnë këtë rol dhe të angazhohen institucionalisht në realizimin e tij sa më me efikasitet në interes të ekonomisë dhe gjithë shoqërisë.

Tregu i përbashkët i energjisë elektrike Kosovë - Shqipëri¹

Fadil ISMAJLI*

Naim BEJTULLAHU

Skënder GJONBALAJ

Abstrakt. *Sistemet elektrike të Kosovës dhe të Shqipërisë janë në proces të ristrukturimit nga kompani vertikalisht të integruara dhe të rregulluara, drejt shthurjes dhe liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, ku qëllimi kryesor është promovimi i konkurrencës mes prodhuesve dhe furnizuesve të energjisë elektrike.*

Në sistemet e vogla, që kushtrimisht janë edhe tregje të vogla si ai i Kosovës dhe i Shqipërisë, me kapacitete dhe strukturë (njëllojshmëri e burimeve) të kufizuar gjeneruese dhe me një numër të vogël të pjesëmarrësve në treg hapja e tregut konkurrues të energjisë elektrike përcillet me vështirësi serioze. Kjo situatë shtrton nevojën e një analize të përfitimeve të pritshme nga një treg i vetëm (i përbashkët) i energjisë elektrike Kosovë - Shqipëri, si hap i parë drejt integritimit në tregun Europian të energjisë elektrike, duke marrë për bazë strukturën e kapaciteteve gjeneruese hidrike dhe termike, kapacitetet rezervë dhe ato balancuese si dhe hapësirat që krijohet për optimizim nga ky fakt.

¹ Tezat e shprehura në këtë referim janë parathënie dhe shpjegimi më i plotë për idenë e linjës së interkonieksionit që ende nuk realizohet, tenderi i të cilës dështoi një vit më vonë, në 2012.

* Drejtor i KOSTT, sh.a, kompania kosovare e transmetimit të energjisë

Hyrje

Tregu i energjisë ka pësuar reforma rrënjësore nga aspekti i menaxhimit komercial të energjisë. Aspekti teknik i operimit të sistemit elektrik nuk ka ndryshuar shumë, përveç në rastet kur është ndikuar nga zhvillimet teknologjike dhe drejtpërdrejt nga komponentët komerciale. Në shumicën e vendeve të Europës tregu me të gjithë komponentët e tij nuk ka arritur maturimin e plotë sipas parashikimeve. Shumë procese janë ende në fazën ideore prandaj ka teori të shumta se çfarë e bënë një treg të funksionojë mirë. Shumica e teorive, por edhe praktikat për një treg funksional sygjerojnë se rregullat e tij (duke mos u kufizuar vetëm në to në tërësinë e operimit) duhet të menaxhojnë në mënyrë të mirëfilltë katër procese, të cilat njihen edhe si komponentë (mekanizma) kryesorë të tregut. Këto komponentë janë:(1) Mekanizmi balancues, (2) Menaxhimi i kongjestionëve (ngufatjeve), (3) Shërbimet ndihmëse dhe (4) Skedulimi e dispeçimi.

Menaxhimi i mirëfilltë i këtyre komponentëve paraqet bazë të mirë për çfarëdo dizajni të tregut i cili mund t'i përshtatet rrethanave dhe kushteve në të cilat zbatohet.

Aktualisht Kosova dhe Shqipëria ballafaqohen me pengesa dhe vështirësi në menaxhimin e duhur dhe zbatimin e plotë të jo vetëm këtyre mekanizmave, por edhe sidomos mekanizmave që ndërlidhen me tregtinë ndërkuftare. Pavarësisht nga kjo, në shumë aspekte të brendshme teknike dhe organizative në të dyja sistemet, ka pasur zhvillime të cilat jo vetëm se janë të krahasueshme, por edhe tejkalojnë disa nga shtetet në rajon.

Historiku

Për realizimin e objektivave për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike dhe themelimit të tregut të përbashkët European , Komisioni European në vitin 2002 ka marrë

iniciativën të mbështesë shtetet e Europës Juglindore (EJL) në harmonizimin e politikave shtetërore dhe në zhvillimin e bazës ligjore në përputhshmëri me direktivat Europiane dhe me qëllim të:

- Nxitjes dhe mbështetjes së investimeve në sektorin e energjisë elektrike.
- Rritjes së sigurisë së furnizimit.
- Rritjes ekonomike në përgjithësi.

Kosova dhe Shqipëria, në mesin e shteteve të EJL-së, në vitin 2002 kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit të Athinës si dhe revidimin e tij në vitin 2003, për themelimin e “Tregut Regjional të Energjisë Elektrike”.

Në vitin 2005 Komisioni European në emër të shteteve të Bashkimit European dhe shtetet e EJL-së nënshkruajnë **Traktatin mbi Themelimin e Komunitetit të Energjisë**. Synimi është që duke zbatuar kornizën legjislative të Komunitetit European, ndërtuar mbi bazën e “Acquis communautaire”, të ndërtohet një treg intern european. Kosova dhe Shqipëria bëhen partnere të barabarta në themelimin e Komunitetit të Energjisë dhe kjo hap mundësi të reja zhvillimi ekonomik sidomos duke pas parasysh rezervat e mëdha të linjtit në Kosovë, potencialet hidrike në Shqipëri si dhe pozitën ideale gjeografike për shkëmbimin e energjisë elektrike në regjionin e EJL-së.

Për të përmbushur obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë për implementimin e “Acquis communautaire”, Kosova dhe Shqipëria kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për përpilimin e legjislacionit dhe ristrukturimin e sektorit në harmoni me direktivat e Komisionit European (KE), me theks në:

- Krijimin e strukturave të reja (p.sh autoriteti rregullator) dhe shthurja e sistemeve vertikalisht të organizuara (p.sh Gjenerimi, Operatorët e sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes, Operatorët e tregut dhe krijimi i mundësive për më shumë furnizues në treg).

- Reformat e duhura në zhvillimin e metodologjive tarifore e standardeve teknike që mundësojnë Qasje të barabartë të Palëve të Treta dhe furnizim cilësor, parakushte për krijimin e tregut të liberalizuar të energjisë elektrike.

Kosova dhe Shqipëria kanë bërë hapa në drejtim të zbatimit të reformave deri në një shkallë të caktuar e që janë në harmoni me kërkesat e mësipërme.

Baza ligjore

Ligjet e Energjisë dhe Energjisë Elektrike si në Kosovë ashtu dhe në Shqipëri përcaktojnë principet themelore për një strategji dhe program të energjisë që ka për qëllim furnizim të sigurt, të besueshëm dhe kualitativ me energji elektrike dhe njëkohësisht të promovojë:

- Shfrytëzim efikas dhe ekonomik të burimeve të energjisë,
- investimet në sektorin e energjisë duke respektuar mbrojtjen e mjedisit.
- Krijimin e kushteve për themelimin e një tregu modern dhe konkurrues të energjisë elektrike bazuar në parimet themelore, nga Direktivat Europiane dhe “Acquis communautaire” për energjinë, (i) transparenca, (ii) jodiskriminimi, (iii) qasja e barabartë dhe (iv) mbrojtja e konsumatorit.
- Kohezion ekonomik dhe social.

Ligjet po ashtu vendosin rregullat për aktivitete ekonomike të shturura të prodhimit të energjisë elektrike, transmisionit, shpërndarjes, furnizimit dhe tregtimit e që janë parakushte për qasje të papenguar të palëve të treta që do të mundësojnë:

- Krijimin e një tregu të qëndrueshëm dhe konkurrues të energjisë elektrike.
- Krijimin e kushteve për furnizim të sigurt, të besueshëm, efikas dhe të pandërprerë me energji elektrike.
- Shërbimet universale, kur është teknikisht dhe ekonomikisht e leverdishme, për të gjithë konsumatorët si dhe të gëzojnë të drejtën për furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike e me çmim të arsyeshëm.

Bashkëpunimi aktual Kosovë – Shqipëri

Bashkëpunimi në sektorin e energjisë elektrike ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është në rritje e sipër dhe zhvillohet në disa nivele si ai qeveritar, i autoriteteve rregullatore, Operatorëve të Sistemeve Transmetuese dhe Operatorëve të tjerë në sektorin e energjisë.

Deri me tani janë arritur këto marrëveshje bashkëpunimi:

- Marrëveshje mirëkuptimi për bashkëpunim në mes të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) së Shqipërisë dhe Ministrisë së Energjisë dhe Minierave (MEM) të Kosovës.
- Marrëveshje e bashkëpunimit në mes të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) së Shqipërisë dhe Zyrës së Rregullatorit të Energjisë së Kosovës (draft).
- Marrëveshje e kooperimit ndërmjet TSO-së dhe Operatorit të Transmisionit dhe Tregut (OST) të Shqipërisë dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) të Kosovës.
- Marrëveshja për shkëmbim të energjisë elektrike në mes të Korporatës Energjetike Shqiptare (KESH) dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).

Nga aspekti i tregut të energjisë, infrastrukturës, bashkëpunimit dhe komunikimeve:

- Shkëmbimi i energjisë elektrike në formë ndihmëse dhe depozitimi i një niveli modest të optimizmit.
- Ndërtimi i një linje të transmisionit 400kV (TS Kos B-NS Kashar) që të rritë dukshëm kapacitetin transmetues në mes të të dyja vendeve. Implementimi i këtij projekti ka filluar dhe pritet që të jetë në operim në vitin 2013.
- Instalimi i pajisjeve për rregullimin frekuence-fuqi (Implementimi ka filluar).
- Bashkëpunimet konkrete në mirëmbajtjen e sistemeve të njeri-tjetrit.
- Shkëmbimi intensiv i eksperiencës së ndërsjellët.
- Diskutimet intensive në themelimin e një zone rregulluese të përbashkët dhe mundësia e anëtarësimit të përbashkët në asociacionit europian të transmisioneve ENTSO-E.
- Janë vendosur komunikimet formale dhe ato joformale për shkëmbim idesh të cilat mund të sjellin përfitime të dyanshme drejt themelimit të tregut të përbashkët.

Kosova dhe Shqipëria si të vetme e kanë të vështirë hapjen e tregut konkurrues të energjisë elektrike kur dihet se prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë mbështetet kryesisht centralet me linjit, ndërsa gjenerimi i Shqipërisë mbështetet në centralet hidrike dhe se numri i pjesëmarrësve në treg është i limituar. Për më tepër si të vetme kanë vështirësi në plotësimin e standardeve dhe obligimeve që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe standardeve teknike nga kodet e operimit të ENTSO-E. Pra, natyrshëm lind nevoja e themelimit të një tregu të përbashkët që mund të jetë Treg Bilateral i mbështetur me “treg një ditë para” (Day Ahead Market) dhe mekanizmit balancues të përbashkët Kosovë- Shqipëri (Shih figura 1.). Energjia bazë për këtë treg do të sigurohej kryesisht nga burimet gjeneruese të Kosovës mbi bazën e linjitet, ndërsa pjesa variabile (përcjellja e diagramit të ngarkesës), piku i

ngarkesës, rezervat për shërbime ndihmëse (sekondare dhe terciare) dhe për balancim do të siguroheshin nga burimet hidrike të Shqipërisë. Në këtë mënyrë do të arrihet, valorizim i mirëfilltë i të dyja llojeve të burimeve krahas një optimizmi të shfrytëzimit të kapaciteteve që është në harmoni me kërkesat nga Direktivat e KE-së mbi Energjinë. Themelimi i këtij tregu do të konsiderohej si hap i parë drejt themelimit të tregut regional të energjisë elektrike, e me këtë përmbushen kushtet për integrim në tregun mbareuropian.




Figura 1

Shembulli i një tregu të mundshëm bilateral

Për themelimi e tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë- Shqipëri, fillimisht kërkohet themelimi i Zonës Rregulluese të përbashkët² dhe (ri)ndërtimi i bazës ligjore dhe i mekanizmave të përbashkët në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe direktivat e KE-së.

Pozita e përshtatshme gjeografike e zonës rregulluese dhe

² Load Frequency Control Study Kosovo – Albania –nga VATTENFALL EUROPE POWERCONSULT GMBH ka konkluduar se themelimi i zonës së përbashkët Kosovë – Shqipëri është ekonomikisht i arsyeshëm

tregtare Kosovë- Shqipëri, e ndërlidhur fort me linja të interkonjeksionit me sistemet fqinje të Serbisë, Maqedonisë, Greqisë, Malit të Zi dhe në të ardhmen edhe me atë të Italisë do të japë sinjale ekonomike joshëse për investitorët në horizonte të gjata kohore për të dyja vendet.

Themelimi i zonës së përbashkët kontrolluese dhe tregu i përbashkët konkurrues si dhe industria që do ta përcjellë këtë treg (prodhuese si dhe ajo e rrjetit) do të krijojnë kushte më të mira për optimizimin e sistemeve dhe do të sigurojnë mirëqenie të përgjithshme shoqërore dhe kualitet të shërbimeve me kosto më të ultë për konsumatorët fundorë .

Për themelimin e tregut të përbashkët fillimisht do duhej të arrihej një marrëveshje e mirëkuptimit me qëllim vendosjen e strukturave të përbashkëta të kooperimit të niveleve qeveritare, rregullatorë, të operatorëve dhe atyre plenare ku mund të participojnë edhe palët e tjera të interesuara.

Rezultatet e marrëveshjes së mirëkuptimit do të reflektojnë :

- Harmonizimin e strategjive zhvillimore të sektorit të energjisë.
- Rishikimin e master -planeve zhvillimore dhe përshtatjen eventuale të tyre të objektivave të tregut të përbashkët.
- Dizajnimin e parimeve të tregut të përbashkët.
- Definimin e aksioneve të harmonizimit të legjislacioneve bazë dhe atyre rregullatorë për tregun e përbashkët.
- Hartimin eventual të një dokumenti ndërshtetëror, me kapacitet obligativ për palët e interesit, për implementim deri në realizim të tregut të përbashkët.

Planet eventuale aksionare, mund të përcaktojnë modalitetet e implementimit më të efektshëm e që duhet të zotohen nga të dyja vendet.

Parametrat teknikë, ekzistues dhe të planifikuar të sistemeve elektrike

Në Tabelën 1 dhe në Tabelën 2 janë dhënë bilancet e kapaciteteve të Kosovës dhe Shqipërisë për periudhën 2010-2025. Nga tabelat në vijim vërejmë se Kosova do të ketë mungesë të kapaciteteve gjeneruese deri në vitin 2018 kur parashihet të fillojë operimin TC Kosova e Re, ndërsa Shqipëria pothuaj nuk do të ketë deficit të kapaciteteve gjeneruese nga viti 2013. Në këto tabela nuk është paraparë rezerva gjenerues së paku 10% mbi ngarkesës maksimale

Tabela 1. Bilanci i kapaciteteve në Kosovë – Rasti Bazë

BILANCI I KAPACITETEVE NE KOSOVË- RASTI BAZË												
Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2025
Ngarkesa maksimale	1073	1081	1107	1133	1158	1177	1210	1245	1286	1327	1368	1539
Kapacitetet gjën. të instaluara	1055	1055	1055	1055	1055	1055	1055	1200	1500	1500	1540	2540
Ekzistuese	1015	1015	1015	1015	1015	1015	1015	500	500	500	500	500
Planifikuar hidro	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40
Planifikuarq termoe	0	0	0	0	0	0	300	600	600	600	1000	2000
Reserva(+) ose Deficiti(-)	-18	-26	-52	-78	-103	-122	-155	-45	214	173	172	1001

Tabela 2. Bilanci i kapaciteteve në Shqipëri – Rasti bazë

Në figurën 3 dhe 4 janë paraqitur bilancet e kapaciteteve në formë grafike.




Figura 3. Bilanci i kapaciteteve në Kosovë




Figura 4. Bilanci i kapaciteteve në Shqipëri

Në Tabelën 4 dhe 5 janë paraqitur balancat energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë për periudhën 2010-2025. Të dhënat nga tabelat pasqyrojnë se Kosova dhe Shqipëria kanë deficit të energjisë dhe janë të varura nga importi i energjisë elektrike. Në rastin e Kosovës situata do të përmirësohet me futjen në operim të TC Kosova e Re, ndërsa Shqipëria do të jetë e varur nga importi i energjisë elektrike deri në vitin 2025.

Tabela 3 Bilanci i energjisë elektrike- Kosovë

Bilanci i energjisë elektrike - Kosovë
GWh

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2025
Kerkesa per energji elek.	5551	6144	6323	6499	6674	6853	7035	7210	7381	7530	8842
TC e planifikuara	0	0	0	0	0	2268	3780	3780	3780	3780	8000
TC ekzistuese	4649	4857	4887	5052	5052	5052	3952	3719	3476	3641	3641
Hidrocentralet	104	104	104	104	104	104	504	605	720	830	1000
Prodhimi ne dispozicion	4753	4961	4991	5156	5156	7424	8236	8104	7976	8251	12641
Reserva(+) ose Deficiti(-)	-798	-1183	-1332	-1343	-1518	571	1201	894	595	721	3799

Bilanci i energjisë elektrike - Shqiperi
GWh

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2025
Kerkesa per energji elek.	9087	9324	9555	9781	9984	10185	10384	10581	10777	10971	11928
TC ekzistuese	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
TC e planifikuara	1140	1140	2656	3414	3414	3414	3414	3414	3414	3414	3414
HC ekzistuese	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565
HC e planifikuara	460	1129	1129	1184	1184	1239	1239	1600	2000	2800	4000
Prodhimi ne dispozicion	6165	6834	8350	9163	9163	9218	9218	9579	9979	10779	11979
Reserva(+) ose Deficiti(-)	-2922	-2490	-1205	-618	-821	-967	-1166	-1002	-798	-192	51

Bilanci i përbashket I energjisë elektrike Kosovë-Shqiperi
GWh

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2025
Kerkesa per energji elek.	14638	15468	15878	16280	16658	17038	17419	17791	18158	18501	20770
Prodhimi ne dispozicion	10918	11795	13341	14319	14319	16642	17454	17683	17955	19030	24620
Reserva(+) ose Deficiti(-)	-3720	-3673	-2537	-1961	-2339	-396	35	-108	-203	529	3850

Tabela 4. Bilanci i energjisë elektrike- Shqipëri

Bilanci i energjisë elektrike - Kosove

GWh											
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2025
Kerkesa per energji elek.	5551	6144	6323	6499	6674	6853	7035	7210	7381	7530	8842
TC e planifikuara	0	0	0	0	0	2268	3780	3780	3780	3780	8000
TC ekzistuese	4649	4857	4887	5052	5052	5052	3952	3719	3476	3641	3641
Hydrocentralet	104	104	104	104	104	104	504	605	720	830	1000
Prodhimi ne dispozicion	4753	4961	4991	5156	5156	7424	8236	8104	7976	8251	12641
Reserva(+) ose Deficiti(-)	-798	-1183	-1332	-1343	-1518	571	1201	894	595	721	3799

Bilanci i energjisë elektrike - Shqiperi

GWh											
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2025
Kerkesa per energji elek.	9087	9324	9555	9781	9984	10185	10384	10581	10777	10971	11928
TC ekzistuese	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
TC e planifikuara	1140	1140	2656	3414	3414	3414	3414	3414	3414	3414	3414
HC ekzistuese	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565
HC e planifikuara	460	1129	1129	1184	1184	1239	1239	1600	2000	2800	4000
Prodhimi ne dispozicion	6165	6834	8350	9163	9163	9218	9218	9579	9979	10779	11979
Reserva(+) ose Deficiti(-)	-2922	-2490	-1205	-618	-821	-967	-1166	-1002	-798	-192	51

Bilanci i përbashket I energjisë elektrike Kosovë-Shqiperi

GWh											
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2025
Kerkesa per energji elek.	14638	15468	15878	16280	16658	17038	17419	17791	18158	18501	20770
Prodhimi ne dispozicion	10918	11795	13341	14319	14319	16642	17454	17683	17955	19030	24620
Reserva(+) ose Deficiti(-)	-3720	-3673	-2537	-1961	-2339	-396	35	-108	-203	529	3850

Në tabelën 5 është dhënë bilanci i përbashkët Kosovë- Shqipëri dhe siç shihet situata përmirësohet dukshëm. Nga viti 2017 deficiti i energjisë është i vogël dhe duke filluar nga viti 2020 balanca e përbashkët do të ketë teprica të energjisë elektrike.

Tabela 5 Bilanci i përbashkët i energjisë elektrike Kosovë – Shqipëri

Bilanci i energjisë elektrike - Kosove

GWh											
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2025
Kerkesa per energji elek.	5551	6144	6323	6499	6674	6853	7035	7210	7381	7530	8842
TC e planifikuara	0	0	0	0	0	2268	3780	3780	3780	3780	8000
TC ekzistuese	4649	4857	4887	5052	5052	5052	3952	3719	3476	3641	3641
Hydrocentralet	104	104	104	104	104	104	504	605	720	830	1000
Prodhimi ne dispozicion	4753	4961	4991	5156	5156	7424	8236	8104	7976	8251	12641
Reserva(+) ose Deficiti(-)	-798	-1183	-1332	-1343	-1518	571	1201	894	595	721	3799

Bilanci i energjisë elektrike - Shqiperi

GWh											
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2025
Kerkesa per energji elek.	9087	9324	9555	9781	9984	10185	10384	10581	10777	10971	11928
TC ekzistuese	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
TC e planifikuara	1140	1140	2656	3414	3414	3414	3414	3414	3414	3414	3414
HC ekzistuese	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565	4565
HC e planifikuara	460	1129	1129	1184	1184	1239	1239	1600	2000	2800	4000
Prodhimi ne dispozicion	6165	6834	8350	9163	9163	9218	9218	9579	9979	10779	11979
Reserva(+) ose Deficiti(-)	-2922	-2490	-1205	-618	-821	-967	-1166	-1002	-798	-192	51

Bilanci i përbashket I energjisë elektrike Kosovë-Shqiperi

GWh											
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2025
Kerkesa per energji elek.	14638	15468	15878	16280	16658	17038	17419	17791	18158	18501	20770
Prodhimi ne dispozicion	10918	11795	13341	14319	14319	16642	17454	17683	17955	19030	24620
Reserva(+) ose Deficiti(-)	-3720	-3673	-2537	-1961	-2339	-396	35	-108	-203	529	3850

Në figurat 5, 6 dhe 7 janë paraqitur bilancet e energjisë elektrike në formë diagrami.




Figura 5 Bilanci i energjisë elektrike- Kosovë




Figura 6. Bilanci i energjisë elektrike- Shqipëri




Figura 7. Bilanci i energjisë elektrike Kosovë – Shqipëri

Të dhënat e shfrytëzuara në tabelat e mësipërme janë marrë nga parashikimet e planeve të zhvillimit të sistemeve të transmiseve të të dyja vendeve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me gjendjet aktuale sepse azhurnimi me të dhëna të reja nuk ndikon në qëllimin e këtij shkrimi.

Në tabelat 6,7 dhe 8 janë dhënë vlerat e estimuara të tregut të energjisë elektrike për Kosovën, Shqipërinë dhe tregun e përbashkët.

Tabela 6. Vlera e estimuar e tregut të energjisë në Shqipëri

VLERA E ESTIMUAR E TREGUT TE ENERJISË NE SHQIPËRI

	2011	2015	2020	2025
Kerkesa me humbje	9087	9984	10971	11928
Kerkesa pa humbje (20%)	7270	7987	8777	9542
Cmimi €/MWh	70	85	100	150
Vlera ne €	508,872,000	678,912,000	877,680,000	1,431,360,000
Importi (eksport)GWh	-2952	-821	-192	51
Cmimi €/MWh	100	100	80	80
Vlera e import(eksport) ne €	-295,200,000	-82,100,000	-15,360,000	4,080,000
Diferenca tregu+imp(Exp)	804,072,000	761,012,000	893,040,000	1,427,280,000

VLERA E ESTIMUAR E TREGUT TE ENERJISË NE KOSOVË

	2011	2015	2020	2025
Kerkesa me humbje	5916	6674	7530	8842
Kerkesa pa humbje (20%)	4733	5339	6024	7074
Cmimi €/MWh	70	85	100	150
Vlera ne € (tregu)	331,296,000	453,832,000	602,400,000	1,061,040,000
Importi (eksport)GWh	-798	-1519	722	3799
Cmimi €/MWh	100	100	80	80
Vlera e import(eksport) ne €	-79,800,000	-151,900,000	57,760,000	303,920,000
Diferenca tregu+imp(Exp)	411,096,000	605,732,000	544,640,000	757,120,000

Tabela 7. Vlera e estimuar e tregut të energjisë në Kosovë

VLERA E ESTIMUAR E TREGUT TE ENERGISË NE SHQIPËRI

	2011	2015	2020	2025
Kerkesa me humbje	9087	9984	10971	11928
Kerkesa pa humbje (20%)	7270	7987	8777	9542
Cmimi €/MWh	70	85	100	150
Vlera ne €	508,872,000	678,912,000	877,680,000	1,431,360,000
Importi (eksport)GWh	-2952	-821	-192	51
Cmimi €/MWh	100	100	80	80
Vlera e import(eksport) ne €	-295,200,000	-82,100,000	-15,360,000	4,080,000
Diferenca tregu+imp(Exp)	804,072,000	761,012,000	893,040,000	1,427,280,000

VLERA E ESTIMUAR E TREGUT TE ENERGISË NE KOSOVË

	2011	2015	2020	2025
Kerkesa me humbje	5916	6674	7530	8842
Kerkesa pa humbje (20%)	4733	5339	6024	7074
Cmimi €/MWh	70	85	100	150
Vlera ne € (tregu)	331,296,000	453,832,000	602,400,000	1,061,040,000
Importi (eksport)GWh	-798	-1519	722	3799
Cmimi €/MWh	100	100	80	80
Vlera e import(eksport) ne €	-79,800,000	-151,900,000	57,760,000	303,920,000
Diferenca tregu+imp(Exp)	411,096,000	605,732,000	544,640,000	757,120,000

Tabela 8. Tregu i përbashkët – operimi i përbashkët

Tregu i perbashket - Operimi i perbashket

	2011	2015	2020	2025
Kerkesa me humbje	14638	16658	18501	20770
Kerkesa pa humbje (20%)	11710	13326	14801	16616
Cmimi €/MWh	70	85	100	150
Vlera ne €	819,728,000	1,132,744,000	1,480,080,000	2,492,400,000
Importi (eksport)GWh	-4085	-2339	529	3850
Cmimi €/MWh	100	100	80	80
Vlera e import(eksport) ne €	-408,500,000	-233,900,000	42,320,000	308,000,000
Diferenca tregu+imp(Exp)	1,228,228,000	1,366,644,000	1,437,760,000	2,184,400,000

Në Figurën 8. është paraqitur grafikisht kërkesa për energji elektrike në tregun e përbashkët me humbje 20% dhe pa humbje dhe nevoja për import për periudhën kohore 2011-2025. Si shihet nga diagrami tregu i përbashkët duke filluar nga viti 2020 do të ketë teprica të energjisë të cilat mund t'i plasojë në tregun regional.




Figura 8. Tregu fizik i përbashkët i energjisë elektrike

Konkluzione

Nga tregu i përbashkët Kosovë – Shqipëri priten përfitime të ndryshme si:

- Kosto më e ulët e sistemit (për të dyja sistemet).
- Siguri më e lartë e furnizimit.
- Nxitje e konkurrencës në tregun e energjisë.
- Parapërgatitje për tregun evropian (anëtarësimi në BE).
- Përbushja e objektivave evropiane 20:20:20 (20% reduktim të emisioneve, 20% energji të ripërtëritshme, dhe 20% përmirësim në efikasitetin energjetik deri më 2020).
- Kursimi nga operimi i përbashkët në një bllok kontrollues vetëm nga kërkesa për rezerva mandatore (primare, sekondare) është paraqitur në tabelën në vijim:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Kursimi nga çmimi për fuqi (Mi. €)	4.283	4.711	5.182	5.727	6.3
Kursimi nga çmimi për energji * (Mil. €)	10.8	10.8	10.8	10.8	10.8
Gjithsejtë kursime (Mi. €)	15.083	15.511	15.982	16.527	17.1

- Duke i konsideruar kostot e larta të kapacitetit, në rastin e rezervave terciare, operimi i përbashkët do të reduktojë kapacitetin e rezervës terciare respektivisht të kostos së mbulimit të saj deri në 50% (aktualisht përmbushja e obligimit për rezerva terciare nënkupton rezervimin e kapacitetit prej 300MW për secilin sistem- pra 600MW, në rastin e tregut të përbashkët ky kapacitet rezerve përgjysmohet duke krijuar përfitime enorme).
- Adekuacia e gjenerimit do të jetë shumë me fleksibile duke valorizuar ngarkesën e pikut, ngarkesën minimale dhe atë bazike.
- Tepërcat dhe mungesat e energjisë elektrike do të mund të valorizohen në mënyrë optimale duke reduktuar ndjeshëm koston e importeve dhe duke shfrytëzuar optimumin e përfitimit nga eksportet.

Referencat

- [1] Bilanci afatgjatë i energjisë elektrike të Kosovës
- [2] Bilanci afatgjatë i energjisë elektrike të Shqipërisë
- [3] Ligji i energjisë dhe energjisë elektrike të Kosovës
- [4] Ligji i energjisë elektrike i Shqipërisë
- [5] Traktati i komunitetit të energjisë
- [6] Direktivat e KE-së për energji

Shqipëri - Kosovë, dy shtete, një komb, një treg i përbashkët mbarëkombëtar _____

***Integrimit ekonomik mbarëkombëtar një hap i rëndësishëm
për fuqizimin e ekonomisë së Shqipërisë e të Kosovës si dhe
integrimit të tyre në Tregun Rajonal e atë Europian***

Artan GJERGJI, M.A. _____

Universiteti Europian i Tiranës

Abstrakt. *Bashkëpunimi rajonal mes Shqipërisë dhe Kosovës është ende larg nivelit ku realisht këto dy vende kanë potencialin ekonomik të jenë. Pavarësisht lëvizjeve të përgjithshme rajonale si MTL-të, CEFTA, apo marrëveshjet e bashkëpunimit në sektorë të caktuar mes dy vendeve, përsëri ato janë marrëdhënie të kufizuara dhe pothuaj sporadike. Pikërisht me anë të këtij materiali synohet të identifikohen disa rrugë dhe mënyra, të cilat po të zbatohen nga agjentët ekonomikë në hapësirën e përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës do të rrisin volumin e shkëmbimit dhe integrimit ekonomik. Kjo do të mundësonte një alokim më eficient të burimeve dhe faktorëve të prodhimit, duke nxitur një rritje më të shpejtë e më të shëndetshme ekonomike të të dy vendeve.*

ZHVILLIMI RAJONAL

Zhvillimi rajonal tashmë është kthyer në kryefjalën e diskursit jo vetëm politik e diplomatik, por edhe atë të komunitetit të biznesit, i cili ka filluar të kuptojë rëndësinë e rritjes graduale dhe zhvillimit në kushtet e një ekonomie gjithnjë e më tepër konkurrenciale. Edhe pse ka ende akdemikë të cilët janë skeptikë mbi ndikimin pozitiv që ka zhvillimi rajonal dhe integrimi ekonomik në rritjen e mirëqënies së qytetarëve,¹ statistikatat tregojnë që ekonomia botërore ka pësuar një nivel gjithnjë në rritje të volumit të tregtimit dhe qarkullimit të faktorëve të prodhimit, e për rrjedhojë edhe ndikimin në rritjen e GDP-së në rajone të ndryshme të botës në vecanti, si dhe në të gjithë globin në përgjithësi.²

Rajonalizmi, zhvillimi rajonal, integrimi apo bashkepunimi ekonomik rajonal janë koncepte që kanë dekada që studiohen në literaturën ndërkombëtare. Megjithatë, në parim, të gjitha janë të lidhura me një fenomen: të qenurit inicitavia ekonomike preferenciale mes vendeve të ndryshme, të ndërmarra nga qeveritë apo sektori privat, me qëllim lehtësimin e mëtejshëm të lëvizjes së lirë të faktorëve të prodhimit dhe arritjen e ekonomise së shkallës mbi baza komplementare, fillimisht në rajonet ku aplikohen marrëveshje të tilla, e më tej në bazë globale.

Zhvillimi rajonal është parë gjithmonë nga këndvështrimi i përfshirjes në lëvizje rajonale (*rajonalizimi*) mes vendeve të caktuara për harmonizimin e infrastrukturës dhe reduktimin e barrierave që pengojnë zhvillimin ekonomik mes vendeve të përshira në proces. Sipas Winters, rajonalizimi ekonomik është një politikë e dizenuar me qëllim reduktimin e barrierave të tregtisë mes një grupi të caktuar vendesh, pavarësisht faktit nëse këto vende janë afër ose jo me njëri-

¹ *shih* Drabek & Laird (1997)

² *shih* Drabek & Laird (1997) dhe Civici (2009)

tjetrin në aspektin gjeografik të fjalës.³

Globalizimi ka sjellë nevojën për zhvillim rajonal

Procesi i globalizimit ka qenë shtyssa kryesore për nxitjen e gjetjes së rrugëve për zhvillimin rajonal mes vendeve të caktuara apo rajoneve të ndryshme të botës. Nëse i hidhet një sy historisë së zhvillimit ekonomik, do të shihet se dy jane momentet kyce sa i përket çështjes së zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare dhe zhvillimit global. Momenti i parë ka të bëjë, me shpikjen e hekurudhave të cilat në një mënyrë apo në një tjetër zgjeruan volumin e tregtisë ndërkombëtare duke reduktuar kostot e transportit të mallrave me anije mes rajoneve të ndryshme. Më tej, rritja e konkurrencës dhe zgjerimi i përdorimit më me efikasitet i faktorëve të prodhimit solli zhvillimin e mëtejshëm global me një normë relativisht të kënaqshme dhe gjithmonë pozitive.

Ndërsa momenti i dytë ka të bëjë më zhvillimin e shpejtë e të jashtëzakonshëm të teknologjisë e informacionit të cilat i dhanë një hop të paparë jo vetëm procesit të prodhimit të mirave dhe shërbimeve, por lehtësuan jashtë mase edhe fazën e liberalizimit të lëvizjes së faktorëve të prodhimit të agjentëve ekonomikë në mbarë globin nëpërmjet reduktimit drastik të kostove si dhe reduktimit të kohës fizike që i nevojitet këtij procesi.⁴

Megjithatë, duke qenë se procesi i globalizimit është një proces, i cili i mbështetur shumë nga fryma liberalizmit politik dhe ekonomik arriti të ngadhënjë mbi rryma të forta proteksionizmi, duhet thënë që u detyrua të kalonte nëpër faza të ndryshme transformimi dhe përshtatjeje me qëllim përfshirjen në këtë proces të ekonomisë së mbarë botës.

³ Winter (1996)

⁴ *shih* Shams (2003) dhe Baldwin (2011)

Kështu, i stigmatizuar nga rrymat anti-globaliste si një proces i cili synon zgjerimin e tregjeve për agjentët ekonomikë në vendet e zhvilluara, më tepër se sa synon zhvillimin e vendeve pritëse të kapitalit të huaj, globalizimi dhe ithtarët ekonomikë të kësaj rryme u detyruan të përshtasin procesin e rajonalizimit sipas pozicioneve të caktuara gjeografike me qëllim, një kalim gradual të ekonomive të mbyllura drejt ekonomive të zhvilluara mbi bazën e frymës së ekonomisë së tregut. Kështu, në shumë prej nismave të zhvillimit rajonale apo grupimeve rajonale ekonomike, u pa e udhës që harmonizimi i rregullave dhe heqja e barrierave në mënyrë graduale do të mundësonte zhvillimin embrional të bizneseve vendase si dhe konkurrencën mbi baza lokale, duke u dhënë mundësinë këtyre të fundit të rriten gradualisht brenda të njëjtit nivel pa u përballur me konkurrencën e fortë të ekonomive të zhvilluara. Me fjalë të tjera, marrëveshjet rajonale për zhvillim ekonomik dhe tregti të lirë u panë si “*paradhoma*” për ngritjen ekonomike të vendeve të treta apo të atyre në zhvillim e sipër, para se të përballeshin me konkurrencën e fortë globale.

Tregjet kombëtare janë gjithnjë e më të vegjël

Një ndër elementet më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik (edhe atij rajonal) është padyshim tendenca e ekonomive kombëtare për tërheqjen e sa më shumë investimeve të huaja direkte (IHD). Pa dashur të ndalem në avantazhet që sjell ky proces sidomos për vendet në zhvillim, është me vend të theksohet fakti se konkurrenca për joshjen e tyre është gjithnjë e më e madhe, duke filluar që nga incentivat zyrtare (lehtësime fiskale dhe burokratike) e deri tek favore apo koncesionet informale të cilat, u mundësojnë investitorëve një normë kthimi relativisht më të lartë mbi kapitalin e angazhuar.

Megjithatë, përvec incentivave të ofruara, ka edhe një grup tjetër faktorësh të cilët ndikojnë në drejtim të thithjes së IHD-ve drejt një vendi të caktuar. Kështu, bazuar në një filozofi të ekonomisë konsumiste, zotëruesit e kapitalit janë në kërkim të vendeve relativisht të mëdha dhe me potencial zhvillimi, të cilët gjithashtu kanë një numër të konsiderueshëm banorësh si *target group* i duhur për bizneset e tyre.

Parë në këtë këndvështrim, të qenurit një vend i vogël si në aspektin gjeografik e territorial ashtu edhe në ate demografik, i bën këto vende pak të padëshiruar nga investitorët e huaj potencialë duke i lenë jashtë orbitës së zhvillimit me ritme të shpejta. E quajtur ndryshe edhe “sindroma e vendit të vogël”,⁵ ky fenomen redukton probabilitetin e zhvillimit të vendeve relativisht të vegjël me të njëjtin ritëm me vendet e tjera.

Bashkëpunimi rajonal dhe integrimi e vetmja rruge

Për këtë arsye, zhvillimi rajonal dhe krijimi i hapësirave të përbashkëta të bashkëpunimit ekonomik, apo i tregjeve të përbashkëta, duke grupuar mbi baza rajonale disa vende të vogla, i bën ato të duken një treg rajonal më i madh duke i bërë të dukshëm në hartën e investitorëve të huaj të kapitalit.

Bashkëpunimi rajonal si dhe integrimi në tregjet rajonale u jap mundëinë agjentëve ekonomikë në vende të tilla që të rrisin kapacitetet e tyre prodhuese dhe konkurruese në mënyrë graduale duke mos u bërë direkt “pre” e konkurrencës së fortë të biznesve që vijnë nga vendet e zhvilluara. Në këtë mënyrë, harmozimi sa më i shpejtë i politikave ekonomike drejt një zhvillimi rajonal nëpërmjet heqjes së barrierave ekzistuese dhe liberalizimit të lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe faktorëve të kapitalit.

⁵ Civici (2009), pp. 171-173

PROCESI I INTEGRIMIT

Sic u tha edhe më lart, procesi i zhvillimit dhe bashkimeve ekonomike rajonale konsiderohet si një paradhomë për vendet e pazhvilluara apo ato në zhvillim e sipër, në drejtim të një integrimi më të shëndetshëm në struktura dhe tregje më të gjera. Pikërisht, bashkimi i vendeve të ndryshme në drejtim të krijimit të strukturave dhe tregjeve rajonale, si dhe më tej, përfshirja e këtyre blloqeve ekonomike (në disa raste edhe politike), karakterizon procesin e integritit,⁶ i cili në vetvete përmbledh të gjithë procedurat për harmonizimin mbi baza komplementare të imperfeksioneve dhe ndryshimeve të ndryshme mes tregjeve të caktuara.

Zhvillimi Rajonal dhe Integrimi, janë procese të pandashme

Rezultatet e integritit ekonomik mes vendeve të caktuara janë pothuaj të njejta duke filluar që nga rritja e konkurrencës për një pjesë më të madhe tregu, përmirësimi i shkallës së inovacionit në procesin e prodhimit, standardizimi i produkteve dhe certifikimi i cilësisë etj.⁷ Një tjetër element i rëndësishëm në drejtim të zhvillimit rajonal dhe integritit ekonomik mes vendeve, e më pas mes rajoneve, është edhe pranimi i “*komplementaritetit*”, i cili konsiston në drejtim të një shpërndarje më eficiente të burimeve dhe faktorëve të prodhimit në vende dhe rajone të caktuara, duke tentuar të maksimizohet dobishmëria në bazë rajoni. Kështu, për shkak të konkurrencës dhe një përdorimi më eficient të burimeve, disa vende specializohen në prodhimin e një grup mallrash dhe/apo shërbimesh ku kanë përparësi të ndryshme dhe mund të prodhojnë me kosto relativisht më të ulëta, ndërsa vendet e tjera, i alokojnë ato burime në drejtime me më tepër efekt në drejtim të maksimizimit të dobishmërisë. E

⁶ *shih* Bergs (2001), Wang (2006)

⁷ Brow & Ruta (2007)

njëta filozofi ndodh edhe në drejtim të integritimit më të gjerë dhe globalizimit, ku blloqe ekonomike të caktuara rajonale, synojnë të arrijnë ekonominë e shkallës mbi bazën e “komplementaritetit”. Për këtë arsye, proceset e zhvillimit ekonomik rajonal dhe më tej integritimit ekonomik, janë dy procese të cilat përveçse janë krejtësisht të harmonizuara me njëra tjetrën (ndihmojnë njëra-tjetrën), por tashmë me zhvillimin e globalizimit, shihen si fenomene të pandashme nga njëri-tjetri.

Ky proces ka edhe efektet e veta negative të cilat normalisht nuk duhen neglizhuar. Pikërisht konkurrenca që vjen për shkak të zhvillimi rajonal dhe integritimit ekonomik të vendeve të përfshira në proces, edhe pse gradual, përsëri krijon premisa negative për agjentë ekonomikë të cilët nuk do i rezistojnë dot luftës së ashpër të tregut, duke u spostuar dhe dalë krejtësisht jashtë tij.⁸ Kjo normalisht krijon probleme sociale në planin mikro, për shkak të reduktimit të vendeve të punës apo efekteve të tjera anësore që vijnë nga ky fenomen. Megjithatë, në aspektin makro, përfitimi dhe dobishmëria që i vjen ekonomisë së një vendi nga integrimi rajonal ka një impakt shumë herë më të madh se sa efektet anësore që pëson një vend i përfshirë. Në anën tjetër, në kuadrin e një zhvillimi rajonal, vetë fakti që konkurrenca është mes agjentëve ekonomike me karakteristika dhe shkallë zhvillimi pak a shumë të ngjashme, u jep këtyre të fundit mundësinë të mbijetojnë ose të transformohen dhe përshtaten me kushtet e reja që imponon tregu, duke u bërë më të fortë për të konkurruar në tregjet globale.

Përfshirja në procesin e integritimit ekonomik rajonal dhe parimi i rrathëve

Natyrisht që zhvillimi rajonal dhe integrimi ekonomik nuk është një proces afatshkurtër por i ngjan një rruge të gjatë me

⁸ *Ibidem.*

shumë stacione dhe sfida për të kaluar. Ai fillon me tendencën për liberalizimin ekonomik të vendeve të përfshira në proces, e më tej me heqjen e barrierave të ndryshme, të cilat në një mënyrë a në një tjetër pengojnë zhvillimin e tregtisë dhe lëvizjen e lirë të mallrave-shërbimeve si edhe faktorëve të kapitalit.

Megjithatë, ashtu sic theksojnë Brow & Ruta (2007), procesi ekonomik i integritit, në pjesën më të madhe të rasteve, shoqërohet edhe me procesin politik të tij. Edhe pse jo në të gjitha rastet, integrimi ekonomik është shoqëruar nga ai politik, duhet thënë që bashkërendimi i këtyre dy proceseve është një gur themeli për një mbarëvajtje më të mirë të procesit të zhvillimit dhe integritit rajonal. Kështu, pas krijimit të Komisionit Europian (i quajtur më vonë Bashkimi Europian), në vitin 1995, vendet që preferuan integrimin ekonomik pa një angazhim politik direkt të tyre, krijuan kryesisht tre blloqe të zonave të tregtisë së lirë duke filluar me më të rëndësishmen EFTA.⁹ Shumë anëtare të EFTA-s, si UK, Austria, Suedia, Portugalia dhe Danimarka, më vonë preferuan t'i bashkoheshin BE-së, duke hequr dore nga anëtarësia në këtë organizëm.

Në anën tjetër, përfshirja “*en-block*” e disa prej vendeve të bllokut ish-komunist të Europës Lindore në tregun e madh e të zhvilluar europian pa një strategji të mirëmenduar, ka krijuar probleme për këto vende duke e zgjatur pak më tepër se duhet përshtatjen e tyre me vendet e zhvilluara.¹⁰ Natyrisht kjo vjen edhe për shkak të aplikimit dhe imponimit (*pa u dhënë atyre mundësinë e zgjedhjes*) të një sërë kriteresh strikte nga ana e BE-së, të cilat nuk janë lehtësisht të adaptueshme nga vendet aspirante.¹¹ Edhe pse janë nxjerrë mësim nga historia e vendeve të para të CEFTA-s,¹² që më pas iu bashkuan BE-së, edhe pse një pjesë e mirë e politikave të hartuara në Bruksel

⁹ European Free Trade Association

¹⁰ Bergs (2001)

¹¹ Brow & Ruta (2007)

¹² Central European Free Trade Agreement

janë përpjekur të jenë me lehtësisht të aplikueshme, përsëri duhet thënë që vendet aspirante hasin vështirësi në drejtim të implementimit me rigorozitet të tyre.

Pavarësisht nga sa më sipër, duhet thënë se përfshirja e vendeve në zhvillim në procesin e zhvillimit rajonal është një proces mjaft i rëndësishëm për përgatitjen e tyre përballë një integrimi ekonomik gjithnjë e më global. Parë në këtë këndvështrim, procesi i zhvillimit rajonal i ngjan teorisë së rrathëve që krijojnë valët në një pellg me ujë, ku epiqendra e rrathëve është vendi në zhvillim, ndërsa rrathët janë hallkat e integritit, ose me fjalë të tjera, tërheqja e investitorëve të huaj. Kështu, në bazë të këtij parimi, zhvillimi rajonal i jep mundësinë kapitalit të vendeve pjesëmarrëse të lëvizë lirshëm në hapësirën e përbashkët gjeografike dhe ekonomike duke u koncentruar sipas parimit të “komplementaritetit”, i cili synon edhe alokimin e burimeve në mënyrë sa më eficiente. Ky proces do mundësojë konsolidimin e kapitalit dhe krijimin e agjentëve ekonomikë të aftë për të konkurruar në kushtet e një integrimi ekonomik me blloqe apo tregje ekonomike më të zhvilluara. Pikërisht në këtë fazë të dytë, kemi një zgjerim të rrathëve të valës së integritit të kapitalit, nëpërmjet fluksit të IHD-ve nga vendet e zhvilluara në drejtim të bllokut rajonal ekonomik.

Thënë ndryshe, nëse për shembull marrim si njësi të zhvillimit rajonal, Ballkanin Perëndimor, vihet re qartë që si valë e parë e integritit dhe zhvillimit rajonal kemi domonimin e investimeve greke dhe sllovene duke blerë, apo u bashkuar, apo shkrirë me kompani vendase, shqiptare, malazeze, serbe, maqedonase etj. Ndërsa, në fazën e dytë të konsolidimit dhe prevalimit të këtyre agjentëve ekonomike në tregun rajonal, kemi fazën e integritit të këtyre agjentëve në tregjet e zhvilluara duke tërhequr vemendjen e investitorëve dhe partnerëve seriozë nga vendet e zhvilluara si Austria, Gjermania Franca dhe Italia.

Vendet e Ballkanit duhet të lënë mënjane mosmarrveshjet etnike

Nëse qëndrojmë pikërisht tek rajoni i Ballkanit Perëndimor, dhe perpiqemi që analizën ta zgjerojmë pikërisht në drejtim të problematikës që has zhvillimi rajonal në këto vende, duhet thënë që kjo zonë karakterizohet edhe nga disa probleme shtesë që kanë të bëjnë me historinë apo konfliktet territoriale, etnike e kulturore. Edhe teorikisht një pjesë e mirë e literaturave ekonomike i mëshon faktit që fluksi i kapitalit udhëhiqet nga siguria dhe nga norma e kthimit, përsëri eksperiencia ka treguar që probleme të tilla territoriale, apo konflikte të forta etniko-fetaro-kulturore, kanë degjenuar në risqe të forta politike në sytë e investitorëve të huaj duke i penguar ata ta shohin Ballkanin si një shans të mirë për të investuar, e për rrjedhojë, duke zgjatur akoma më tepër procesin e gjatë të integritimit të këtij rajoni në tregjet e zhvilluara.

Për sa më sipër, gjykohet që lënja mënjane madje, kapërcimi i mjaft problemeve krejtësisht të panevojshme, që kanë për bazë grupime apo qarqe ekstremiste nacionaliste do të ishte një gur themeli për një zhvillim rajonal shumë më të qëndrueshëm, duke u dhënë mundësinë vendeve të Ballkanit Perëndimor të hedhin hapa përpara në drejtim të rritjes së shpejtë ekonomike. Ky do ishte një hap i qartë dhe i vendosur drejt një bashkëpunimi me eficient, duke i përgatitur agjentët ekonomikë rajonalë më mirë drejt sfidave që sjell tregu i përbashkët europian dhe më tej, atij global.

ORGANIZIMI I ZHVILLIMIT RAJONAL***Ballkani Perëndimor, bashkëpunim që prej një dekade***

Të dala nga i njëjti sistem totalitar, me thuajse të njëjtat karakteristika, vendet e Ballkanit Perëndimor, kaluan drejt ekonomisë së tregut pothuaj si të gjitha vendet e ish-

bloku komunist. Megjithatë, ndryshe nga vendet e ish-Jugosllavisë, Shqipëria i hynte kësaj sfide me më shumë mungesa dhe disavantazhe të dukshme e të padukshme. Kjo për shkak se vendet e tjera i kishin deri në një farë mase të kënaqshme të zgjidhura mjaft çështje duke filluar që nga filozofia e funksionimit të pronës private e deri tek infrastruktura e ngritur (*ish-Jugosllavia mbahej si një ndër vendet me infrastrukturën më të zhvilluar në vendet e Europës Lindore*) e deri tek elementë të tjerë të rëndësishëm për zhvillimin shoqëror si rregjistri i qytetarëve apo dokumentat hipotekore. Pavarësisht kësaj, duhet theksuar fakti se luftërat e forta etnike dhe territoriale që shoqëruan shkëputjen e vendeve të ndryshme si Kroacia, Bosnja-Herzegovina apo Kosova nga trangu i ish-Jugosllavisë, i shkaktuan vendeve sllave të Ballkanit Perëndimor, një kosto marramendëse në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies. Edhe pse jashtë këtyre zhvillimeve (fakt që mund të konsiderohej një avantazh), në vitin 1997 Shqipëria u përfshi në rënien e skemave piramidale, dhe një luftë civile, e cila pothuaj zhduku cdo vlerë të shtuar të krijuar nga ekonomia shqiptare në 5 vjecarin e parë pas shembjes së kounizmit, duke e vënë në të njëjtën vijë starti me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, në aspektin ekonomik të fjalës.

Parë në këndvështrimin e bashkëpunimit ekonomik dhe rajonal, duhet thënë që në vitet e para pas 90's, bashkëpunimi ekonomik ishte i dominuar prej importeve nga vendet e zhvilluara (kryesisht BE), për shkak edhe të mungesës së mallrave dhe shërbimeve më elementare të konsumit të përditshëm. Megjithatë, me kalimin e kohës filloi të intensifikohej edhe bashkëpunimi ekonomik rajonal edhe pse me hapa të avashtë dhe barriera të konsiderueshme. Pavarësisht kësaj, në 10-15 vitet e fundit marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale mes vendeve të rajonit kanë liberalizuar hap pas hapi zhvillimin rajonal të vendeve të Ballanit Perëndimor.

Mbështetja nga Pakti i Stabilitetit në SEE që prej 2005

Në fakt, CEFTA është një nga arritjet më të mëdha të bashkëpunimit rajonal në SEE të nxitura nga Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore dhe duhet thënë që përpara se kjo marrëveshje të hynte në force, ka kaluar një proces relativisht të gjatë. Ekspertët ekonomikë të këtij organizmi sugjeruan që në vitin 2001 krjimin e një marrëveshjeje të vecante për të gjithë vendet e SEE. Megjithatë, një gjë e tillë nuk u bë e mundur që në atë kohë, por i hapi rrugën vendimit për ngritjen e një rrijeti të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë (MTL) bilaterale mes vendeve të rajonit. Kështu, nën kujdesin e Paktit të Stabilitetit, deri në vitin 2008 u nënshkruan rreth 32 MTL bilaterale dhe ky konsiderohet si një sukses.¹³ Mjafton të përmendësh faktin që Shqipëria, e cila në 2001 nuk kishte asnjë MTL të nënshkruar, në vitin 2005, kishte nënshkruar 7 të tilla me vendet e rajonit. Nënshkrimi i këtyre MTL-ve ndihmoi në përmirësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike e politike mes vendeve të përfshira si dhe coi në përfundimin që një marrëveshje e përbashkët do të sillte më shumë përfitime për vendet nënshkruese. Kështu në vitin 2006 u nënshkrua edhe marrëveshja e CEFTA-s për vendet e SEE ndërsa për një pjesë të konsiderueshme të tyre (përfshi Kosovën) ajo hyri në fuqi një vit më vonë.¹⁴

- MTL-të bilaterale ndërshtetërore

Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (MTL) janë instrumente që lehtësojnë liberalizimin e tregtisë së lirë mes vendeve të caktuara duke u bazuar në përputhjen e interesave të përbashkëta me qëllim maksimizimin e dobishmërisë për ekonominë e përfshira. Zakonisht MTL-të, janë bilaterale

¹³ *shih* Drabek & Laird (1997) dhe Busek (2008)

¹⁴ Busek (2008)

dhe kanë për qëllim intensifikimin dhe nxitjen e tregtisë së lirë mes dy vendeve nënshkruese.

- CEFTA (pjesa më e madhe anëtare që në 2007, Maqedonia 2006)

CEFTA është një tjetër organizëm i cili shihet si një instrument parapërgatitor për zhvillimin rajonal të vendeve që aspirojnë për t'u bërë anëtare të tregut të gjerë europian. I iniciuar në vitin 1992 nga katër vendet Vishegrad-it, ky instrument u përdor në rolin e paradhomës, në aspektin e liberalizimit ekonomik dhe zhvillimit rajonal, për mjaft vende të Europës Lindore, një pjesë e mirë e të cilave tashmë është pjesë e BE-së. Sa i përket vendeve të Ballkanit Perëndimor, të gjitha vendet janë anëtare të CEFTA-s që në vitin 2007, me përjashtim të Maqedonisë e cila është anëtarësuar në vitin 2006.¹⁵ Sipas ekspertëve, edhe pse volumi i tregtisë për vendet e këtij rajoni ka ardhur duke u rritur me një ritëm më të shpejtë krahasuar me periudhën para nënshkrimit të Marrëveshjes së CEFTA-s, përsëri ai ngelet në nivele që lënë për të dëshiruar, dhe kjo kryesisht vjen për shkak të mbetjes ende në fuqi të barrierave jortarifore.¹⁶

Tashmë të gjitha vendet e CEFTA janë përfshirë në procesin e integritimit në Bashkimin Europian. Përvec Kosovës pothuaj të gjitha vendet e rajonit kanë nënshkruar Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit (MSA) me BE-në¹⁷ dhe po punojnë intensivisht për të adaptuar kërkesat e Brukselit zyrtar me kushtet e secilit prej vendeve përkatëse.

¹⁵ Tempera (2010)

¹⁶ *shih* Bobek (2010)

¹⁷ Kroacia dhe Maqedonia janë tashmë vende candidate për t'u anetaresuar në BE, ndersa vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor po përpunohen që të kalojnë në statusin e vendit kandidat.

SHQIPËRI - KOSOVË 2 VENDE, 1 TREG

Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete të cilat kanë një popullsi të banuar nga shtetas me të njëjtën kombësi. Shqipëria si një shtet me një histori pothuaj një shekullorë, është një vend i cili është përplasur shumë ndër vite duke u përballur me konjunkturën politike dhe ekonomike për ndarjen territoriale kryesisht nga vendet fqinje. Ndërsa Kosova, një shtet me një histori vetëm 3 vjeçare, është një shtet në ngritje e sipër dhe tashmë i pranuar edhe në arenën ndërkombëtare me mbi 80 njohje zyrtare nga vende të ndryshme të OKB-së.

Në aspektin ekonomik, është e natyrshme që Shqipëria ka bërë shumë më përpara, kryesisht për shkak të faktit që ka qenë një shtet i pavarur dhe krejtësisht vetëvendosës për fatet e veta. Pavarësisht luhatjeve politike dhe luftës shterpë që prodhon papërgjegjshmëria e një vendi të vogël Ballkanik, Shqipëria ka bërë hapa të vendosur përpara drejt konsolidimit si një shtet në ngritje e sipër, nëpërmjet reformave ekonomike e strukturore. Ndërsa Kosova, një vend i dalë nga një sërë reperkusionesh shoviniste, raciste e etnike, të cilat degraduan në luftra për spastrim etnik, ka harxhur mjaft mund e burime financiare pa pasur mundësinë të ketë një kurs normal zhvillimi ndër vite. Edhe pas miratimit të Rezolutës 1244 në periudhën e pas luftës, Kosova ishte shumë e cinguar në drejtim të menaxhimit real të burimeve të saj. Ndërkohë, që pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ka filluar të zhvillohet me ritme normale edhe kjo vjen kryesisht edhe për shkak të kompetencave, pjesa më e madhe e të cilave tashmë i janë transferuar klasës politike vendase.

Procesi i formimit të shtetit dhe institucioneve më i konsoliduar në Shqipëri

Një tjetër faktor i rëndësishëm, i cili ka ndikuar në zhvillimin me hapa relativisht më të shpejtë të Shqipërisë krahasuar me

atë në Kosovë, është edhe fakti që tashmë Shqipëria është një demokraci më e konsoliduar, me institucione të pavarura të cilat sa vijnë dhe koracojnë “*de-facto*” rolin e tyre të pavarur në shoqëri. Megjithatë, duhet thënë që kryesisht për shkak të një kulture institucionale të trashëguar nga sistemi i ish-Jugosllavisë, mjaft intitucione kosovare kanë treguar një nivel të kënaqshëm ekspertize dhe pavarësie në raste kyce të përplasjeve të vogla politike, duke i dhënë herë pas here leksione korrekte edhe homologëve të tyre në Tiranë.

Prirja për bashkëpunim ekonomik-social më e madhe mes dy vendeve

Edhe pse teorikisht, vende apo shtete, popullsia e të cilëve i përket të njëjtit komb, me gjuhë, histori, zakone dhe sjellje sociale të përbashkëta, kanë gjasa të një bashkëpunimi më të madh mes tyre, duhet thënë që niveli i shkëmbimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Kosovës lë shumë për të dëshiruar.

Kështu nëse u hedhim një sy statistikave të publikuara nga ACIT, gjatë viti 2010, pjesa që zënë eksportet shqiptare drejt Kosovës, edhe pse me një rritje vjetore prej 35.6%, përsëri përbën vetëm 6.1% të totalit të eksporteve të vendit. Ndërsa sa i përket fluksit të tregtisë së Kosovës në drejtim të Shqipërisë, edhe pse me një rritje vjetore prej 16.2%, përsëri importet nga Kosova zënë vetëm 0.9% të totalit të importeve shqiptare.¹⁸ Ndërkohë që parë në këndvështrimin e peshës që kanë tregtia e Kosovës me Shqipërinë, duhet thënë që gjatë vitit 2008, eksportet kosovare drejt Shqipërisë zinin rreth 10.75% të totalit të eksporteve, ndërsa importet janë një zë krejtësisht i papërfillshëm krahasuar me atë që vjen nga vendet e tjera.¹⁹

¹⁸ ACIT, Annual Report 2010, *Albanian Center for International Trade*, Tirana, pg. 37

¹⁹ *Per me shume info shih* MIT (2009), “Trade Policy of Kosova 2008”, Ministry of Trade and Industry in Kosova, Pristina, August 2009, pg. 13

Ndërkohë që nëse tenton të shikosh orientimin politik të politikave ekonomike, vihet re që të dy vendet ndjekin një frymë krejtësisht liberale dhe në harmoni të plotë me nismat apo organizmat e bashkëpunimit rajonal ku janë përfshirë (CEFTA, MTL-te, MSA etj.). Më konkretisht, dokumentat zyrtare të politikave ndërkombëtare flasin për frymën e librealizimit dhe heqjes së barrierve tarifore apo reduktimin në maskimum të atyre jo-tarifore.²⁰

De-facto, nivel i ulët i bashkëpunimit bilateral

Pavarësisht pritshmërive për një bashkëpunim të lartë mes dy vendeve, duhet thënë që edhe pse me një tendencë rritjeje, përsëri volumi i tregtimit mes Shqipërisë dhe Kosovës mbetet në nivele krejtësisht të pakënaqshme. Kështu, sa i përket eksporteve të dy vendet kanë si partnerë kryesorë vendet e BE-së (me një dominim të Italisë, kryesisht për shkak të punës dhe prodhimit me fason), në importe, është përsëri BE-ja partneri kryesor për Shqipërinë ndërsa Kosova mbetet ende peng i fluksit të konsiderueshëm të importeve nga vendet e ish-Jugosllavise ku pjesën me të madhe e zënë Maqedonia dhe Serbia.²¹

Sado që vendimi i Qeverisë së Kosovës për t'iu përgjigjur me parimin e reciprocitetit vendimit të Serbisë për moslejimin e penetrimit të produkteve dhe shëbimeve kosovare në tregun e tyre, përsëri, gjykojmë se rritje e fluksit të tregtisë mes dy vendeve kërkon një kohë relativisht të gjatë, nëse këto zhvillime i lihen thjesht dhe vetëm spontanitetit apo evoluimit normal të tregjeve, pa i nxitur ato.

²⁰ shih MTI (2008), "Trade Exchanges of Kosova 2008", Ministry of Trade and Industry in Kosova, Pristina, July 2008, pg. 8

²¹ per informacion me te detajuar shih ACIT (2010), MIT (2008) dhe MIT (2009)

C'DUHET BËRË PËR INTEGRIMIN SAMË TE SHPEJTË MES SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Përmirësimi i infrastrukturës dhe ambjentit të biznesit në mënyrë që të mundësojë me ritme të shpejta liberalizimin e tregtisë dhe shkëmbimit të faktorëve të prodhimit mes dy vendeve është edhe kyçi i suksesit. Parë në këtë këndvështrim, tre janë rrugët dhe instrumentat ku duhet rishikuar pozicioni jo vetëm i dy vendeve por edhe i agjentëve ekonomikë shqiptarë që jetojnë e ushtrojnë aktivitetin e tyre në këto dy vende:

1. Shteti – *nëpërmjet bashkëpunimit institucional dhe administrativ*
2. Biznesi – *nëpërmjet bashkëpunimit dhe besimit të ndërsjellë*
3. Konsumatori – *nëpërmjet preferencës konsumatore.*

Shteti: Bashkëpunim Institucional dhe Administrativ

Ashtu sic e kanë vënë në dukje studiues të ndryshëm, bashkëpunimi në nivel shtetëror, ndikon jashtëzakonisht në rritjen dhe intensifikimin e marrëdhënieve tregtare dhe bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve të caktuara. Madje, ka prej tyre që gjykojnë që integrimi ekonomik duhet të jetë i lidhur ngushtë edhe me integrimin politik mes dy vendeve (duke deklaruar se janë procese plotësuese të njëri-tjetrit) me qëllim rritjen e volumit të shkëmbimit ekonomik.²²

Pikërisht ky fenomen, pra bashkërendimi i politikave për integrimin politik dhe ekonomik mes dy vendeve është edhe modeli që duhet të tentojnë të aplikojnë të dy vendet. Fakti që Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete të një kombi, me histori, gjuhë dhe kulturë të njëjtë e bën më të lehtë dhe krejtësisht të absorbueshëm edhe integrimin politik, përveç atij ekonomik që mund të arrihet edhe me vende të tjera të rajonit.

²² Brow & Ruta (2007)

Edhe pse ka shenja të qarta bashkëpunimi mes sektorëve të caktuar të ekonomisë së vendit,²³ përsëri duhet thënë që ky bashkëpunim është pak më shumë se sporadik, i fragmentarizuar dhe i pa harmonizuar me politika konkrete ndër-sektoriale, të cilat do i mundësonin ekonomisë së dy vendeve arritjen e ekonomisë së shkallës nëpërmjet alokimit më eficient të burimeve. Për këtë arsye, gjykohet me vend krijimi i grupeve të përbashkëta të punës mes dy qeverive, ku të hartohen strategji të përbashkëta mbarëkombëtare, të cilat të jenë parimisht ndër-sektoriale, të përfshijnë konceptet bashkëkohore të konkurrencës mbi baza komplementariteti si dhe të jenë në një linjë me teoritë e integritit, jo vetëm ekonomik por edhe atij politik, pa synuar asnjëherë cënimin e ndryshimit të kufinjve territorialë të të dy vendeve.

Më konkretisht:

- **Treg Komplementar dhe Konkurrues:** duke qenë të paintegruara sa duhet, Shqipëria dhe Kosova janë tregje të vogla në sytë e investitorëve të huaj. Për rrjedhojë, integrimi rajonal mbarëkombëtar i tyre do krijonte një treg konsumator të përbashkët prej rreth 6 milionë banorë, të cilëve po t'u shtosh edhe shqiptarët autoktonë që jetojnë në Maqedoni dhe Mal te Zi (me karakteristika pothuaj të njëjta në drejtim të zgjedhjes konsumatore), kjo hapësirë përbën një treg prej 7 milionë banorësh.
- **Arritja e Sinergjisë:** pikërisht përdorimi i burimeve dhe faktorëve të prodhimit mbi baza komplementare mes dy vendeve, do të mundësojë arritjen e një sinergjie pozitive nëpërmjet ekonomisë së shkallës duke mundësuar edhe një zhvillim me ritme të shpejta të ekonomisë mbarëkombëtare.

²³ Ka një bashkëpunim institucional konkret në sektore si p.sh: sektori energjistik, marrëveshje bashkëpunimi mes ministrive të ekonomisë apo drejtorive të doganave e atyre të policisë etj.

Për të qenë më konkretë, Shqipëria dhe Kosova mund të arrijnë sinergjinë dhe të jenë komplementare në drejtim të turizmit duke gërrshetur me stinë dhe kohë të ndryshme (*psb: turizmin detar – malor dhe atë historik*), energjinë elektrike duke shfrytëzuar burimet hidrike të Shqipërisë në dimër dhe burimet natyrore (qymyrgurin) e Kosovës për TEC-et në verë etj.

- **Bashkëpunim në Nivel Shtetëror:** koordinim dhe bashkëpunim i ngushtë në nivel ministrish, drejtorish si dhe entesh rregullatore për të mundësuar një treg të lirë e të ndershëm në drejtim të konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorit, por edhe një ambient atraktiv për investimet e huaja direkte.
- **Harmonizim Legjislacioni:** përmirësimi dhe harmonizimi i legjislacionit me kahje drejt de-rregullimit dhe heqjes së barrierave të panevojshme administrative (*sidomos regjimin e taksave dhe tarifave apo reduktim të burokracive*) me qëllim lehtësimin e procedurave për shkëmbimin e mallrave, shërbimeve dhe faktoreve të prodhimit mes dy vendeve.
- **Nxitje e Prodhimit Vendas (shqiptar):** nëpërmjet hartimit të politikave të përbashkëta me qëllim nxitjen e konkurrencës brenda hapësirës mbarëkombëtare, por edhe nxitjen e prodhimit vendas, të paktën në fazën e ngritjes (*start-up*) ose në drejtim të ngritjes së kapaciteteve për të konkurruar (*standardizim dhe certifikim të produkteve*) në tregjet rajonale e me gjerë.
- **Edukimi:** është një tjetër shtyllë e rëndësishme ku duhet të fokusohet vëmendja e autoriteteve me qëllim edukimin e krahut të punës sipas kriterëve bashkëkohorë, duke vënë një theks të vecantë në drejtim të procesit të kërkim – zhvillimit si një mjet i mirë për përmirësimin dhe nxitjen e zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve të prodhuara në hapësirën mbarëkombëtare. Kjo kërkon një bashkëpunim të ndërsjellë në drejtim të hamrmonizimit të kurrikulave akademike

sipas nevojave që ka tregu dhe përparësive ekonomike që paraqet hapësira mbarëkombëtare.

Komuniteti i Biznesit: Bashkëpunim dhe Besim i Ndërsjelltë

Pavarësisht barrierave të ndryshme tarifore dhe jo tarifore që kanë ekzistuar në drejtim të shkëmbimit tregtar dhe ekonomik mes dy vendeve duhet thënë që një pjesë jo të vogël të “fajit” e ka edhe vetë komuniteti i biznesit në vendet përkatëse. Pavarësisht se shtetas të të njëjtit komb, vihet re një ndjenjë mosbesimi dhe moskorrekte në marrëdhëniet mes biznesit shqiptar dhe atij kosovar. Kjo ndihet qartë, edhe pse nën zë, në puthuaj të gjitha misionet e biznesit ndërmjet dy vendeve, ku numri i bashkëpunimeve që krijohen lë shumë për të dëshiruar, edhe pse me tendencë të lehtë rritjeje nga vitit në vit. Paradoksal është fakti që pikërisht të njëjtat biznese shqiptare dhe kosovare që hezitojnë të bashkëpunojnë në mënyrë direkte me njëra-tjetrën, janë krejtësisht korrekte në marrëdhëniet me palët e treta, apo me biznese që vijnë nga vende të tjera të rajonit.

Për këtë arsye, krijimi i urave të bashkëpunimit mes biznesit mbarëkombëtar është një ndër pikat ku duhet të fokusohet shumë jo vetëm vëmendja e politikëbërësve por e vetë këtij komuniteti. Natyrisht nxitja e bashkëpunimit institucional mes organizmave dhe përfaqësive të biznesit në vendet respektive do të ishte një garanci më e madhe dhe një gur themeli për krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme mbi bazat e interesit dhe besimit të ndërsjelltë. Në anën tjetër, vetë komuniteti i biznesit duhet të mësojë të jetë korrekt në zbatimin e kontratave, jo vetëm me të huajt, por edhe me biznesin që vjen nga viset shqiptare.

Një tjetër element i rëndësishëm ku duhet të drejtohet vëmendja e komunitetit të biznesit në viset shqiptare, ka të bëjë me parimin e “vetë-mjaftueshmërisë” ose thënë ndryshe përdorimit të burimeve dhe faktorëve të prodhimit (*toka, kapitali, krahu i*

punës etj.) me një efikasitet më të lartë duke përdorur parimin e komplementaritetit. Pikërisht, nëse komuniteti i biznesit arrin që t'i alokojë kapitalet e lira në mënyrë të tillë, ekonomia e dy vendeve do fitojë momentum nëpërmjet sinergjisë së krijuar duke maksimizuar nivelin e rritjes ekonomike të të gjithë hapësirës mbarëshqiptare.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishmja, sistemi financiar në Shqipëri dhe Kosovë, i ka të gjitha mundësitë për nxitjen e rritjes së fluksit të transaksioneve ekonomike dhe financiare mes dy vendeve. Për shembull, aplikimi i tarifave më të ulëta për transaksionet e biznesit dhe qytetarëve mes dy vendeve do ishte një bazë e mirë për fuqizimin e shkëmbimit dhe zhvillimit ekonomik në një nivel më të lartë në të ardhmen.

Konsumatorët: Në kushte të njëjta cilësie dhe cmimi, BLEJ SHQIP

Sipas studiuësve të shumtë të sjelljes së konsumatorëve dhe fenomeneve të tjera që kanë lidhje direkte ose indirekte me të, preferencat individuale në konsum mund të ndryshojnë në varësi të kushteve.²⁴ Edhe pse teoritë e zgjedhjes konsumatore fokusohen kryesisht në efektet që ka ky fenomen në drejtim të kërkesës agregate, përsëri duhet thënë që në kushte të njëjta cilësie dhe cmimi ky fenomen (*zgjedhja konsumatore*) bazohet në preferenca të ndryshme individuale, si ngjyra, paketimi, komoditeti, kohëzgjatja etj.

Parë në këtë këndvështrim, gjykoj që në kushtet kur një pjesë jo e vogël e produkteve dhe shërbimeve shqiptare e kosovare kanë filluar të jenë denjësisht konkurruese, si në aspektin cilësor ashtu edhe në drejtim të cmimeve të aplikuara në tregje, sjellja konsumatore e qytetarëve shqiptarë ndaj këtyre produkteve duhet të jetë më miqësore. Me fjalë të tjera, "***Në kushte të njëjta cilësie dhe cmimi, Blej Shqip***" duhet të jetë një moto që duhet të shoqërojë konsumatorët shqiptarë në të dy vendet, me qellim

²⁴ Gowdy & Mayumi (2001)

nxitjen dhe mbështetjen e ngritjes ekonomike mbarëshqiptare. Është për të të ardhur keq që, edhe pse në këto vise prodhohen produkte tashmë të certifikuara dhe cilësore, të cilat janë konkurrencte edhe në aspektin e politikave të cmimeve, përsëri sa për inferioritet ndaj produkteve të huaja, sa për snobizëm, konsumatorët shqiptare (*ky fenomen është më i përhapur në Shqipëri se në Kosovë*) vazhdojnë të kenë një qasje jo fort pozitive ndaj produkteve dhe shërbimeve vendase.

Kundrejt akuzave për proteksionizëm që mund të ngrihen në drejtim të kësaj qasjeje, përgjigja e vetme është thjesht preferenca konsumatore, e cila në këtë rast bazohet në ndjenjën e ngritjes së ekonomisë kombëtare, për shkak se agjentët ekonomikë të cilët i ofrojnë këto produkte dhe shërbime në treg, janë kompani të cilat u paguajnë taksa Shqipërisë dhe Kosovës, punësojnë njerëz në këto vende dhe të ardhurat e tyre konsumohen përsëri në këtë hapësirë ekonomike mbarëkombëtare.

Aplikimi i preferencës konsumatore mbi baza kombëtare (*Blej Shqip në kushte të njëjta cilësie dhe cmimi*) do të nxiste:

- Vetëmjaftueshmërinë ekonomike në hapësirën mbarëkombëtare,
- Reduktimin e varësisë nga importet,
- Akumulimin e kapitalit në vend,
- Nxitjen e zhvillimit ekonomik të shkallës në tregun e përbashkët,
- Rritjen e të ardhurave në buxhetin e Shqipërisë dhe Kosovës.

BIBLIOGRAFI

1. ACIT, “**Annual Report 2010**”, *Albanian Center for International Trade*, Tirana
2. Baldwin, R. (2011), “**21st Century Regionalism: Filling the gap between 21st century trade and 20th century trade rules**”, *WTO* staff working papers ERSD-2011-08, Geneva, May 2011, http://www.wto.org/english/res_e/reser_e/ersd201108_e.pdf
3. Bergs, R. (2001), “**EU Regional and Cohesion Policy and Economic Integration of the Accession Countries**”, *Discussion Paper* presented at the international conference on *Regional Transitions: European Regions and the Challenges of Development, Integration and Enlargement*, convened by the Regional Studies Association at the Faculty of Economics, University of Gdansk, 15-18 September 2001, <http://papers.ssrn.com/abstract=297437>
4. Bobek, V. (2010), “**Doing Business in SEE**”, Workshop Doing Business in South-Eastern Europe: *Prospects, Issues, Potential*, Graz, Austria, March 4th, 2010, <http://icic.ro/docs/Vito%20Bobek.pdf>
5. Brow, D. & Ruta, M. (2007), “**Economic Integration, political integration or both?**”, *WTO* working papers, http://www.wto.org/english/res_e/reser_e/gtdw_e/wkshop08_e/ruta_e.pdf
6. Busek, E (2008), “**CEFTA and Beyond**”, interview for SEE Investment Compact, OECD publications, Spring 2008, <http://www.investmentcompact.org/dataoecd/1/54/40315616.pdf>
7. Civici. A (2009), “**Globalizmi Ante Portas**”, Shpëtia Botuese UET Press, Tiranë
8. Drabek, Z. & Laird, S. (1997), “**The New Liberalism: Trade Policy Developments in Emerging Markets**”, *WTO* staff working papers ERAD9707.WPF, Geneva, January 1997, http://www.wto.org/english/res_e/reser_e/pera9707.pdf
9. MTI (2008), “**Trade Exchanges of Kosova 2008**”, Ministry of Trade and Industry in Kosova, Pristina, July 2008, http://www.mti-ks.org/repository/docs/SHkembimet_tregtare_eng.pdf
10. MIT (2009), “**Trade Policy of Kosova 2008**”, Ministry of Trade and Industry in Kosova, Pristina, August 2009, <http://www.mti-ks.org/>

repository/docs/Trade_Policy_of_Kosovo_2009.pdf

11. Tempera, M. (2011), “**FTAs in Western Balkans: CEFTA’s Achievements and Problems**”, *PECOB Business Reports*, March 2011,
12. <http://www.pecob.eu/flex/cm/pages/...php/L/EN/D/.../BLOB%3AID%3D3029>
13. Shams, R. (2003), “**Regional Integration in Developing Countries: Some Lessons Based on Case Studies**”, Hamburg Institute of International Economics, *HWWA Discussion Papers*, No. 251, Hamburg, Germany
14. Winter, A. (1996), “**Regionalism versus Multilateralism**”, *WB policy research working papers*, WPS/1687, World Bank, Washington, DC

Websites

www.pecob.eu

<http://www.mti-ks.org>

www.investmentcompact.org

www.worldbank.com

www.wto.org

<http://www.hwwi.org>

<http://www.acit-al.org>

Roli i bujqësisë në zhvillimin ekonomik: Bashkëpunimi ekonomik Shqipëri-Kosovë

Lumnije THAÇI, M.A. _____

Universiteti FAMA

Abstrakt. *Të gjitha vendet në botë, për të përmirësuar ekonominë e për të shtuar volumin tregtar, sipas faktorëve të prodhimit që kanë, specializohen e bëjnë përpjekje për një rrjedhë sa më të lirë të mallrave dhe shërbimeve. Në rastin konkret, faktorët e prodhimit për secilin territor shqiptar më vete janë të pakta, firmat shqiptare në rajon nuk kanë shumë mundësi për informacion e burime të vlefshme për periudhën afatgjatë, prandaj, për të arritur dhe për të shfaqur avantazhet konkurruese, e gjithë hapësira shqipfolëse në Ballkan duhet të shikojë situatën si një treg unik. Kështu krijohet një hapësirë e gjerë me faktor bazë prodhimi të vlefshëm, që duhen menaxhuar së bashku në mënyrë të rinovueshme për shfaqjen e avantazhit konkurrues. Nëse toka bujqësore e Kosovës përdoret për prodhimin e drithrave të bukës, foragjereve e frutave dhe toka bujqësore e fermave të vogla të Shqipërisë për prodhimin e perimeve, në kuadrin e një politike agrare të përbashkët krijohen shanse që tregu të furnizohet me më shumë produkte bujqësore e blegtorale.*

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës i cili gjeneron sasi të konsiderueshme të prodhimeve bujqësore dhe mundësinë e rritjes së punësimit. Burimet natyrore të Kosovës, si dhe rrethanat në qasjen e lirë në tregun e BE-së, tregojnë se Kosova ka një potencial për të rritur prodhimin vendor, pra të zvogëlojë importin me prodhime bujqësore dhe të rrisë eksportin.

Në vitet e fundit Kosova ka shënuar rritje ekonomike, megjithatë në zonat rurale kjo është më pak e theksuar. Më se 60% e popullatës së Kosovës jetojnë në zonat rurale, e cila është mbi mesataren në rajonin e Europës Juglindore. Të paktën 70% e ekonomive familjare rurale varen nga bujqësia duke i dhënë asaj një rol të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë në këto zona. Më shumë se 60% e popullatës në zonat rurale është nën moshën 30 vjeçe dhe papunësia është ende e lartë, por me një përkrahje më të madhe kjo popullatë do të rezultojë me rritje të punësimit dhe ulje të varfërisë në zonat rurale. Barrierat ekonomike nga vendet e rajonit, nënshkruese të marrëveshjes për tregti të lirë(CEFTA), ndikojnë negativisht në zhvillimin ekonomik-bujqësor dhe ne duhet të propozojmë politika për eliminimin e këtyre barrierave kryesore që pengojnë zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë. Hyrja eventuale e Kosovës dhe e Republikës së Shqipërisë në BE kërkon përgatitje në aspektin institucional dhe në atë të administrimit të marrëdhënieve me vendet e tjera anëtare. Më specifikisht, hyrja e Kosovës dhe e Republikës së Shqipërisë në BE, do të thotë liberalizim dhe intensifikim i marrëdhënieve tregtare me vendet e BE-së. Nga ky këndvështrim, CEFTA i ofron të dyja vendeve një mundësi për t'u ushtruar dhe për t'u mësuar me rregullat e lojës në një treg rajonal, në mënyrë që procesi i integritimit në BE të përballohet me sukses.

Sektor i Bujqësisë në Kosovë doli nga lufta mjaft i dëmtuar, mirëpo fal donacioneve, vetiniciativës së fermerëve dhe

mbështetjes institucionale ka arritur në masë të madhe të konsolidohet. Edhe përkundër progresit që është arritur në bujqësi, ky sektor është duke u përballur me probleme. Këto probleme më shumë janë pasojë e një konkurrence të pabarabartë në raport me produktet e importuara. Kosova është e rrethuar me shtete që kanë një bujqësi më të avancuar për shkak të benefiteve që gëzojnë fermerët në këto vende. Për pasojë tregu i produkteve bujqësore vazhdon të jetë i varur nga importi. Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës, vazhdojnë të jenë vendet e CEFT-as. Me këto vende Kosova realizon vlerën më të lartë të eksportit (87%) dhe të importit (44%). Nga totali i vlerës së përgjithshme të importit të produkteve bujqësore nga vendet e CEFT-as janë realizuar **481,452,770/2010**

Vendet nga të cilat importohet më së shumti janë: Serbia(56%), Maqedonia (25.16%), Kroacia (8.37%), B.Heregovina (6.77%) dhe vendet tjera (3.7%).

Sa i përket vlerës së eksportit me vendet e CEFT-as ende është i ulët edhe pse ka trend të rritjes. Nëse krahasohet vlera e eksportit për periudhën 2005-2010, del se në vitin 2005 pjesëmarrja në % e eksport-importit ka qenë 5.58%- 94.42%, ndërsa për vitin 2010 ka qenë 8.20%- 91.80%.

Vendet në të cilat Kosova ka eksportuar më së shumti produkte bujqësore në vitin 2010 janë Shqipëria (62.15%), Maqedonia (18.96%), dhe vendet tjera (18.89%).

Produktet e eksportuara janë; perimet dhe produktet e perimeve (7%), përgatitjet e perimeve dhe e pemëve-zarzavateve (20%), pijet(22%), produktet e industrisë së grurit- mielli (11%).

Vlen të ceket se i vetmi vend me të cilin Kosova ka bilanc pozitiv tregtar është Republika e Shqipërisë (eksport 66.55%, import 33.45%).

Deficiti tregtar i Kosovës me vendet e CEFT-as në vitin 2010 ka qenë **(-54,516,000euro)** krahasuar me vitin paraparak 2009 është diçka më i ulët **(156,204,000 euro)**.

Sa i përket shkëmbimit tregtar me Shqipërinë, vlera totale e importit është: **5, 511,549.16 euro**, nga produktet e importuara dominojnë: frutat dhe perimet, ndërsa totali i vlerës së eksportit është **10,964,705.18 euro**; dominojnë produktet e industrisë bluajtëse dhe perimet.

Në kuadër të produkteve të eksportuara janë edhe patatet. Vlen të përmendet se Kompania eksportuese- importuese: “Pestova”, si dhe kultivuesit e tjerë të patates dhe të rrushit realizojnë një sasi të konsiderueshme në këtë vend. Duke u bazuar në të dhënat e deklaruara të tyre, shteti shqiptar ka krijuar disa barriera tarifore për këto produkte. Në vitin 2009, Republika e Shqipërisë. në mënyrë selektive e ka rritur bazën doganore (baza e taksueshme 20%-tvsh) për patate në 50cent, ndërsa në vitin 2010 në 25cent, edhe pse çmimi shitës i patates është vetëm 15cent, ky duke llogaritur të gjitha shpenzimet variable dhe fikse. I njëjti produkt (patatja) eksportohet edhe në Kroaci e cila doganohet me 16cent.

Në bazë të të dhënave të doganave të Kosovës në vitin 2010 Kosova ka eksportuar në total **3,095,370kg**, me vlerë **3,377,779.65 euro**, nga kjo sasi në Shqipëri ka eksportuar **1,448,990kg** patate me vlerë **172,866.25euro** (46% e totalit të eksportit).

Nëse shikojmë marrëveshjet tregtare kjo bie ndesh me marrëveshjen e CEFT-as, OBT-së dhe me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP).

Por ka shpresa të mëdha që kjo çështje do të rregullohet pasi Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, zoti Sali Berisha, dha premtimin se më nuk do të aplikohen çmime referente n doganore për mallra të cilat eksportohen nga Kosova në Shqipëri dhe anasjelltas. Gjithashtu unë i referohem këtu një premtimi të kryeministrit që porti i Shëngjinit do të jetë porti i Kosovës. Krahas këtij porti, po aq i rëndësishëm është edhe porti i Durrësit. Mendoj që për t'i paraprirë kësaj situate është shumë i rëndësishëm krijimi i një infrastrukture në portet

shqiptare për t'u krijuar mundësi biznesmenëve nga Kosova që të operojnë në këto porte.

Ajo çfarë na bën optimistë për të ardhmen është edhe aksi i rrugës kombëtare, rrugë e cila do të lidhë dy vendet tona dhe do t'u jap frymëmarrje tregjeve dhe në njëfarë mënyre bën një hapje qoftë të tregut shqiptar për ta kthyer atë në një port rajonal, por edhe më gjerë në drejtim të Italisë dhe vendeve tjera përrëndimore.

Me një rëndësi mjaft të madhe për të dyja vendet është edhe përpjekja për krijimin e avantazheve konkurruese. Pozicionimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Kosovën krijon një situatë të përshtatshme për faktorin shqiptar në rajon dhe ndihmon në rivendosjen e balanceve në Ballkan, ku aspektet ekonomike dhe tregtare janë shumë të rëndësishme. Të gjitha vendet në botë, për të përmirësuar ekonominë e për të shtuar volumin tregtar, sipas faktorëve të prodhimit që kanë, specializohen e bëjnë përpjekje për një rrjedhë sa më të lirë të mallrave dhe shërbimeve. Në rastin konkret, faktorët e prodhimit për secilin territor shqiptar më vete janë të pakta, firmat shqiptare në rajon nuk kanë shumë mundësi për informacion e burime të vlefshme për periudhën afatgjatë, prandaj, për të arritur dhe për të shfaqur avantazhet konkurruese, e gjithë hapësira shqipfolëse në Ballkan duhet të shikojë situatën si një treg unik. Kështu krijohet një hapësirë e gjerë me faktor bazë prodhimi (toka, kapitali, burimet njerëzore dhe teknologjia) të vlefshëm, që duhen menaxhuar së bashku në mënyrë të rinovueshme për shfaqjen e avantazhit konkurrues. Nëse toka bujqësore e Kosovës përdoret për prodhimin e drithrave të bukës, foragjereve e frutave dhe toka bujqësore e fermave të vogla të Shqipërisë për prodhimin e perimeve, në kuadrin e një politike agrare të përbashkët krijohen shanse që tregu të furnizohet me më shumë produkte bujqësore e blegtorale.

Shembuj bashkëpunimi ka shumë, por në themel mbetet menaxhimi eficient dhe efikas i burimeve natyrore e njerëzore

në nivel firme dhe në nivel ekonomie. Nëse i hyjmë debatit, nga bashkëpunimi Shqipëri- Kosovë, tri nga kombet ose popullsitë që do të përfitojnë më së shumti janë sllavët, grekët dhe italianët, që në rastin konkret do të bëhen partnerët më të mëdhenj tregtarë të shqiptarëve, të cilët në një treg unik do të prodhojnë shumë, me cilësi të lartë, me çmime të ulëta dhe pa kosto të larta transporti. Duke marrë në konsideratë mundësitë e shkëlqyera që ofron e tërë hapësira shqiptare, zgjerimi i faktorëve të prodhimit mbi bazën e gjetjes dhe shfrytëzimit të kompetencave bazë të BVM-së krijon avantazhe konkurruese të mira, që garantojnë integrim të shpejtë e cilësor në rajon e më gjerë. Kjo situatë kërkon që vendimet kryesore për fatet e kombit të shikohen në dy aspekte: (1) të lidhura me vendimet strategjike e operacionale në infrastrukturë, në nxitjen e investimeve të huaja, në edukim, në gjetjen e partnerëve strategjikë, në fokusimin te cilësia e produkteve, në arritjen e standardeve ndërkombëtare në nivel firme e sektori etj. Dhe (2) në ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës për të përcaktuar sektorët e fushat e bashkëpunimit, ku sektori i bujqësisë është njëri ndër sektorët më propulziv i cili do të përshpejtojë zhvillimin ekonomik.

Në këtë frymë bashkëpunimi e pune në radhë të parë duhet që të ekzistojë dhe të mbizotërojë interesi, ku rol kryesor luan interesi ekonomik e tregtar, aq më shumë ku si në rastin e Kosovës ashtu edhe të Republikës së Shqipërisë në plan të parë mbetet pa dyshim tregu unik europian, i cili kërkon gjithnjë e më shumë mallra dhe shërbime cilësore nga tregje unike, të diversifikuara dhe konkurruese.

Ecuria e zhvillimit të bujqësisë në Shqipëri dhe në Kosovë: Sfida të përbashkëta dhe nevoja për koordinim të politikave zhvillimore

Dr. Shkëlzen MARKU

Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore

1. Konteksti i përgjithshëm i bujqësisë në Shqipëri dhe në Kosovë

Ekonomitë bujqësore dhe rurale të të dyja vendeve janë përballur gjatë këtyre njëzet viteve të fundit me mjaft sfida të mëdha. Ndryshimi i sistemit politik dhe ekonomik në Shqipëri dhe reforma agrare e fillimit të viteve '90, presioni politik dhe ekonomik mbi Kosovën për pothuajse shumë vite, që u mbyll me luftën e fundit në Ballkan për çlirimin e Kosovës, ndryshimi i strukturës tradicionale të tregjeve të produkteve bujqësore si dhe nevoja e përshtatjes së politikave dhe institucioneve të zhvillimit bujqësor dhe rural me politikat dhe me praktikat e mira europiane (në kuadër të proceseve integruese) kanë krijuar mjaft problematika, vështirësi dhe sfida të reja për të dyja këto vende.

Bujqësia mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomive kombëtare, duke kontribuar me rreth 17% të GDP-së në Shqipëri (2009) dhe rreth 30% të GDP-së në Kosovë. Në të dyja vendet rreth 50-60% e popullsisë jeton në zonat rurale dhe lidhet ngushtë

me aktivitetin bujqësor. Në Shqipëri niveli kombëtar i varfërisë është reduktuar masivisht në dhjetë vitet e fundit, nga 25.4% në vitin 2002 në 12.4% në vitin 2008. Në vitin 2006, rreth 45% e popullsisë së Kosovës vlerësohej se jeton në kushte varfërie ndërsa 16% në varfëri ekstreme¹. Përveç të tjerave, niveli i lartë i varfërisë rurale dhe lidhja e saj me popullsinë që merret me bujqësi, përbën dhe një nga karakteristikat e përbashkëta të të dyja vendeve. Megjithatë, duhet thënë se niveli i varfërisë ekstreme është reduktuar ndjeshëm gjatë këtyre viteve të fundit. Reduktim të ndjeshëm ka patur sidomos në Shqipëri, ku treguesi i varfërisë ekstreme është reduktuar me rreth katër herë, duke shkuar nga 5% në vitin 2002 në 1.2% në vitin 2008.

Të dyja vendet kanë një sipërfaqe të punueshme bujqësore pothuajse të përafërt. Megjithatë, raporti i tokës së punueshme bujqësore ndaj sipërfaqes totale të vendit është mjaft më i ulët në Shqipëri sesa në Kosovë. Kosova ka rreth rreth 585,000 hektarë tokë bujqësore (ose rreth 53% të sipërfaqes totale), nga e cila rreth 350,000 hektarë është tokë e kultivuar bujqësore dhe 180,000 hektarë janë klasifikuar si kullotë. Në Shqipëri sipërfaqja e tokës së punueshme bujqësore zë rreth 584 mijë hektarë tokë të punueshme bujqësore, në total rreth 450 mijë hektarë tokë e punuar.

Pavarësisht progresit të bërë gjatë këtyre viteve të fundit, në të dyja vendet bujqësia mbetet kryesisht një sektor i destinuar kryesisht për vetëmbajtje dhe vetëm një numër relativisht i vogël fermash është i orientuar për treg. Madhësia e fermave është ndër më të ulëtat dhe më të fragmetuarat në Europë. Në Shqipëri një fermë me madhësi mesatare ka rreth 1.2 ha tokë të punueshme bujqësore dhe kjo sipërfaqe është e ndarë në mesatarisht 3 parcela, ndërsa në Kosovë një fermë mesatare ka rreth 1.4 ha. të ndarë në mesatarisht 8 parcela (80% e fermave nga 0,5-2ha, që zënë rreth 86% të tokës së punuar)². Edhe

¹ World Bank. October 2007: "Kosovo Poverty report: Volume I: Accelerating Inclusive Growth to Reduce Widespread Poverty".


² MAFRD. 2003. "The Kosovo Greenbook: A strategy for sustainable agricultural and rural development in Kosovo".

agroindustria e të dyja vendeve përballet me mjaft probleme dhe sfida. Pas një rënije të madhe, gjatë viteve të para të tranzicionit, agroindustria në Shqipëri dhe ka filluar t'i përshepejtojë ritmet e rritjes vetëm në dhjetë vitet e fundit, kryesisht në drejtim të përpunimit të produkteve blegtorale, frutave dhe perimeve. Në Kosovë agroindustria mbetet ende në hapat e para, por me disa shenja mjaft pozitive gjatë pesë viteve të fundit. Megjithatë një pjesë e mirë e agroindustrialisë (sidomos asaj në Shqipëri) vazhdon të punojë me lëndë të parë të importuar si rezultat e fragmentimit të ofertës dhe nivelit të ulët të integritimit dhe strukturimit të zinxhirëve të furnizimit të produkteve nga tregu vendas.

2. Shkëmbimet tregtare agrorëshqimore

Raporti eksport/import në të dyja vendet vazhdon të mbetet mjaft i ulët (në 2008 - rreth 1/9.8 në Shqipëri dhe rreth 1/13.9 në Kosovë). Kjo ka rezultuar me një bilanc mjaft negativ në këtë sektor, me rreth -145 milionë Euro në Kosovë (në 2008) dhe rreth -447 milionë Euro në Shqipëri (në 2009).

Figurë 1. Ecuria e eksporteve agrorëshqimore shqiptare gjatë 2001-2008 (në milionë Euro).




Burimi: MBUMK. Vjetari statistikor 2009.

Eksportet shqiptare dhe kosovare janë rritur gjatë viteve të fundit. Gjatë periudhës 2004 – 2008 eksportet e produkteve agrourbushqimore shqiptare dhe kosovare kanë pësuar një rritje të ndjeshme (eksportet kosovare nga rreth 2.5 milionë Euro në 2004 në rreth 15 milionë Euro në 2008, ndërsa eksportet shqiptare nga 41 milionë Euro në 2004 në rreth 60 milionë Euro në vitin 2008).


Në Kosovë, produktet e hortikulturës zënë vendin kryesor, të ndjekura më pas nga frutat dhe perimet e përpunuara si dhe drithërat, ndërsa në Shqipëri vendin kryesor e zënë bimët mjekësore dhe aromatike dhe më pas perimet (kryesisht perimet e hershme). Ndërkohë që shumica e eksporteve agrourbushqimore shqiptare destinohen për tregjet europiane, rreth 50% e eksporteve agrourbushqimore kosovare janë të destinuara për në tregjet shqiptare dhe maqedonase (respektivisht me rreth 32% dhe 21% në vitin 2008, kryesisht patate dhe perime të vona). Megjithatë, si Shqipëria ashtu dhe Kosova janë ndër vendet e rajonit me nivelin më të ulët të eksporteve për banorë (Kosova me rreth 6 euro/banor dhe Shqipëria me rreth 16 euro/banor, në vitin 2007).

Figurë 2. Ecuria dhe përbërja kryesore e eksporteve agrourbushqimore



Burimi: USAID. 2010. *Kosovo Agricultural Opportunities Strategy* (Booz, Allen. Hamilton)

kosovare gjatë viteve 2004-2008 (në milionë Euro).



Burimi : Përlllogaritur bazuar në të dhënat e FAOSTAT, 2008

Figurë 3. Krahasim i vlerës së eksporteve agrourbushqimore për banor në vitin 2007 (në Euro/banor)

Edhe importet janë rritur dukshëm si në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë. Në Kosovë, nga rreth 48 milionë Euro në vitin 2004 vlera e importeve agrourbushqimore ka shkuar në rreth 156 milionë Euro në vitin 2008, ndërsa në Shqipëri gjatë së njëjtës periudhe importet janë rritur nga rreth 41 milionë Euro në rreth 60 milionë Euro. Rreth 20% e këtyre importeve agrourbushqimore kosovare vijnë nga Serbia, rreth 12% nga Maqedonia, rreth 7% nga Turqia dhe më pas vijnë vendet e tjera fqinje. Ndërkohë që produktet agrourbushqimore të importuara në Kosovë nga Shqipëria, me gjithë një tendencë rritjeje gjatë këtyre tre-katër viteve të fundit (sidomos me perimet e hershme, agrumet dhe disa fruta të tjerë) zënë më pak se 2% të totalit të importeve

kosovare.

3. Potencialet dhe sfidat e sektorit bujqësor në Shqipëri dhe në Kosovë

Sektori bujqësor i të dyja vendeve ka disa potenciale të rëndësishme që duhet të shfrytëzohen:

- Kushtet natyrore të Shqipërisë dhe të Kosovës ofrojnë mundësi për prodhimin e një larmie të madhe produktesh. Pjesa fushore dhe bregdetare e Shqipërisë mund të fillojë vjeljen e produkteve dhe të dalë në treg rreth 45-50 ditë para vendeve të Europës veriore, ndërsa pjesa malore dhe Kosova mund të dalin deri në rreth 30 ditë para Europës veriore. Të dyja vendet janë relativisht të pasura me burime ujore për zhvillimin e sistemeve të ndryshme të ujitjes. Ndër produktet me perspektivë për të dyja këto vende mund të përmendim: blegtorinë (sidomos të imëtat), pemët frutore, perimet (sidomos perimet e hershme në Shqipëri dhe perimet e vona në Kosovë), si dhe bimët eterovajore dhe aromatike.
- Mundësitë e mëdha për të rritur produktivitetin si në Shqipëri dhe në Kosovë kanë tregues mjaft të ulët (krahasuar me vendet europiane dhe me shumë prej vendeve të rajonit) për sa i përket intensitetit të kultivimit, rendimenteve për hektar, vlerës së produktit të tregtuar ndaj sipërfaqes së kultivuar, përqindjes së sipërfaqes së punueshme në prodhim, koeficientit të shfrytëzimit të krahut të punës, etj. Këto mangësi të sotme mund të kthehen në oportunitete të rëndësishme për përmirësimin e produktivitetit të sektorit, rritjen e punësimit dhe të ardhurave të familjeve rurale;
- Afërsia me tregjet europiane: produktet shqiptare dhe kosovare mund të arrijnë për rreth 1-2 ditë në të gjitha tregjet

europiane, volumi i eksporteve si dhe numri i partnerëve tregtarë po rritet me ritme të qëndrueshme;

Pavarësisht nga progresi i bërë gjatë këtyre viteve, procesi i zhvillimit dhe i modernizimit të sektorit të bujqësisë dhe ushqimit vazhdon të përballet me një sërë vështirësish të ngjashme, të cilat kërkojnë përgjithësisht ndërhyrje afatmesme dhe afatgjata, strukturore dhe teknologjike. Ndër problemet kryesore mund të përmendim (jo sipas rëndësisë): madhësinë e kufizuar dhe fragmentimin e fermave; nivelin e ulët të zhvillimit të treguar të tokës bujqësore; infrastrukturën e dobët bujqësore dhe rurale; nivelin e lartë të informalitetit në bujqësi; nivelin e ulët të integritimit të aktorëve dhe të strukturimit të zinxhirëve të furnizimit të produkteve dhe si pasojë nivelin e ulët të integritimit të ekonomisë bujqësore dhe rurale në ekonominë rajonale; mungesën e aksesit në financim përfshirë sistemin bankar dhe financimet publike; sektorë agroindustrialë pak të zhvilluar; politika fiskale jo sa duhet favorizuese për produktet bujqësore; sistem këshillimor, sistem edukimi dhe kualifikimi profesional bujqësor dhe rural pothuajse rudimetar; etj.

Burimi kryesor i rritjes së bujqësisë gjatë këtyre 20 viteve të fundit në Shqipëri (por deri diku edhe gjatë 10 viteve të fundit në Kosovë) ka qenë rritja totale e produktivitetit të faktorëve (tokës, punës dhe kapitalit), gjë që i ka lejuar bujqësisë të gjenerojë rritje me një shkallë të ulët investimi. Megjithatë, rritja totale e produktivitetit të faktorëve, e shkaktuar nga rialokimi postranzicional i faktorëve, mund të mos vazhdojë gjatë dhe reduktimi i mëtejshëm i varfërisë bazuar në fermat e vogla bëhet edhe më i vështirë. Në këto vendet duhet të kërkojnë mundësi të reja të zhvillimit të kapitalit fizik dhe njerëzor.³

³ MoAFCP. 2011. Draft Rural Development Programme 2011-2013 under the Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA).

Nevoja për koordinim të disa politikave të zhvillimit

Gjatë viteve të para të tranzicionit, politikat bujqësore të këtyre viteve kanë qenë të fokusuara kryesisht në drejtim të: i) reformave strukturore si ndarja e tokës në Shqipëri, privatizimi apo ristrukturimi i ndërmarrjeve në Shqipëri dhe në Kosovë, rehabilitimi i sistemeve të ujitjes (Shqipëri dhe Kosovë) dhe kullimit (Shqipëri); ii) ngritjes dhe forcimit të strukturave dhe institucioneve, si dhe; iii) zhvillimit të legjislacionit rregullator të ekonomisë së tregut në Shqipëri. Gjatë këtyre viteve të fundit, vërehet një fokusim më i madh i politikave kryesisht në drejtim të: i) infrastrukturës rurale dhe rritjes së aksesit në treg; (ii) përmirësimit të teknologjive dhe rritjes së konkurrueshmërisë; iii) harmonizimit të legjislacionit me BE-në (kryesisht lidhur me sigurinë ushqimore dhe me standardet); iv) zhvillimit insitucional dhe forcimit të kapaciteteve të formulimit dhe zbatimit të politikave.

Të dyja vendet përbëjnë një hapësirë territoriale me shumë ngjashmëri dhe komplementaritet për sa i përket aktivitetit bujqësor dhe kanë një perspektivë të përbashkët ekonomike rajonale dhe europiane. Në këtë kuadër do të ishte me përfitime të dyanshme rritja e nivelit të bashkëpunimit dhe e koordinimit mes të dyja vendeve dhe sidomos në drejtim të:

- Shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave të mira në formulimin dhe zbatimin e politikave dhe reformave institucionale;
- Zhvillimit të sistemit të kërkimit shkencor, edukimit profesional në bujqësi dhe shërbimeve të specializuara laboratorike (asnjera prej vendeve, të paktën në periudhë afatshkurtër deri në periudhë afatmesme, nuk do të mund të përballojë e vetme ngritjen dhe zhvillimin e plotë të një sistemi të tillë);

- Përgatitjes dhe zbatimit të programeve të përbashkëta zhvillimore në hapësirat ndërkufitare (me mundësi financimi dhe nga BE-ja apo donatorë të tjerë), sidomos në fusha si zhvillimi i turizmit malor, zhvillimi i produkteve tradicionale dhe territoriale me vlera të përbashkëta të produkteve të orgjinës, etj;
- Nxitjes së integritimit të tregjeve dhe zinxhirëve të produkteve bujqësore ndërmjet të dyja vendeve (gjë që do të mund të rriste aksesin në treg dhe atraktivitetin përmes reduktimit të efektit të fragmentimit të ofertës);
- Koordinimit të politikave dhe mekanizmave të menaxhimit dhe rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit të burimeve ujore dhe natyrore të pellgut ujëmbledhës të Drinit;
- Zhvillimit të mekanizmave të përbashkëta për reduktimin e efekteve negative dhe rritjen e përfitimit nga ndryshimet klimatike të cilat prekin një numër të madh të popullsisë rurale ku bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik. Një vend të rëndësishëm kanë këtu analizat sasiore e cilësore të opsioneve të përshtatjes, zhvillimit të planeve konkrete të përbashkëta për përgatitjen e sektorit bujqësor për të qenë më i qëndrueshëm ndaj ndryshimeve aktuale dhe të pritshme klimatike.
- Bashkëpunimit në rrjet dhe përmirësimit të kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimit të institucioneve meteorologjike, strukturave, agjencive dhe operatorëve të ndryshëm publikë që është një element shumë i rëndësishëm i cili duhet të adresohet sa më shpejt në funksion të nevojave jo vetëm të fermerëve, por edhe të institucioneve të tjera operative ose vendimmarrëse në të dyja vendet.

Bibliografi:

Çela, R, Marku, S, Imami, D. 2010. *Review of agriculture and agricultural policy in Albania*. In Agriculture in Western Balkan Countries. Enlargement Network for Agripolicy Analysis. AgriPolicy

MAFRD-Kosovo. 2003. *The Kosovo Greenbook: A strategy for sustainable agricultural and rural development in Kosovo*.

MAFRD-Kosovo. 2009. *Policy and strategy paper on forestry sector development 2010 – 2020*.

Marku, S. 2006. *Integration of the Albanian agricultural market into the regional and EU markets*. CEI-Socio-Economic Forum - 2007.

Marku, S. 2009. *Development of Micro, Small and Medium Enterprises in the Rural Mountain Areas of Albania*. Pp 261-272. Economic and Social Challenges and Problems. International Conference, 2008. University of Tirana & ASET.

Marku, S. 2010. *Les femmes en milieu rural et agricole en Albanie: contraintes et évolutions*. Les notes d'alerte du CIHEAM, No 69, Novembre 2010.

MoAFCP-Albania. 2011. *Draft Rural Development Programme 2011-2013 under the Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA)*.

USAID. 2008. *Kosovo Economic Performance Assessment*.

USAID. 2010. *Kosovo Agricultural Opportunities Strategy* (Booz, Allen. Hamilton).

World Bank. October 2007. *Kosovo Poverty report: Volume I: Accelerating Inclusive Growth to Reduce Widespread Poverty*.

Integrimet Rajonale Europiane

A munden Shtetet Nordike të jenë shembull për Shqipërinë dhe Kosovën dhe për trojet e tjera shqiptare në Ballkan? _____

Avni DERVISHI, M.A. _____

*Magjistër i Shkencave Politike Europiane
Këshilltar për Bashkëpunim Ndërkombëtar i z.v.Kryeministrit të
Republikës së Kosovës, z.Behgjet Pacolli*

Shtetet nordike janë të njohura në të gjithë botën për një sistem efikas të bashkëpunimit rajonal. Ky bashkëpunim ka arritur suksese dhe merret si mostër e bashkëpunimit efikas në të gjitha sferat e jetës.

Për shembull në vitin 2010 sipas të gjitha parametrave globalë del se vendi ku unë kam jetuar tash e 20 vite, Suedia është vendi i dytë në botë me nivelin e standardit jetësor, Norvegjia vendi i parë, Finlanda e treta, Danimarka e katërta etj. Por, pse atëherë janë shtetet nordike aq mirë të integruara? Çka i bashkon ato dhe çka i ndan? Cilat janë arsytet prapa vlerave të tyre të përbashkëta?

Nëse dëshirojmë ta kuptojmë të tashmen dhe t'i studiojmë arsytet e këtij "vëllazërimi nordik" doemos ne duhet ta studiojmë të kaluarën e tyre të përbashkët. Një përshkrim i shkurtër i historikut të Bashkëpunimit Nordik na tregon se pas mbarimit të luftës, konkretisht më 1952

– u formua Këshilli Nordik. Arsyet ishin – Sigurimi i stabilitetit dhe zhvillimit politik, ekonomik e social. Ndërsa thellimi i këtij bashkëpunimi ndodhi më 1962-in, kur edhe u formua Këshilli Ministror Nordik.

- Tanimë janë shumë mirë të qartësuar dy qëllimet kryesore të këtij integrimi rajonal:

1. Që rajoni nordik të bëhet rajon atraktiv për jetesë, punë dhe zhvillim biznesi
2. Që të forcohen shtetet nordike në arenën ndërkombëtare (brenda Unionit European si dhe më gjerë).

Ky integrim është i drejtuar dhe i autorizuar nga institucionet e vendeve të rajonit përmes Këshillit Nordik si dhe Këshillit Ministror Nordik

Këshilli Nordik

Është bashkëpunimi në mes të parlamentarëve të vendeve nordike, si dhe tash 3 shteteve Baltike (Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë). Bashkëpunimi është i koncentruar në:

5 komisione politike (Zhvillim Ekonomik, Hulumtim Shkencor & Arsimim, Kulturë, Mjedis, Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Rinisë).

Sipas ideologjisë partiake (të djathtë, të majtë dhe qendrore)

Një herë në vit mbahet takimi plenar, por shumë herë brenda vitit, sipas përgjegjësive që deputetët kanë në komisionet e tyre. Koordinim të plotë kishin dhe kanë në gjithçka që lidhet me integrimet europiane, edhe pse jo të gjitha vendet nordike janë anëtare në Unionin European, për shembull Norvegjia dhe Islanda.

Meqenëse Këshilli Nordik është bashkëpunimi në mes të parlamenteve të këtyre vendeve, kjo ndikon automatikisht që edhe pjesët e tjera të shoqërive nordike të integrohen ndërmjet tyre si, për shembull:

Angazhimi i rinisë: Nordic Youth Council (Këshilli i Rinisë Nordike) takohet në të njëjtën kohë.

Arrihet deri tek unifikim i qëndrimeve pozitive-opozitive: Kur është në pyetje interesi i rajonit nordik takohen liderët e vendeve nordike si dhe lideri/ja e opozitës merr pjesë dhe merren vesh për një qëndrim të përbashkët si, për shembull, qëndrimi ndaj Rosisë etj.

Identiteti Nordik forcohet çdo vit: 1 herë në vit duke bërë promovimin e vlerave të përbashkëta. Rregullisht bëhet ndarja e çmimeve në Literaturë, Muzikë, Film si dhe Hulumtim Shkencor dhe Ruajtje të ambientit (“mini çmime NOBEL”).

Këshilli Ministror Nordik – quhet bashkëpunimi në mes të qeverive të këtyre shteteve. Kjo realizohet përmes 10 këshillave ministrorë që mundohen të arrijnë në konsensus për: Tregun e Punës, Zhvillimin Ekonomik, Energji dhe Politikë Rajonale, Bujqësi, Ushqim dhe Shfrytëzimin e Pyjeve, Barazinë Gjinore (që edhe është pjesë përbërëse e traditave demokratike në këto shtete), Kulturë, Ligjet dhe Rregulloret e tjera, Mjedis, Shëndetësi dhe aspekte Sociale (mjekim të përbashkët), Arsimim dhe Hulumtime Shkencore, Ekonomi dhe Politikë Financiare.

Financimi i këtij bashkëpunimi kuptohet se është i përbashkët nga shtetet anëtare Suedia, Norvegjia, Finlanda, Danimarka, Islanda, Estonia, Letonia dhe Lituania si dhe nga kompani private që ushtrojnë bizneset e tyre ose që mendojnë ta zgjerojnë aktivitetin e tyre në vendet nordike, domethënë që financimi është një partneritet Publiko-Privat (PP). Shtetet nordike po ashtu çdo vit marrin fondet që vijnë nga Unioni

European për zhvillim rajonal. Më shumë se 1/3 e buxhetit shkon në financimin e instituteve të përbashkëta nordike (p.sh. Instituti Nordik për promovimin e Filmit dhe TV-së, Instituti Nordik për Hulumtime Shkencore etj).

Tregu i punës - shtetet nordike e rregullojnë tregun e tyre të punës përmes bashkëpunimit të drejtpërdrejtë të të dyja grupeve kryesore: Punëdhënësve dhe Punëmarrësve

Të dyja anët janë në kërkim për propozimin e ligjeve përkatëse. Kjo edhe ka ndikuar që të krijohet një treg unik i punës, që karakterizohet me: Ngjashmëri maksimale (25-30 % është përbërja e sektorit shoqëror në Ekonomi), Siguria është shumë e lartë (80-90 % e punëmarrësve janë anëtarë në Sindikata) si dhe në konsensus/kompromis, që në praktikë d.m.th. se asnjë ndryshim në vendet e punës nuk bëhet pa marrëveshjen e plotë të të dyja palëve. Arritja deri te përshtatja e direktive të UE-së, bëhet po ashtu bashkërisht në mes të shteteve, pa dallim se Norvegjia dhe Islanda nuk janë anëtare.

Banka Nordike e Investimeve (BNI)

Një nga gjeneratorët më të mëdhenj të integritit nordik, pas institucioneve shtetërore është Banka Nordike e Investimeve. Qëllimi i krijimit të saj është përkrahja e projekteve që e rrisin konkurrencën në treg, ruajtjen dhe menaxhimin e mjedisit dhe zhvillimin e gjithanshëm të rajonit. BNI u jep kredi me kushte të tregut edhe aktorëve institucionalë edhe atyre privatë. Fushëveprimi i Bankës Nordike të Investimeve fokusohet në 4 fusha: Energji, Mjedis, Transport, Logjistikë dhe Komunikim si Inovacione. Projektet që përkrahen shqyrtohen sipas koeficientit të zhvillimit të qëndrueshëm, d.m.th. afatgjatë. Progresi ekonomik i këtij rajoni ka ndikuar që kjo bankë ta rrisë ndikimin e vet edhe në rajone të tjera. Kjo po manifestohet në dhënie e kredive ekonomive në zhvillim që kanë iniciuar një

bashkëpunim rajonal me rajone të tjera, p.sh. BTDBSR (Bank for Trade & Development of the Black Sea Region – Banka për Tregti dhe Zhvillim në regjionin e Detit të Zi). Vlera e obligimeve dhe aksioneve të BNI njihet si shumë e lartë.

Infrastruktura dhe telekomunikimi është faktor i pakontestueshëm i çdo zhvillimi. Vendet nordike i kushtojnë rëndësi të veçantë këtij fakti, prandaj edhe Integrim Ekonomik në Teknologjinë Informativë (TI) ka fonde të garantuara. *The Economist Intelligence Unit* i radhit vendet nordike rreth brebandit, internetit, investimet në TI dhe kompetencat në këtë fushë në ranglistën më të lartë të planetit tonë. Shtetet nordike kanë treg të unifikuar që njihet për kompetencë, inovacion, dhe zhvillim dinamik. Integrimi ekonomik kuptohet se edhe kushton, prandaj për t'i ulur shpenzimet financiare këto vende edhe vendosin që trupat koordinues të këtij bashkëpunimi të shpërndahen në tërë rajonin. p.sh. Në vitin 2010 qendra më moderne e komunikimit kabllor, e quajtur HPC, u vendos në Islandë, me qëllim që të lehtësohet hulumtimi shkencor dhe kalkulimi i statistikave të vendeve anëtare. Energjia – dhe garantimi për përkrahjen interne brenda shteteve nordike për të pasur 100 % elektricitet për të gjithë banorët e rajonit është po ashtu evidente. D.m.th. termi "Një për të gjithë – të gjithë për një" – është aplikativ për tregun energjetik nordik. Më 2015 planifikohet që qytetari nordik do të ketë mundësi të zgjedhë vetë se në cilin shtet nordik do ta blejë energjinë elektrike për konsumimin e vetë privatë apo të kompanisë.

Integrimi Ekonomik Nordik përfshin edhe autoritete të përbashkëta: p.sh. NIVA (Instituti për Edukim të mëtejshëm për mjedisin e biznesit). Ky institut ofron kurse të nivelit shumë të lartë me shkencëtarë dhe ekspertë mbi bashkëpunimin ndërshtetëror për tregun e përbashkët (Rusi, shtetet Baltike etj).

Që nga 1985 instituti NORDjob – ndihmon rininë me punë sezonale verore (3 muaj) . Rinia 18-28 vjeç, nga të gjitha shtetet

nordike mund të kërkojë punë në shtetin tjetër duke mos u diskriminuar aspak nga përparësitë eventuale të punëtorëve vendas si dhe duke paguar taksa më të ulëta sesa punëtorët e rëndomta. Për luftimin sa më efikas të papunësisë tek rinia është krijuar një databazë e përbashkët mbi vendet e punës për rininë.

Që bashkëpunimi në një sferë na mundëson bashkëpunimin edhe në hapësira të tjera tregon edhe përvojat që do të përmenden në vijim ku këto shtete kanë një avantazh të mrekullueshëm duke krijuar treg të përbashkët edhe në: Sektorin e shëndetësisë si dhe të veterinarisë, Institutin për Hulumtime Shkencore, Institutin hulumtues për Literaturë për Fëmijë. Por edhe integrimi në:

Energji: Treg të përbashkët Nordik energjetik 2015 (Tash vlen klauzola "përgjegjësia e përbashkët" e furnizimit me energji,

Sistem tatimi të përbashkët (d.m.th jo tatime të dyfishta. Ku rajoni Oresund, që përfshin qytetin Malmo ne Suedi dhe qytetin e Kopenhagës në Danimarkë. Aty janë më se 48 000 qytetarë nga Suedia që punojnë dhe udhëtojnë çdo ditë në Danimarkë dhe anasjelltas)

Vlerësime të njëjta në universitete e kolegje që gjenden në trojet nordike,

Kontrollimin e kufijve ("Schengeni Nordik" shumë para marrëveshjes Schengen – jo vetëm sezonal si p.sh Shqipëri-Kosovë)

Mbrojtje: Nordic Battle Group – është krijuar me qëllim që vendet nordike, në kohën më të shkurtër, të mund të dërgojnë një batalion të përbashkët ushtarësh kudo në botë që kërkohet nga Kombet e Bashkuara, NATO ose Unioni Europian. Edhe këtu as Suedia e as Finlanda nuk janë anëtare në paktin Veri-Atlantik të NATO-s, por e marrin përgjegjësinë e implementimit të bashkëpunimit regional në rend të parë)

Diplomaci: Suedia, Finlanda dhe Norvegjia në shumë vende të botës i kanë ambasadat e përbashkëta. Me qëllim të uljes

së shpenzimeve shtetërore, rritjes së efikasitetit diplomatik e mbrojtjes së qytetarëve të tyre jashtë vendit, jo rrallë i kanë përfaqësitë tyre diplomatike në të njëjtën ndërtesë.

Shtetet e Europës Veriore kanë bashkëpunim të ndërsjellë edhe pse janë të ndryshme me gjuhë, etnicitet etj. Pse atëherë funksionon Integrimi Nordik? Sepse ata i kanë vendosur bashkërisht:

Parakushtet

Identifikimin e kanaleve promovuese,

Ngritja e vetëdijes mbi beneficet e bashkëpunimit për popullin është në nivel të lartë (kjo edhe për arsye të fushatave të rregullta)

Shtetet nordike kanë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, gjë që u pa edhe nga krizat e fundit financiare globale që nuk i kanë goditur këto vende. Por, a mundemi ne në trojet tona etnike në Ballkan të mësojmë apo edhe më mirë të aplikojmë ndonjë eksperiencë nga bashkëpunimi nordik? Unë besoj dhe jam më se i sigurt se po. Po ashtu mendoj se duke pasur parasysh globalizimin e tërësishëm të tregut, bashkëpunimi gjithëpërfshirës kombëtar është një domosdoshmëri e kohës moderne europiane që mbështetet edhe financiarisht nga Komisioni European dhe nga institutet e tjera financiare, sepse përshtatet me linjat gjithëpërfshirëse të integritimeve rajonale. Këto të fundit sjellin stabilitet demokratik ekonomik, social e kulturor, nga të cilat përfiton jo vetëm rajoni, por edhe kontinenti ynë. Duke u bazuar nga përvoja nordike dhe përkrahja e Brukselit pse atëherë ne të mos krijojmë për shembull:

1. Ligje e rregulla të përbashkëta përmes krijimit të trupit bashkëveprues Kosovë-Shqipëri?
2. BISH - Banka për Investime Shqiptare?
3. Lëvizje pa pasaporta gjatë gjithë vitit e jo vetëm sezonale, siç

e kanë pasur që para 30 viteve shtetet nordike?

- Në një kohë afatshkurtër unë jam i bindur se duhet të krijohet një Institut për shkëmbime rajonale shqiptare, ku çdo nxënës shqiptar, p.sh. nga Shqipëria do ta kalonte një javë në semestër në një klasë dhe në një familje shqiptare në Kosovë, Tetovë, Tuz apo Preshevë dhe anasjelltas. Me partneritet publiko-privat si dhe pjesëmarrje në sponsorizim, përmes kompanive që i promovojnë prodhimet vendore, rritet edhe Integrimi Ekonomik. Kjo shkon 100 % me cakun e integritime europiane.

Ne i kemi të gjitha mundësitë që të marrim shembull nga vendet nordike për krijimin e një rajoni progresiv gjithëpërfshirës për krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e gatishmërisë sociale, arritjen e stabilitetit demokratik si dhe ta kemi përkrahjen e plotë të miqve tanë ndërkombëtarë.

Integrimi dhe bashkëpunimi financiar Shqipëri – Kosovë

Dr. Elvin MEKA

Dr. Arjan KADAREJA

Universiteti European i Tiranës

Abstrakt. *Shqipëria dhe Kosova, dy shtete shqiptare në rajon po përpiqen të ndërtojnë një urë të përbashkme lidhëse midis ekonomive të tyre kombëtare. Ndonëse në hapat e para, ky vizion, ky vullnet dhe kjo dëshirë e përbashkët e shumë grupeve të interesit në të dy shtetet shqiptare, ka nevojë të konkretizohet me identifikimin e mundësive reale dhe hapësirave konkrete, për një bashkëpunim të qëndrueshëm e të koordinuar ekonomik midis dy ekonomive, me destinacion përfundimtar integrimin e harmonizuar të këtyre ekonomive, brenda rajonit të Ballkanit.*

Një nga drejtimet e rëndësishme dhe të mundshme në mbështetje të këtij integrimi do të ishte dhe integrimi financiar i sistemeve bankare të të dyja vendeve. Ekzistojnë disa arsye madhore që krijojnë një shtat të përshtatshëm e që favorizojnë këtë integrim financiar, sikundër dhe janë të dukshme disa efekte pozitive, që një integrim i tillë mund të sjellë për të dyja sistemet financiare dhe ekonomitë respektive. Punimi fokusohet kryesisht në aspektin e borxhit publik të Shqipërisë dhe në aspektin e efekteve të mundshme pozitive që do të kishte mbi të ky integrim.

Integrimi dhe bashkëpunimi financiar Shqipëri-Kosovë

Ndër arsytet kryesore që flasin pozitivisht mbi një integrim të mundshëm ekonomik dhe financiar midis Shqipërisë dhe Kosovës mund të përmendim:

1. Asimetrinë evidente në ciklet e biznesit dhe të kursim – investimeve në të dyja vendet


Vetë historiku dhe rruga e ndjekur në zhvillimin e ekonomisë së tregut, sikurse dhe karakteristikat specifike që ka respektivisht të dallueshme ekonomia e Shqipërisë dhe e Kosovës e bëjnë evidente ekzistencën e një asimetrie ciklike në zhvillimin ekonomik dhe institucional midis dy ekonomive dhe sistemeve financiare respektive.

Kjo asimetri ciklike, ndonëse evidenton statet e ndryshme të zhvillimit ekonomik të të dyja vendeve, nga pikëpamja e zhvillimit të tregut dhe e produkteve financiare mund të shihet nën një dritë pozitive, të paktën për dy arsye:


1. i bën letrat me vlerë dhe instrumentet e tjera financiare, të emetuara në të dyja vendet, por në një këndvështrim më të gjerë, edhe në rajon, interesante dhe të pëlqyeshme për kthime reale dhe për diversifikim rreziku.

Duke qenë se kemi shkallë të ndryshme, por deri diku të ngjashme rreziku midis dy vendeve (por dhe në raport me vendet e tjera të rajonit), kjo asimetri mundëson që këto produkte e instrumente financiare të jenë plotësuese dhe jo zëvendësuese të njëri – tjetrit.

2. ndihmon në harmonizimin dhe plotësimin e cikleve të huamarrjes dhe huadhënies midis institucioneve financiare dhe huamarrësve në të dyja vendet.




Në këtë kuadër, do të kemi një rritje mekanike të mundësisë së huadhënies dhe huamarrjes në të dyja vendet, duke përdorur një bazë huamarrëse dhe huadhënëse të zgjeruar, brenda mjedisit financiar të të dyja vendeve së bashku, si dhe duke plotësuar nevoja për huadhënie të natyrave të diferencuara dhe në stade të ndryshme të zhvillimit të biznesit.



Natyrisht, shfrytëzimi me efektivitet i potencialeve të sipërpërmendura të kësaj asimetrie do të bëhej i mundur vetëm në kuadër të sigurimit të një niveli të caktuar integrimi dypalësh

dhe rajonal, si në rrafshin ekonomik, ashtu dhe në atë financiar. Një aspekt tjetër i rëndësishëm, përveç asimetrisë së ciklit të biznesit, është dhe asimetria në aspektin e kursim – investimeve midis të dyja vendeve. Është e qartë që, ekspansioni i kursimeve në Shqipëri mund të financojë më së miri ekonominë në Kosovë dhe anasjelltas. Ky lloj financimi i ndërsjellë mund të jetë shumë i ngjashëm me shkëmbimet bujqësore ose të energjisë midis dy vendeve (në sezona të ndryshme), të cilat në këto fusha kanë dallime të qarta strukturore, por fatmirësisht këto janë ndryshime plotësuese dhe jo zëvendësuese (konkurruese) të njëra – tjetrës.



Siç shihet dhe nga grafiku, gjatë gjithë vitit të fundit kemi rritje kursimesh dhe disponibilitet të tepërt depozitash. Praktikisht, sistemi bankar shqiptar mban mbi 900 milionë EURO në formën e vendosjes së depozitave jashtë me bankat mëma, ose ato korrespondente, të cilat përfitojnë fare pak të ardhura, pasi këto vendosje janë me norma shumë të ulëta interesi. Për më tepër, këto fonde, për shumë arsye, nuk i shkojnë në mënyrë produktive ekonomisë shqiptare nëpërmjet kreditimit të biznesit.

Në këtë kuadër, Kosova pse jo dhe rajoni, mund të ishin aktualisht alternativa më të mira e më fitimprurëse për bankat shqiptare. Përveç aspektit të përfitueshmërisë, këto fonde do të ndihmonin në nxitjen dhe mbështetjen e mëtejshme të zhvillimit të biznesit në Kosovë me kosto më efektive, por dhe me përfitueshmëri më të lartë për bankat shqiptare.

II. Rruga relativisht e gjatë e integritit financiar me BE-në dhe Eurozonën për të dyja vendet, qoftë kjo dhe në këndvështrimin rajonal.

Nisur nga situata komplekse ekonomike dhe problematika që dominon sot Eurozonën dhe Bashkimin Europian, duket se, për të dyja vendet, rruga drejt këtyre dy strukturave dhe hapësirave dhe integrimi respektiv në to nuk do të jetë aq i shpejtë dhe i lehtë. Kjo dhe për vetë faktin e momentit në të cilin ndodhet ky proces integrimi në Shqipëri dhe në Kosovë dhe për çështjet ose kriteret specifike që duhet të përmbushin në vijim të dyja vendet.

Faktet tregojnë se Shqipëria ka një shkallë modeste të integritit financiar me Eurozonën, siç tregohet dhe në grafikët e mëposhtëm. Nga grafikët shihet qartë se, në dallim me Gjermaninë, si ekonomia më e madhe dhe shtyllë e Eurozonës, në Shqipëri probabiliteti i bashkëlëvizjeve të kursit të monedhës vendase dhe linja e pavarësisë luhaten thuajse njëlloj dhe fare pranë njëra – tjetrës. Kjo tregon për një shkallë të ulët integrimi të Shqipërisë me Eurozonën.

Nga sa më lart dhe në këtë kuadër, integrimi dypalësh dhe ai rajonal i të dyja vendeve do të rriste, ndër të tjera, kërkesën për letrat me vlerë të emetuara nga institucionet dhe nga subjektet (publike e private) të secilit vend. Ndërkohë, në të dyja vendet mund të punohej për integrimin dypalësh, pa hequr dorë nga objektivi madhor i integritit në BE dhe në Eurozonë, por ky integrim dypalësh do të ndihmonte dhe do të lehtësonte ndjeshëm drejt arritjes së objektivit madhor të mësipërm.

Efektet e pritshme pozitive nga integrimi dhe bashkëpunimi financiar Shqipëri-Kosovë

Integrimi dhe harmonizimi financiar dypalësh (e rajonal) do të kishte efekte të pritshme pozitive ndër të tjera, në:

- reputacionin,
- çmimin,
- likuiditetin dhe
- maturimin

e instrumenteve financiare të të dyja sistemeve financiare, ku sigurisht elementi i çmimit dhe ai i maturimit janë më të rëndësishmit.

Pa hyrë në një analizë të hollësishme të të gjitha instrumenteve e produkteve financiare, argumentin e mësipërm mund ta zhvillojmë vetëm për borxhin publik të qeverisë shqiptare, për të kuptuar potencialin dhe mundësitë që ekzistojnë, për të trupëzuar të gjitha elementet pozitive të sipërpërmendura në ecurinë e këtij borxhi.

Praktikisht, nëse do të shqyrtojmë statistikën e borxhit publik të Shqipërisë do të vërejmë se, aktualisht borxhi publik në LEK është rreth 40% e PBB-së dhe ky borxh ka një maturim mesatar rreth 1.7 vjet. Nisur nga këto parametra, qeverisë shqiptare i nevojitet mesatarisht çdo vit që të rifinancojë një borxh rreth 20% të PBB-së (për krahasim për shembull: Gjermania me një nivel të përafërt borxhi kundrejt PBB-së (~78%) i duhet të rifinancojë çdo vit një borxh rreth 3-4% të PBB-së). Një fakt i tillë përkthehet në një kosto të shtuar të shërbimit të borxhit dhe pasiguri e një niveli të caktuar, lidhur me rifinancimin e tij të sigurt në të ardhmen. Rritja e synuar dhe e mirëpritur e afatit mesatar të maturimit të borxhit publik në Shqipëri do të ndikonte ndër të tjera dhe në kthime më pozitive për

investuesit dhe diversifikim i bazës investuese, tashmë nga jashtë Shqipërisë (investuesit nga Kosova ose nga rajoni).

Në përmbllje të këtij materiali të shkurtër, do të ishte e rekomandueshme ndër të tjera që, investuesve nga Kosova, pse jo dhe nga rajoni, të mund t'u ofroreshin mundësi dhe lehtësi të përbershme për blerje të borxhit publik të Republikës së Shqipërisë, në monedhë vendase dhe të huaj (duke ndikuar dhe në uljen e kostos së këtij borxhi – në valutë të huaj).

Në vend të përmbylljes, ose roli i Lëvizjes

Mentor NAZARKO, M.A. _____

*Drejtor i Qendrës për Kërkime të “Lëvizjes për hapësirë
mbarëkombëtare zhvillimi”, Universiteti FAMA*

Sipas një përkufizimi, “energji potenciale”, do të thotë energjia që ruan një trup, i gjendur në një fushë force, ose për shkak të përbërjes së tij.

Duke u përpjekur të ndërtojmë një paralelizëm me realitetin e popullsisë shqiptare në fillim të shekullit 21, mund të guxojmë të themi, se pavarësisht shpërndarjes së tyre në vende të ndryshme, këto popullsi disponojnë një energji potenciale të jashtëzakonshme. Kjo energji e sotme, është sigurisht më shumë se ajo që këto zotëronin në prag të copëtimit përfundimtar në fillim të shekullit 20. Në hapësirat e banuara prej tyre gjendeshin dhe gjenden portet më të rëndësishme në rajon, rrugë të rëndësishme komunikimi me rëndësi botërore ku kishin kaluar kryqëzatat, vendburime minerale të jashtëzakonshme, etj. Kjo “energji potenciale”, pra tërësia e kapaciteteve të tyre njerëzore dhe natyrore, të administruara prej një sistemi ekonomik dhe politik, të iluminuar prej një klase intelektuale dhe politike në lartësinë e misionit historik, do ta çonte kombin në nivele unike zhvillimi dhe begatie.

Premisat e lirisë, të pavarësisë dhe të demokracisë së vendosur në vendet ku banojnë shqiptarët, janë kushte ideale që këto nivele zhvillimi dhe begatie, të ishin arritur dhe të arrihen dhe sot. Kapacitetet natyrore mbeten aty ku ishin me gjithë dëmtimet e ardhura prej marrive të tranzicionit. Kapacitetet njerëzore kanë nevojë për formësim të mëtejshëm.

Por atëherë çfarë i ka penguar dhe i pengon shqiptarët që sot të mbeten në vendet e fundit në Europë për nga niveli i zhvillimit, nga të ardhurat për frymë, nga furnizimi me të mira kolektive të tilla si uji, energjia, etj, etj? Çfarë roli do të kishte krijimi i një kuadri përbashkues në përshpejtimin e zhvillimit kombëtar?

Me këto pikëpyetje dhe me nevojën për prognozë, në vitin 2007, së bashku me një grup studiuesish ne organizuam në Durrës një konferencë e cila të ofronte pikërisht perspektivën e marrëdhënieve ndërshqiptare në fillim të shekullit 21. Në vitin 2007-të, Shqipëria po hynte në NATO dhe Kosova shumë shpejt do të bëhej e pavarur, elemente thelbësore këto që forca e shqiptarëve si komb të rritej shumë. Me një fjalë “energjia e tyre potenciale pritej të arrinte nivele të larta. Qasja jonë ishte se kjo perspektivë do të formësohej më së pari nga ata që “dinë” më shumë, nga njerëzit e shkencës dhe ata të biznesit. Politika, roli i së cilës është të shtrojë rrugë zhvillimi, duhej vetëm të dëgjonte. Pastaj të vepronte! Duhej që kjo Energji Potenciale kombëtare të shndërrohej në Energji Kinetike. Në fizikë, Energjia Kinetike është energjia që krijohet prej Lëvizjes së trupit. Energjia Kinetike e një kombi për analogji, është energjia e zhvillimit, e lëvizjes përpara të të gjitha kapaciteteve njerëzore dhe natyrore të shqiptarëve kudo që ishin.

Kanë kaluar 4 vjet qysh atëherë, por niveli i bashkëpunimit ndërshqiptar mbetet ende shumë i ulët. Ndërtimi i rrugës së Kombit që duhej të nxiste këtë bashkëpunim cilësisht dhe në pikëpamje të sasisë, nuk u shoqërua me politika të menduara, të cilat brenda kushtëzimeve të integrimit europian të afronin më shumë shqiptarët mes veti, kah begatia. Plagët e moszhvillimit

i prekin thuajse njëjtë viset e shqiptarëve. Mësimi skënderbejan se “bashkimi bën fuqinë”, nuk është mbajtur parasysh as për energjinë, as për bujqësinë, as për kulturën.

Ne kuptuam që mungonte Lëvizja, ai element kyç që e shndërron Energjinë Potenciale në Energji Kinetike. Lëvizja, duke i shfrytëzuar të gjitha kapacitetet natyrore dhe njerëzore, do të çonte kah Zhvillimi dhe Përparimi, kah Begatia, kah Mbrothësia, kah Komunuelthi Shqiptar, siç e ka quajtur në mënyrë elokuate Arbën Xhaferri, njëri nga intelektualët më të ndritshëm shqiptarë dhe kumbari i Lëvizjes. Me këtë synim, dy universitete nga hapësira shqiptare, Universiteti European i Tiranës dhe Universiteti Fama në Prishtinë, mblodhën në korrik të vitit 2011 një grup intelektualësh, studiuesish, njerëzish të biznesit dhe vendimmarrësh politikë, dhe i dhanë jetë Lëvizjes për Hapësirë Mbarëkombëtare Zhvillimi. Në krye të saj, në mënyrë unanime, Bordi i Lëvizjes, vuri z. Behgjet Pacolli, njeriun i cili duke u zhvendosur prej viseve shqiptare kah hapësira globale arriti të ndërtonte një emër të madh në botë. Kështu Lëvizja, e hapur për anëtarësim në të gjithë Hapësirën ku jetojnë shqiptarë, do të shndërrohet në një grup presioni të fortë mbi qeveritë e vendeve tona, duke inkurajuar bashkimin e kapaciteteve të gjithëmbarshme kombëtare.

Objektivi i Lëvizjes është Mbrothësia, Begatia e shqiptarëve. Sot shqiptarët s’kanë më frikë nga askush për t’u zhvilluar. Të tjerët ndoshta duhet t’i marrin më seriozisht se më parë.

